



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 86709

Më: 08 korrik 2024

Në bazë të nenit 52 paragrafit I, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 59 paragrafit I të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet me **16 korrik 2024 (e martë)** në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **orën 10:00**. Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 26 qershor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Prizrenit 2024-2029;
6. Raporti financiar janar - qershor 2024;
7. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor;
8. Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë, menaxhimit të mbeturinave dhe energjisë elektrike;
9. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024.



Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Komitet za Politiku i Finansije

Br. 001/060 – 86709

Dana: 08 jula 2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 52 stav I, Zakona o Lokalnoj Samoupravi i člana 59 stav I Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15.10.2008. sazivam sastanak Komiteta za Politiku i Finansije koja će se održati: **16. jula 2024. godine (utorak)**, u sali za sastanke KPF-a, u „Beloj kući“, sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka kao član Komiteta za Politiku i Finansije, pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeći:

D N E V N I R E D

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od dana 26 juna 2024;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Razmatranje i usvajanje prethodne predlog-odluke o davanju opštinske imovine na kratkoročno korišćenje organizacijama civilnog društva;
4. Razmatranje i usvajanje prijedlog-odluke za formiranje Komisije za ocjenjivanje;
5. Razmatranje i usvajanje strategije za lokalni ekonomski razvoj za opštinu Prizren 2024-2029.;
6. Finansijski izvještaj januar - jun 2024;
7. Informacija o završetku školske;
8. Podaci o stanju vodosnabdijevanja, upravljanja otpadom i električnom energijom;
9. Izveštaj Saveta za kulturno nasleđe Istorijskog centra Prizrena za period avgust 2023- jun 2024.



Predsedavajuća KPF-je
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRIZREN BELEDİYE MECLİSİ

Siyasi ve Maliye Komitesi

No. 001/060 – 86709

Tarih: 8 Temmuz 2024

Prizren

03/L - 040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 52. Maddesi ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 59. Maddesi, 1. Fıkrası gereğince, **16 Temmuz 2024** tarihinde (**Salı günü**) saat **10:00** da "Beyaz Evde" SMK oturum salonunda düzenlenecek olan Siyasi ve Maliye Komitesinin toplantısını çağırıyorum. Bu yüzden, toplantının belirlendiği tarih, saat ve yere bağlı kalarak Siyasi ve Maliye Komitesi üyesi niteliğinde toplantının çalışmalarına katılmak üzere davet ediliyorsunuz.

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

GÜNDEMİ
öneriyorum

1. 26 Haziran 2024 tarihinden tutanağın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Belediye mülkiyetini sivil toplum kuruluşlarına kısa vadeli kullanıma vermekle ilgili daha önceki öneri-kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
4. Değerlendirme Komisyonunun oluşturulması için öneri-kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
5. 2024-2029 Prizren Belediyesinin yerel ekonomik kalkınma stratejisinin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
6. Ocak-Haziran 2024 dönemi Finans Raporu;
7. Öğretim yılının sona ermesiyle ilgili Bilgisi;
8. Su, atık yönetimi ve elektrik enerjisi tedarik durumu hakkında Bilgi;
9. Ağustos 2023 – Haziran 2024 dönemi için Prizren Tarihi Merkezi Kültürel Miras Konseyinin Raporu.



SMK Başkanı
Antigona Bytyqi

Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 77033

Më: 26 qershor 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 26 qershor 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:12 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj dhe Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj dhe Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës, Sulltan Badalli nga DEF, Çelë Lamaj, nga DSHP, Eleonora Fetollari nga Zyra për Integritim Evropian, Lajde Kolgjeraj nga Këshilli për Fshatin Zym i Hasit, Përfaqësuesi i OSBE-së, si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkryetar, të nderuar zyrtar të drejtorive, përfaqësues të OSBE-së media, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Siç jeni të njoftuar për sot kemi thirr mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. Për rend dite kemi këto pika:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 28 maj 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (2025-2027);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
5. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2024;
6. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës për Integritim Evropian për vitin 2023;
7. Raporti i Këshillit të fshatit Zym i Hasit për periudhën janar-qershor 2024;

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 28 maj 2024;

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar rreth procesverbalit? Në qoftë se jo atëherë po e hedhim menjëherë në votim. Prezent jemi nëntë anëtarë. Kush është për? Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e dytë,

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i ditës.

Antigona Bytyqi: Nëse ka dikush diçka rreth të ditës? Po urdhëro Karanfil.

Karanfil Haxhillari: Në qoftë se shkojmë në drejtori i financave për ditën e tretë këtu koka, të katërtën po. Tash raporti i punës së kryetarit, koka Nënkryetari si gjithë dhe kryetari si gjithë s'koka! informatë të Zyrës së Integriteteve Europiane është, po në raportin e fshatit Zym të Hasit?

Egzona Hoxhaj: E kemi Lajden këtu.

Karanfil Haxhillari: Ah po paskëm harru! Neve në seancën e fundit e kemi pasur pikën e rendit të ditës e cila mbetë as anej as knej. Pra, subvencionimin e bizneseve në Shatërvan, aty ku është prolonguar puna për një kohë të gjatë, e patëm futë në rend të ditës në seancën e fundit, pastaj mbetë pa kuorum dhe nuk e pamë këtu që është vendosur. Se tash ligjërisht apo me qysh duhet, ajo duhet me u bajtë edhe me u trajtuar në këtë seancë. Edhe propozoj që atë pikë të rendit të ditës ta qesim edhe ta diskutojmë edhe në mbledhjen e nesërme.

Antigona Bytyqi: Jo s'ka pasur aspak problem me e pas qitë, por na e lënë që me u mbledhë shefat e grupeve dhe siç u mblodhëm, ishit edhe ju prezent edhe me pa se çfarë po vendosim. Atë ditë unë me sa e pashë shumica pothuajse gati të gjithë përveç juve. Jo që nuk ishim për me e përkrahur por për shkak të mungesës së materialit edhe ku me u bazuar, e lamë që ju thatë që në qoftë se përgatisim diçka e sjellim në KPF. Personalisht nuk kemi diçka kundër kësaj pike, por në qoftë se keni përgatitur ndonjë propozim-vendim, meqë ishte edhe propozim nga ana e juaj. Me sa e di ne kështu u dakorduar, në qoftë se keni diçka gati, e qesim për sot.

Karanfil Haxhillari: Jo, na mbetëm, domethënë në diskutim s'u morëm vesh në fakt për kurrëgjë. edhe LDK-ja mungojë në mbledhjen e shefave të grupeve, por edhe e lëmë që a e lëmë që të vijë si pikë e rendit të ditës dhe pastaj në seancë të vendoset të votohet apo mos votohet. Por ama si pikë e rendit të ditës, me unanimisht me gjithë votat e kuvendarëve ajo u votua si pikë e rendit të ditës. Apo jo në gabim? Ajo u votua në komplet votat e kuvendarëve dhe tash opa u heq! Unë konsideroj që duhet me u kthyer si pikë e rendit të ditës, të diskutohet në kuvend, të shtjerret debati edhe në fund votojmë për, kundër, kjo është komplet çështje tjetër. A si pikë e rendit të ditës në kuvend vetëm u votua edhe u fut si si pikë e rendit të ditës.

Antigona Bytyqi: Me sa mbaj mend na e lamë me i konkretizu lokalet, qysh tek, tash është pa material! Po Bajram, urdhëro.

Bajram Kastrati: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Po në takim me shefat e grupeve e diskutuan këtë pikë edhe zyrtari ligjor tha që nuk ka bazë ligjore me shqyrtuar. Kështu që ne edhe tu drejtuan Fil edhe atë ditë. Nëse dhe sot ka bazë ligjore edhe e dinë që mund me e kaluar atë nuk është problem, ne me shqyrtuar e me diskutuar atë temë e diskutojmë pa problem. A di veç mos

mbetet se përderisa u përmendën takimi me shefat e grupeve. Kështu ne e lamë edhe në fund. Nëse ka bazë ligjore, ti e di që vazhdimisht jeni edhe kundër këtyre pikave që po shkojnë dhe po na kthehen jo ligjore. Tash ne e kemi zyrtarin ligjor këtu. Nëse ka bazë ligjore, edhe unë jam për, tash edhe të tjerët le të deklarohen secili. Ama përderisa s'po ka sipas zyrtarëve ligjorë, qysh nuk e di sa ja vlen me!

Karanfil Haxhillari: Bajram na e diskutuam, vetë drejtori tha që për faljen e qirasë edhe të tatimit të karrigeve, të shfrytëzimit të hapësirave, ka bazë ligjore. U pajtuam që bazë ligjore për subvencionim domethënë TM1 dhe TM2, ato të cilët ishin për subvencionim me pare kesh, aty ishte domethënë dyshueshmëria që s'ka bazë ligjore edhe në rregull. Mirëpo për dy propozimet e para unë konsideroj që ka bazë ligjore. Për dy propozimet e para të pikës së rendit të ditës. Domethënë, t'ju falet qiraja për muajt të cilët e kanë pësuar, edhe atyre të cilët i kanë objektet e komunës, edhe hapësirat publike që i shfrytëzojnë dhe që i paguhen komunës, për këto të dyja na mundemi.

Bajram Kastrati: Po tash le të njoftohen edhe kolegët, po ishte pyetje për katër ose pesë lokale, për pesë lokale, të tjerët po mbesin do të thotë pa u përkrahur përderisa s'kanë objekte të komunës. Le të njoftohen edhe bashkarisht ne po vendosim se s'ka kurrfarë problemi për me rekomandu për në mbledhje.

Antigona Bytyqi: Po urdhëro Florent.

Florent Ukaj: Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Tash po foli edhe pak në emër të LDK-së. Ne si LDK nuk jemi kundër që të mbështeten bizneset edhe pse pak për mua personalisht mu duk pak si paarsyeshme kur e dimë që shumica aty bizneset kanë punuar. Domethënë e dimë edhe vetë ne secili e frekuentojmë shtatërvanin, nuk dimë cili, pengesa normal që kur punohet ka ka me pas gjithë. Ama unë nuk di një lokal aty që e ka pauzuar punën gjatë kohës së punimeve. Edhe tjetra, na më me rëndësi është e sata herë që e ngris personalisht si si kuvendar çështjen e dëmeve që janë shkaktuar në bujqësi. Unë mendoj që është shumë më e rëndësishme dhe shumë më e nevojshme që të mbështeten, ta krijojmë një fond të veçantë për buqit të cilët kanë pësuar fatkeqësi natyrore vitin e kaluar e dimë të gjithë. Kur aty janë të gatshme, janë me lista, me dëme sa sa ju kanë shkaktuar dhe hala asnjë cent nuk e kanë marrë prej cilitdo institucion, që nuk po du me me gjujt o komuna, o ministria po e di që u bë një komision prej komunës, janë dalë në terren. Kjo po i bie si një formë si mashtrim i përbujqit. Janë vlerësuar dëmet, u shpall u bë publike lista e dëmeve kujt sa i ka shkaktuar dëme në bujqësi. Ata me i ymyt që jo dikush në vit të ri, jo dikush në qershor, e dikush në mars, jo ministria, jo komuna, jo emergjenca edhe nuk kanë, nuk dinë bujqit hala, i ka mbetur një listë aty nga sa i takon edhe nuk kanë asnjë mbështetje. Prandaj nuk jemi apert po them, nuk jemi kundër me i përkrahur bizneset në Shadëran, çdo herë do të jemi pro çkado që i takon komunës ose neve si kuvendar me bërë për të zhvilluar aktivitetin, por besoj që më urgjence është të mbështeten Buqit në komunën e Prizrenit. Kur e dimë që komunat po e marrë për shembull Rahovecin është i mbështetur, buqit e komunës së Prizrenit, ende asnjë gjë nuk kanë marrë nga fatkeqësitë, edhe më së shumti fatkeqësi ka pasur në komunën e Prizrenit se në çdo komunë tjetër. Unë vetë vij prej një anës ku ka pasur jashtëzakonisht dëme të mëdhaja dhe nuk jam mbështetur asnjë cent. Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Florent. Po urdhëro Nënkrjetar.

Kujtim Gashi: Faleminderit Kryesuese, ju përhëndes të gjithëve. Në fakt këtë temë e kemi pasur në seancën e fundit, e kemi diskutuar, shumica në parim e kanë mbështetur dhe ne në të njëjtën kohë. Por duhet ta kemi parasysh që punimet tash janë duke zhvilluar gjatë gjithë kohës edhe në Shadërvan edhe në zona të tjera, edhe në fshatra, edhe në fshatra ka lokale, ka biznese që operejnë. Domethënë nuk është vetëm Shadërvani, ka lokale gjithë andej, në Tusuz ka, në Bajram Curr ka, në Bazhdarhane ka. Domethënë pengesë në punime gjithmonë ka me pas. Tash a doni me krijuar precedent çdo herë sa zhvillohen punimet, me u çu komuna dhe me i larguar pagesat për bizneset, mendoj që është gabim, se dëmtohet buxheti në përgjithësi. Edhe aty nuk janë ndalë bizneset për të punuar, ka pasur vështirësi, është e vërtetë. Po punimet e kanë filluar me 8 mars edhe po shkojnë drejt fundit. Shadërvanit sigurisht që po i kthehet një farë shkëlqimi që i ka munguar viteve të fundit, jo për shkak ndoshta të politikës, por shkak që ka vite e vite që s'është investuar. Mendoj që ata më shumë sesa gjithë tjerët kanë me ja parë hajrin këtij investimi. Ne krejt çka mundemi me bë sot me marrë vendim sot, me marrë vendim me i larguar prej pagesës së hapësirave publike, kjo është e tëra, kurgjo tjetër s'mun bëjmë. Me i subvencionuar bizneset ne nuk mundemi, duhet me pasur vendim të qeverisë ose me ligj. Ne e kemi një Rregullore e cila i ka specifikuar krejt pagesat e taksat, për me u përjashtuar ajo Rregullore ka punë. Kështu që s'është mirë me marrë vendime që kthehen prapë edhe veç nuk kanë ndonjë efekt kështu juridik. Edhe aty një pjesë e lokaleve janë të komunës, ata paguajnë qira, kanë kontrata, nuk i kanë qiratë kushedi sa të mëdhaja në raport me ata që i shfrytëzojnë prej privatëve që i kanë edhe njëherë më të larta qiratë. Edhe nëse veç vendoset për me i liruar nga pagesa e hapësirave publike, duhet të ketë një analizë, kush po lirohet, sepse mundet dikush me u diskriminuar. Te dikush është punuar më shumë, një pjesë e shadërvanit është punuar pak më shumë, te pjesa tjetër është punuar më pak, sepse janë kry punët më shpejtë. Omethënë ka rrethanat të ndryshme në këtë projekt që po realizohet. Kështu që pa pas një analizë të mirë të drejtorisë edhe të financave, edhe të urbanizmit, edhe të inspektoriatit me dalë me një raport, sepse ndonjë lokal s'ka punuar, sepse lokali kushtimisht po e them i Çeles 10 ditë, i Sulltanit dy ditë edhe nuk mundet njëjtë me u trajtuar si atij dhe si i këtij. Kështu që nuk ka diçka për ngutë, nëse veç vendosni është mirë me pas një komision, e cila paraprkishtë e bën një raport. Se aty ka lokale po them edhe njëherë kur pat thënë Bujar Hasani dhe kur e kemi bërë 20 cent pagesën për metër katror, janë quditë sepse ka lokale që ka që qarkullon 10.000 euro në ditë. është raport i Administratës Tatimore të Kosovës. Kështu që që është mirë me ruajtë institucionin.

Antigona Bytyqi: Po Karanfil urdhëro pastaj

Karanfil Haxhillari: Thjeshtë nëse edhe njëherë domethënë për procedura. Ka ardhur si propozim i një pike të rendit të ditës së re në kuvend të seancës së kaluar. Ajo pikë e rendit të ditës është votuar nga kuvendi dhe ka hy si pikë e rendit të ditës. Dhe kjo pikë e rendit të ditës edhe pasi është votuar nga gjithë kuvendarët, nuk është diskutuar për shkak të mungesës kuorumit. Thjeshtë unë nuk po dua me paragjyku votimin, tash na në KPF jemi, mirëpo ta qesim në rend dite, ta diskutojmë pikën e rendit të ditës të propozuar dhe të votuar dhe pastaj le të vendosin kuvendarët, kur shtjerret debati, le të vendosin kuvendarët çka me bë për këtë pikë të rendit të ditës. Kaq e thjeshtë është. Unë nuk po dua me hy, pastaj janë ato që janë zyrtarët ligjorë çka mundemi dhe çka s'mundemi, mundemi me bë një komision që mirret me këtë punë, gjithçka mund të del prej kuvendit, domethënë prej atij kuvendit. Unë nuk po dua me votuar menjëherë me marrë diçka sepse shumë të qartë ishim edhe në seancën e fundit. Por të bëjmë diçka, ta ndimojmë dikënd gjithmonë në suaza ligjore që mos me mungu dhe mos me na u kthyer mbrapa. Sa i përket bujqëve Florent,

lirisht propozojë si pikë të rendit të ditës, në këtë rast sepse këto janë dy sene të ndame a po kupton? Edhe në rregull. Kjo ishte komplet logjika që ta kemi si pikë të rendit të ditës edhe të diskutojmë.

Antigona Bytyqi: Po si procedurë normal është dashtë me kanë, po meqë e thatë në foltore, që me u mbledhë shefat e grupeve, pastaj çka vendosim dhe kjo është arsyeja pse nuk ka hy në rend dite.

Karanfil Haxhillari: Po nuk vendosëm kurrgjë Kryesuese, edhe u mbledhëm edhe nuk vendosëm kurrgjë.

Antigona Bytyqi: Po edhe tu drejtuan ty edhe e morët me sa më kujtohet mua si përgjegjësi me e përgatit, se edhe propozim-vendim çka me e përgatit? Pa material s'di qysh e qesim si pikë. Këtu ishte problemi edhe e lamë që në qoftë se për sot përgatitet diçka, e qesim pa pikë problemi. Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: Ju krahas që po pyetni a ka bazë ligjore, duhet me pyet a ka edhe vullnet kjo qeverisje? Unë nuk po shoh vullnet! Ne jemi asambleist edhe shumë po kërkohet punët e zyrtarëve ligjorë me i bë na, ose punët e ekzekutivit. Propozimi ka kaluar procedurisht ishte dashur me kanë në rend dite. Ne nuk jemi tash këtu për me diskutuar a duhet me u votuar apo jo. Kuvendi vendos a duhet me u votuar apo jo. Ajo ka kaluar në seancën e kaluar me vota unanime. Mos po hapim hapësirë, mos me pasur vlerësimin e votimeve që bëhen në kuvend edhe a mos po e zbehim kuvendin me këto veprime, nën një. Në dy, ne i kemi propozuar tre opsione. A bash tre opsione s'po bëjka, s'paska asi bazë ligjore a? Të parën e dimë që ka bazë ligjore. Unë nuk e ngoj atë, nuk e ngoj më zyrtarin ligjor.

Bajram Kastrati: Atëherë kan duhet me ngu?

Dafina Alishani: Tash as unë s' di, po nëse kemi njerëz me aktakuza që janë hala në pozita, unë nuk muj me marrë më për bazë, po më vjen keq. Nëse kemi zyrtar ligjor që nuk e merrë përgjegjësinë në asnjë vendim që kthehet, unë nuk po du ma me marrë përgjegjësinë ose nuk po du edhe me ngu. Se neve këtu po na paketohen do vendime duke thënë që janë të ligjshme, kur po kan vullnet. A kur s'po kam vullnet valla s'di a ka bazë ligjore, nuk është e sinqertë kjo. Prej tre opsioneve nëse një nuk mundemi ne si kuvend me e shtyrë, atëherë kjo është veç për reklamim po bëjmë aty që po themi po jemi për biznese, por në fakt nuk jemi. Karrikat është sendi më i lehtë që mundet komuna me ja falur për një vit bizneseve. Ju po e merrni këtë që shadërvanit si tanësi i ka ra puna.

Kujtim Gashi: Po tu doket.

Dafina Alishani: Jo bre nuk po duket. Po jo bre unë e frekuentoj, po çdo ditë po pritoj me dalë aty. A e di pse? Sepse është katrahurë, shumë mirë që po punohet.

Çelë Lamaj: Shihe, a ka një karrigë që është e lirë aty.

Dafina Alishani: Si opsion me e parë, veç pak se nuk e përfundova. Për me e parë se qysh ka qenë puna më herët edhe qysh është tash, na e propozuam me pas të ardhurat e para gjashtë muajve edhe tash, me bërë krahasimin edhe me vitin e kaluar. Që me pas një pasqyrim, a ka pasur rënie apo nuk

ka pasur? Po ju e dini vetë edhe qytetarët janë duke pritu se dorën në zemër, dil në Shadërvan një rrugë është e mbyllur, tjetra ku po do me pi ti kafe krejt pluhur e ki. Prap po them, shyqyr që po punohet. Po nuk mujmë tash me thënë, nuk ka ndikuar hiç në biznese.

Çelë Lamaj: A ka mundësi kryesuese vetëm për sqarim.

Antigona Bytyqi: Po urdhëro drejtor.

Çelë Lamaj: Më erdh mirë që Nënkryetari në mënyrë shumë profesionale e qartësoj. Në komunën e Prizrenit momentalisht realizohen përmbi 100 projekte në infrastrukturë. Drejtorja e Shërbimeve Publike e dini që bënë infrastrukturë nëntokësore deri në infrastrukturën tokësore, jo mbitokësore. Edhe tash nëse kështu sinqerisht bëhet presedant nëse një biznesi në Shadërvan duhet me e subvencionuar, edhe një biznesi tjetër që ka qenë në rrugën prej shtëpisë së kulturës të cilën e ka hapur një kanal, KfV-ja gjermane dhe ka mbetur dy muaj ditë derisa nuk është implementuar projekti. Krejt lokale janë aty, edhe aty nuk kemi pasur një ngritje të një çështje të tillë. Nëse fillojmë kështu, çdo pjesë të qytetit, s'është veç shadërvani, ka pasur zëra që në shadërvan ka ra puna, në shadërvan nuk ka ra puna, në shadërvan punohet.

Dafina Alishani: Ku po bazoheni?

Çelë Lamaj: Midis Minhenit, tre vjet është një pjesë e madhe e sheshit të tyre kryesor, s'po ja di tash emrin, kush e di mundet me e thënë, që punohet në restaurime, janë bllokuar edhe nuk ka as protesta, nuk ka as shqetësime që punohet. Bile bile thuhet, po ta them kështu profesionaleisht thuhet, nëpër vende historike ku ka punime, turizmi vërshon më shumë. Pse? Don me pa qysh po e punon ai kalldërmin. Domethënë sot shadërvanin mos ma krahasoni as me para 10 vitesh, as para katër vitesh. Më shumë ka sot se para 10 vitesh qarkullim shadërvani. Më shumë ka sot qarkullim shadërvani sesa para katër vitesh apo dy vitesh. Çdo vit e më shumë turizmi o ka i kthehet shadërvanit. Sa për informacionin e juaj në bazë të statistikave vetëm kalaja e Prizrenit gjatë ditës i ka përmbi një mijë vizitorë, krejt ata kalojnë mes shadërvanit.

Karanfil Haxhillari: A bën i thu nesër këto drejtor? Te shtimë pikë të rendit të ditës edhe e diskutojmë proceduralisht edhe nesër edhe i thoni edhe nesër në seancë.

Kujtim Gashi: A bën veç pak se është në kontekst të asaj që ju tha. Se e tha Dafina që vullnet, vullneti politik është treguar atë ditë në seancë. Edhe prej anëtarëve tonë të cilët e përfaqësojnë subjektin tonë politik, edhe qeverinë në kuvend. Po dhe tash po e ripërsëris që ky vullnet edhe ekziston edhe ka me ekzistuar gjithmonë se ne për bizneset jemi tuj e bë.

Karanfil Haxhillari: Po pse tash s'jemi tuj e bë për.

Kujtim Gashi: Po. Ju s'e vendosni atë punë. Unë e po tregoj.

Dafina Alishani: Po na e kena vendosur në seancën e kaluar.

Kujtim Gashi: Ju s'keni vendos kurgjo, a e din pse s'ke vendosur? Sepse propozuesi me një pikë të rendit të ditës vjen me material. Çfarë keni me votuar? A më kallxon çfarë keni me votuar?

Dafina Alishani: Faljen e hapësirave publike.

Kujtim Gashi: Kujt?

Dafina Alishani: Qysh kujt? Qendrës historike.

Kujtim Gashi: Po s'mundesh ashtu.

Dafina Alishani: Pse?

Kujtim Gashi: Se duhet me pas një raport kujt ke me ju falur me emër dhe mbiemër, nuk shkon shabllon qysh po mendoni ju? E ke rregulloren ta ka përcaktuar qysh lejohet falja e borxheve.

Karanfil Haxhillari: E këtë asambleisti duhet me e bë a?

Kujtim Gashi: Propozuesi, ai djali, ai Sokoli aty po di krejt senet me i thënë se është jurist i njohur. Pse s'po e bënë propozim-vendimin? Shumë e thjeshtë është kjo.

Karanfil Haxhillari: Propozuam njëherë, ju po mendoni që asambleistët duhet në formë ligjore me i përpiluar nenet edhe këtë gabim.

Kujtim Gashi: Tash a e keni marrë përsipër, çfarë është propozimi juaj? Propozoje.

Dafina Alishani: A po e sheh që s'ke vullnet.

Kujtim Gashi: Jo kam vullnet, unë ta rregulloj këtë punë për një orë.

Dafina Alishani; Jo se me kanë naj hapësirë publike për naj biznesmen a di qysh aktivizoheni?

Kujtim Gashi: Jo jo, nuk qëndron.

Dafina Alishani: Po qysh jo, kur ju po keni interes.

Kujtim Gashi: Edhe pse s'dasha me bë temë, po doni me bë politikë.

Dafina Alishani: Kujtim, nuk është bre temë, a po diskutojmë mes meje dhe teje. Ajo është votuar në kuvend prej shumicës së asambleistëve. Edhe duhet me respektuar vendimin e asambleistëve me kap me qitë në kuvend. A kalon, a nuk kalon, është vendimi i kuvendit. Ju po i harroni diçka, punën e ekzekutivit me legjislativin.

Kujtim Gashi: A e din çka, veç sinqeritet s'ka në qet propozimin e juaj. Se në mënyrë jo të sinqertë veç po doni me bë një farë zhurme, pa bë zgjidhje. Unë po ju tregoj me bë zgjidhje para se me bë zhurëm.

Dafina Alishani: S'është hera e parë që propozojmë ne.

Kujtim Gashi: Po n'varet prej specifikave çka po propozon. Tash një tuj dashtë me ra në kundërshtim me një rregullore që e ke votuar para shtatë apo tetë muajve.

Dafina Alishani: Çka vjen prej anës tonë prej opozitës tash nuk bën. jeni të barrikaduar.

Kujtim Gashi: Bëjeni bëjeni.

Dafina Alishani: Ju po e dishit që shadërvani po punon, ne po e dimë që s'po punon. Neve po na kontaktojmë bizneset.

Kujtim Gashi: Përditë po punojnë, mbrëmë bile kam pi kafe.

Dafina Alishani: Ani të bëftë mirë. S'është normale se njerëzit nuk kanë kohë. Ose qaj shadërvan s'është aj i jonë që ne po e dimë ose ju jeni me një shadërvan tjetër.

Dafina Alishani: E kjo është mirë, varet me cilin sy e shikojmë.

Çelë Lamaj: A dalim, a dalim bashkë edhe e shikojmë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, fjalën Florenti pastaj Bajrami.

Florent Ukaj: Ne e kemi një propozim konkret. Raporti raporti është domethënë krejt këto që i kërkohen. Kemi një propozim që të mbështeten bujqit për vërshimet dhe fatkeqësitë natyrore që kanë ndodhur në vitin 2023.

Kujtim Gashi: Këtë qeveria e ka.

Sulltan Badalli: Po, veç i ka shkuar raporti qeverisë, Bexhati dje e raportoj.

Kujtim Gashi: Në çdo çdo mbledhje të qeverisë nga një komunë e kanë.

Florent Ukaj: Domethënë qe ky topi qeveri komunë qe një vit drejtor është tuj asi. A mundemi ne si komunë me bë një, me nda një fond të veçantë për dëmet në fatkeqësi natyrore që kanë ndodhur.

Sulltan Badalli: Qeveria e ka marrë përsipër.

Dafina Alishani: Le qeverinë, kryetari ka premtu në fushatë me qeto që ka me i përkrahë.

Levent Bus: Edhe unë jam për këtë që e kena votu me qenë në rend dite, por siç tha Nënkrjetari një pjesë kena me liru një pjesë jo, edhe pse bash 1 vjet.

Dafina Akishani: Qysh 1 vjet.

Levent Bus: Qashtu qysh e keni propozu.

Dafina Akishani: Gjashtë muaj është, nuk po bëhet 1 vjet.

Bajram Kastrati: është 6 muajt e kaluar dhe gjashtë muajt e ardhshëm.

Levent Bus: Tash na nëse e lejojmë gjashtë muaj shadërvanin, ka pasur punime edhe në bazhdarhane dhe vende tjera. Tash nëse ne e marrim një vendim, duhet me marrë për krejt vendim sepse nuk po punohet vetëm në shadërvan, tash po punohet edhe këtu te ëmbëltorja që s'po punon, tash duhet edhe për aty me marrë vendimin, na s'mundemi vetëm për shadërvanin me marrë. Po e qesim në rend të ditës edhe e bëjmë një hulumtim dhe po i shohim dëmet për krejt e jo vetëm për shadërvanin, krejt i kemi dostat aty nuk është problem edhe për shadërvanin jemi të gjithë për me përkrah, vetëm tash në bazhdarhane po punohet intenziv edhe njeri s'ka ku me punu, e ka mshel lokalit ëmbëltores e di se e kam shok vetë, tash atë pjesën jo, qet pjesën po. Nesër pasnesër kur të dalim ne në teren na thojnë jo valla kqyre ti shadërvanin tash.

Çelë Lamaj: Nesër i kemi vatrat shqiptare, edhe aty janë lokale, domethënë dëmtohet buxheti i komunës duhet me pas të qartë këtë.

Egzona Hoxhaj: Na duhet me me bë një komision edhe me këqyr në secilën pjesën ku punohet.

Karanfil Haxhillari: A jeni duke kuptuar? Ta qesim pikë të rendit të ditës, të diskutohet dhe prap kuvendi merr vendim.

Kujtim Gashi: Lereni se është tuj dashtë me bë politikë, në rregull është.

Bajram Kastrati: Kryesuese, në takim me shefat e grupeve, ne e kemi kemi diskutuar në detaje edhe kush mund me u kanë përfitues. Qysh edhe s'ka qenë veç një një zyrtar ligjor, kanë qenë dy zyrtar ligjorë. Na do të thotë e kemi diskutuar. Unë e kam pritur sot Fil që ti me ardhë me një propozim më konkret edhe me bazë ligjore, se qashtu edhe u morëm vesh. Bëni raportin, bile unë personalisht me sa më kujtojtohet tu drejtova okej, veç afrona ti.

Antigona Bytyqi: Po kështu e kemi lënë.

Bajram Kastrati: Në suaza të ligjit afrona një propozim konkret, ne kemi me përkrah, s'jemi kundër. Ne kur e diskutuam në detaje, sot su diskutua në detaje, atë ditë e kemi diskutu edhe kush mund me u kanë përfitues. Lokalet që janë privat s'mujnë me u kanë përfitues në asnjërën prej alternativave që i dhatë. Janë pesë lokale, ato i përmendim edhe me emra. Po. Tash me fillu ne po dalim në personale me njerëz që s'kemi nevojë me bë aq politikë. Qato lokale që u përmenden me emra është edhe prej teje personalisht është absurde me thënë u dëmtuan këto pesë lokale që u përmenden me emra, njëra prej tyre është edhe Beska. Edhe tash po i anashkalojmë ne disa të tjerë e po i përkrahim nja pesë veta që ndoshta janë edhe milionera me një shumë modeste që dëmtohet buxheti, dëmtohet, kuptohet. E tash unë prita përderisa e diskutuam ne në detaje, prita me ardhur ti me një propozim pak më konkret. Ti prapë po thua veç ta çojmë ne aty. Okej, po e çojmë, po e diskutojmë, prapë këto diskutime kanë me kanë. Unë personalisht kam me i pasur qëndrimet, ndoshta edhe me emra i përmend se kam atë problem, se s'po dua me bë politikë. Nuk është në pyetje politika këtu, po është në pyetje pse me ja humb kohën edhe kuvendarit me diskutu këtë temë. Edhe arsytimi i drejtorit, edhe i nënkryetarit, edhe i zyrtarëve ligjorë, po është.

Karanfil Haxhillari: Po mos e votoni bre Bajram.

Bajram Kastrati: Po mirë dhe atëherë po bjen që po bëhet veç politikë.

Florent Ukaj: Jo duhet me i marrë edhe përgjegjësitë që i kemi, tash s'mundemi me i ik ne tash përgjegjësitë që i kemi. Nëse mendoj unë që jam kundër me u fal Princi ka me dalë publikisht ka me thënë jo sepse ka punuar sepse kam pirë pave në Princ gjatë gjithë kohës edhe duhet me i përmend me emra, nuk kemi ne kurrjë hiç personale, edhe se kam problem. Tash ne me thënë se Getsbi s'ka punuar për mua është e pavërtetë sepse unë çdo ditë kam pi kafe në Getsbi. Ju po thoni veç pesë lokale, a po thoni hapësirat publike në shadërvan? Hapësira publike ka Getsbi, ka Princi, ka ajo tjetra Sylja, të gjitha. Tash nëse ne jemi me falë Princin, pa keq pa kurrjë hiç unë kam me kanë kundër. Po tash nëse ne jemi me fal tash Princin, me fal Getsbin, me fal Beskën, me fal Hyskën, këtë duhet me thënë publikisht, si unë, si ti, si secili, edhe nuk kemi çka me i ikë përgjegjësisë. Unë nuk jam kundër që me asi, por nëse ishte bllokuar me të vërtetë, nëse me të vërtetë nuk kish punuar Princi, nëse nuk kish punuar Sylja, unë isha kanë i pari që i kisha dalë në mbështetje të bizneseve. Unë nuk jam për me u mbështet asnjëri biznes aty përderisa nuk është i dëmtuar, nuk është e vërtetë që jam dëmtuar. Edhe duhet me thënë publikisht edhe pa marre, pa frikë se asgjë nuk ka të keqe këtu, kaq.

Antigona Bytyqi: Egzona fjalën edhe tani po shkojmë me votim sepse pak e zgjatëm!

Egzona Hoxhaj: Në fakt kryesor u tha qetash edhe prej Florentit edhe prej Bajramit. Ne po thojnë, okej, po e shtina në rend të ditës me pru një hulumtim, me pru një material. Unë nuk po besoj që prej këtij momenti që jemi duke folur ne deri nesër ka me mujt me ardhë ai hulumtim apo ai material. Domethënë për krejt neve është thjeshtë hajde pe shtina. Kështu që edhe përderisa s'ka bazë ligjore me u përkrah krejt bizneset, se janë private të tjerat që janë biznese krejt më të vogla që ndoshta janë shumë më shumë të dëmtuara sesa këto katër pesë biznese të mëdhaja.

Dafina Alishani: Kush po fol bre për biznese të mëdhaja? Ju po e thoni biznese të mëdhaja.

Egzona Hoxhaj: Po që ato janë në pronë publike, nuk po e thojmë ato që nuk janë.

Antigona Bytyqi: Kështu, njëherë i votojmë këto pikat e propozuara, mandej krejt dhe secila tani kemi me diskutuar sepse rendi i ditës u zgjatë shumë. Kështu. Propozimi i parë erdhi nga Fili, vetëm ta bëjmë emërtimin, të diskutojmë apo?

Karanfil Haxhillari: Pika e rendit të ditës të seancës së kalume qysh u kanë.

Antigona Bytyqi: Për subvencionim u kanë emërtimi

Florent Ukaj: Mirë se këta besoj e përgatisin nëse kalon na duhet me qitë në votim a kalon a s'kalon tjetër.

Antigona Bytyqi: Kush këta?

Florent Ukaj: Propozuesit.

Karanfil Haxhillari: Jo bre hiqet pika e tretë veç mbeten dy pikat e para.

Antigona Bytyqi: A ishte lirimi i hapësirave edhe?

Karanfil Haxhillari: Edhe qiraja. Kurse subvencionimi largohet domethënë i qarkullimit. subvencionimi i qarkullimit largohet që u kanë pikë e tretë e propozimit edhe mbetet veç me dy pika të para.

Antigona Bytyqi: E për qiranë a mundemi me bë diçka drejtor?

Sulltan Badalli: Veç pesë lokale janë, çka bënë me lokale të tjera që janë privat.

Florent Ukaj: Jo jo nuk caktohet pesë lokale, hapësira publike për krejt.

Sulltan Badalli: Jo hapësira publike, por qiraja e lokaleve tjera.

Bajram Kastrati: S'kish mundësi ligjore për këto tjerat.

Antigona Bytyqi: Për qendrën historike ka qenë. Kështu, propozimi që u bë nga Karanfli, prezent jemi nëntë anëtarë. Kush është për që të hyjë në rend të ditës përsëri? Sa jemi? pesë jemi për. Kush është kundër, zero kundër? Abstenim? Zero abstenim. Atëherë propozimi i parë hyn në rend dite. Propozimi i dytë që u bë nga Florenti, të ndahet fond për Bujqit. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Tani po e hedhim rendin e ditës të plotë për sot. Kush është për që të miratohet rendi i ditës, bashkë me propozimet e reja? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Antigona Bytyqi: Po drejtor fjala për juve.

Sulltan Badalli: Po, faleminderit. Përshëndetje për të gjithë. Pra buxheti siç e dimë është një dokument i rëndësishëm i organizatës buxhetore faktikisht komunës i cili miratohet çdo vit. Duke filluar nga qarkorja e parë që na ka ardhur më 15 maj 2024, në të cilën janë vendosur projektet buxhetore të buxhetit për komunën tonë. Pra ky buxhet përbëhet nga granti i përgjithshëm, granti i përgjithshëm janë 28.389.000 euro, te arsimit kemi 19.383.000, shëndetësi 6.543.000, financimi i qendrës historike të fshatit Zym dhe të tjera janë 51.532 euro, teatro 263.000 euro, për shërbimet rezidenciale janë 100.980.000 mijë euro, si dhe për shtëpinë e komunitetit për persona të moshuar 179.000 euro. Pra garanti i përgjithshëm është i caktuar nga qarkorja e parë buxhetore është 55 milionë e 8 euro. Ndërsa të hyra vetanake është në limitin po ashtu që është i caktuar nga qarkorja buxhetore është 10.193.000. Pra total 65.201.979 euro. Mirëpo në këtë rast te komuna e Prizrenit e kemi edhe kredinë apo huamarrjen që janë ndarë për vitin 2025, janë 1 milion euro që totali me gjithë huamarrjen është 66.201.979 euro. Pra, ky është buxheti i tërësishëm sipas kufijve të cilët na ka caktuar Ministria përmes qarkorës së parë. Mirëpo ky ka me pas ndryshime, jo si total, por si nëpër kategori, sepse kemi edhe qarkoren e dytë e cila do të na vjen me 15 korrik edhe do të ketë

ndoshta ndryshime të vogla. Ndërsa nëpër kategori buxheti është për paga janë ndarë 26 milionë 406.000, mallëra dhe shërbime 12.740.000, shërbime komunale 1 milion, subvencione 4 milion dhe më falni se është tjera, 28 milion e 102 mijë e 24 euro, 14 milion mallëra dhe shërbime, 1.055.000 janë shërbime komunale, subvencione 4.561.000, si dhe investime kapitale 21.425.000. Pra ky është buxheti i tërësishëm i komunës, i cili mundet me pësuar ndryshime të vogla, kur vjen qarkorja e dytë, kemi edhe te pagat mundet me pësuar ndryshime sepse sipas ligjit të fundit mbi Menaxhimin e Financave Publike nga ministria që ka ardhur, çdo vit koeficienti në bazë të Ligjit do të rritet për 5 euro. Tash do të ndryshojë apo nuk do të ndryshojë, presim që derisa të na vjen qarkorja e dytë buxhetore, që do të thotë është më 15 korrik. Faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. A dëshiron dikush me marrë fjalën rreth kësaj pike?

Karanfil Haxhillari: Në bazë të Kornizës Buxhetore Afatmesme, qysh po e shoh unë projekte të reja të paraqitura shumë pak. Domethënë, pothuajse të gjitha qenkan projekte në vazhdimësi të tre viteve të kaluara, sidomos te Drejtoria e Shërbimeve Publike asnjë projekt i ri nuk tek koka në bazë të kësaj investimeve kapitale që po i shoh. Në administratë as kode buxhetore nuk kanë projekte. Në turizëm paska diçka dhe në drejtoritë të tjera, domethënë shumica është vazhdimi i projekteve të. Por edhe në disa projekte specifike sidomos normal thënë gjuha shkon ku dhemb dhëmbi. Nuk po e shoh që a do të jenë edhe këto investime të mjaftueshme? Për shembull po e marrim një pyetje drejtor , ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës! Është kodi 52118. A ka filluar ky projekt? Me sa e di unë këtu e kemi si projekt ekzistues. Në anën tjetër e di unë që kontrata veç është nënshkruar edhe paraqitet. Në qoftë se kalon KAB-i në rregull, por çka në qoftë se nuk kalon, po e marrim një një shembull të tillë. Domethënë a i bjen kjo që është nënshkruar kontrata pa i zotuar mjetet?

Çelë Lamaj: Ka mjete, sivjet fillon projekti.

Karanfil Haxhillari: A ka filluar ky projekt.

Çelë Lamaj: Po.

Karanfil haxhillari: Tjetra është, veç edhe edhe një pyetje se kjo rruga që e përmende drejtor prej Staneve të Strushës deri në Qafa Kushnit. Kjo rrugë unë besoj që e di, fillon te Stanet e Struzhës përfundon te Qafa Kushninit i bjen ku është lokali i Hafizi apo? Por me i ndarë vetëm këtu sa e pashë, domethënë vetëm edhe 70.000 euro ishin ndarë për këtë aks edhe vetëm për vitin e ardhshëm. Nuk janë të mjaftueshme drejtor se nuk e kryejmë. Në qoftë se janë bërë deri tash vetëm 1.7 km rrugë dhe pritet asfaltimi për këtë pjesën tjetër, nuk janë të mjaftueshme 70.000 euro për me kryer deri atje.

Çelë Lamaj: Projekti është vetëm deri aty, nuk është deri atje. Projekti nuk është 1.7, por është 1.5 km, sot asfaltohet edhe përfundon si projekt.

Karanfil Haxhillari: Sot thatë asfaltohet a?

Çelë Lamaj: Po po, asfaltohet sot. Në ora 13:30, shtresa e parë sot, shtresa e dytë nesër, nesër ti shko me kerr edhe shife.

Karanfil Haxhillari: Po jo se sun shkon kërkush se në gjysmë është. A dhe në gjysë.

Çelë Lamaj: Në gjysmë, atëherë tash propozone dhe futeni në buxhet për vitin 2025.

Karanfil Haxhillari: Drejtor, projekti është e Stanet e Struzës, Qafa e Kushninit.

Çelë Lamaj: Emërtimin e ka, ne e dimë shumë mirë që ka qenë projekti i ministrisë, ka qenë projekt i propozuar prej ministrisë, ka pasur një i cili gjatë hartimit të atij projekti atje kam bërë një farë, kam gjetur një farë dhe autostrade. Nuk ka mundur me u implementuar, është bërë revidimi i projektit. Edhe është tenderuar në bazë të situatës të cilën e kemi sepse është kanë parapa një rrugë diku 12 m, po ka pasur probleme se është një pjesë e projektit kish pas atakuar Malin Sharr, zonën e mbrojtur edhe normalisht që në ato zona na e dimë që ka shumë probleme për me mujt me zhvilluar infrastrukturë të re. Ne kemi bë revidimin e projektit, kemi marrë lejet dhe pëlqimet.

Katanfil Haxhillari: Domethënë qetu ka me mbetë, në 1.5 kilometër apo?

Çelë Lamaj: Po 1.5 kilometër sepse një pjesë e projektit e kish pas atakuar Malin Sharr, zonën e mbrojtur edhe normalisht që në ato zona ne e dimë që ka shumë probleme për me mujtë me zhvilluar infrastrukturën. Ne e kemi bë revidimin e projektit, e kena ba projektin.

Katanfil Haxhillari: Domethënë qetu ka me mbetë, në 1.5 kilometër

Çelë Lamaj: 1.5 km, edhe sa jesis Karanfil? Edhe pjesa tjetër ka me vazhduar në moment që komuna ka me pasë mundësi buxhetore dhe kena me vazhduar edhe kemi me bë edhe rrugë tjera.

Karanfil Haxhillari: Ama unë sa e di, propozues i këtij projekti jam unë. Kur propozohet një projekt nga një vend i caktuar, në një vend të caktuar, ajo duhet me u përfshirë krejt drejtor.

Çelë Lamaj: Unë nuk e di kush ka qenë propozues.

Karanfil Haxhillari: Se Qafa e Kushninit është një pozicion, hapësirë gjeografike, është diku 8 km.

Çelë Lamaj: Unë e kam gjetur atë projekt, atë projekt e kam bërë me buxhetin që e kemi pasë, kemi vendos që ky projekt mund të zhvillohet 1.5 km. Tash edhe 6.5 km tjera dashtë zoti, gradualisht në mandatin tjetër po të premtoj që kena me realizu.

Bajram Kastrati: Premtimi është borgj drejtor.

Çelë Lamaj: Borgj është, s'ka problem mandatin tjetër kena me e realizu.

Karanfil Haxhillari: Ama nuk po kryhet atëherë projekti. Sepse shihe kur ti thua një rrugë prej Petrovës deri në Arbanë po e marrim shembull edhe ti po e bënë prej Petrovës deri te rrethi i Tranzitit.

Çelë Lamaj: I kemi bërë një emërtim të tillë, ka mbetur qatë, është aksi i rrugës Stanet e Struzhës-Qafa e Kushninit, aksi i rrugës, i cili ky aksi implementohet 1.5 km edhe u krye.

Antigona Bytyqi: Po drejtor, urdhëro.

Sulltan Badalli: Duhet me ditë një diçka që ligji mbi ndarjet buxhetore i specifikon planifikimin e prioritetit të projekteve. Tash ne nuk mund me kaluar në projekte shumë të reja pa i kryer obligimet kontraktuale që kanë mbetur në projektet në vazhdimësi që janë. Edhe normalisht që numri i projekteve në vitin e ardhshëm normal zvogëlohet se ka obligimet që kanë mbetur që janë projektet në vazhdimësi që janë dhe s'mundemi me i lënë në gjysëm. Kjo është një rregull që e cakton ligji i buxhetit e caktuar, jo ne, ne mund me lëviz pak aty këtu, po prap duhet në vijë me nejtë ligjit që na cakton ligjin mbi ndarjet buxhetore. Për atë dhe ka më pak projekte të reja që kjo është arsyeja.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Naxhija fjalën e ka.

Naxhije Memaj: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Atëherë së pari kam një vërejtje. Dua të them se materiali nuk mu hap në email. Mirëpo e shfletova materialin që e kemi pasur për debat publik. E aty mes të tjerash e pashë një pozicion të DSHP-ja, ku për vitin 2025 për mallra dhe shërbime janë paraqitur 5 milionë euro. Kjo shumë mu duk tepër e lartë dhe e pa kuptim për këtë lloj pozicioni. Tash nuk po mund të kthehem më shumë në mungesë të listës së projekteve. Por kjo më la me kuptuar në këtë buxhet, ta shoh më shumë si buxhet elektoral dhe jo si buxhet real. Pra, për interesat të ngushta të individëve apo grupeve siç është siç është rasti me investimet e objektivit shtesë në shkollën Besim Ndreca në Lutoglavë e që ka mbetur si muze e drejtor. Megjithatë jam për me ja rekomanduar këtë pikë të rendit të ditës Kuvendit. Por unë zor se do ta votoj këtë pikë në Kuvend edhe për faktin se nuk janë marrë parasysh asnjëherë kërkesat e mia të cilat i kam paraqitur në Kuvend. Ju faleminderit.

Kujtim Gashi: Duhet ta kemi parasysh se edhe vitin e kaluar ka ndodhur kur u diskutu për Kornizën afatmesme, shumica kanë menduar që është buxheti. Korniza është kufijtë buxhetorë edhe nuk është i pandryshueshëm në vazhdim, sepse ka me ardhur qarkorja tjetër tash, varet çfarë po me na thënë edhe qarkorja, është shumë me rëndësi. Edhe e dyta arsyeja pse drejtorinë e shërbimeve publike i janë shtuar buxhetin për mallra, është për shkak se do projekte të mëdha si mbeturinat e këto, deri më tash janë investuar prej kapitaleve edhe kemi pasur vërejtje. Domethënë është detyruar me ndërruar kategorinë sipas kërkesës edhe të ministrisë edhe të raportit të auditorit. Kjo është arsyeja, veç është bërë lëvizje te kategoria.

Çelë Lamaj: Pastrimi i qytetit merr kontrata që i ka 3.5 milion.

Kujtim Gashi: Dometënë ka veç ndërrim të kategorive, nuk ka shtim.

Çelë Lamaj: Momentalisht drejtorja e shërbimeve publike me funksionu mirë, mallëra dhe shërbime lypet 5.5 milion.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Bajrami e ka fjalën.

Bajram Kastrati: Faleminderit kryesuese. Drejtor, ne i kemi do propozime që sigurisht për projekte i prezantoj nesër në seancë. Po veç desha një konsultë te projekti nëntë, instalimi i ndriçimit publik e kemi një një kod. Po tani te projekti 48 e kemi rregullimin e ndriçimit publik në Lëvizhdë të Hasit, ndoshta ka dhe diku tjetër po kjo më me rëndësi. A duhet me patjetër me i prezantuar do projekte që janë më të mëdhaja prapë me ndriçimin, përderisa e kemi ndriçimin një kod për krejt ndriçimin? Apo duhet, tash përderisa e kanë këta, sigurisht që unë e kam kërkesë për Arbanë, ka shumë që ka me u rregulluar ndriçimi publik, ka shumë rrugë. A duhet me patjetër me pas një kod të veçantë për atë pjesë, apo hyn në kuadër të atij kodi?

Çelë Lamaj: Më dëgjoni, ne kur të ka ardhur me u realizuar projekti si drejtorie e shërbimeve publike shkojmë me komplet infrastrukturën si ujësjellë, kanalizim, rrugë, ndriçim. Domethënë pavarësisht një kontratë të cilën sot e kemi rreth ndriçimit dhe mirëmbajtjes në komunë. Ndriçimin të cilin e kemi si kontratë që është një kontratë 2.5 milion, është kontratë kornizë tre vjeçare, aty intervenojmë nëpër gjithë ato lokalitete ku këtë infrastrukturë tjetër e kemi të rregulluar. Ne me pasur edhe tre kontrata nga 2.5 milion krejt komunën e Prizrenit është problem me e ndriçuar. Sivjet edhe këto tre vite mendojmë që diku 10.000 drita i duhen me këtë kontratë, tani mbi diku 10.000 drita e komunës së Prizrenit i hy 25.000. Deri tani tash i kemi diku 1300-1400. Kështu që çdo projekt të cilin e hapim si infrastrukturë, ujësjellës, kanalizim, rrugë, e fusim edhe ndriçimin publik që të jetë pjesë e asaj që ta kemi si infrastrukturë complete. Mos ta përziejmë që ne kemi me pas tash edhe tre kontrata të tjera ndriçimit publik, nuk ka mundësi për me u përfshirë. Kështu që e përfshim komplet infrastrukturën me një. Kështu që për Lubizhdë edhe e ke.

Bajram Kastrati: Këtu është veç rregullimi i ndriçimit.

Çelë Lamaj: Po kjo është kod, këtë e ke veç kod.

Bajram Kastrati: Atëherë po dashka me bë kërkesë ose propozim edhe për një projekt të ri për Arbanë.

Çelë Lamaj: Në Arbanë ne e kemi goxha një infrastrukturë të rregullime, kështu që unë e mendoj Arbanën me kontratën që e kemi, Arbana, Zhuri, Korisha e ka të veten, disa lokalitete më të mëdhaja mendoj me kontratën që e kam për me startuar me ndriçim publik. Kështu që prej muajit shtator me siguri kam me pas aktivitete mbasi përfundon qyteti edhe në këto fshatrat më të mëdhaja.

Bajram Kastrati: Mirë, a ke mi tenderuar tash rrugët e Arbanës ti?

Çelë Lamaj: Po, po qysh jo?

Bajram Kastrati: E Kur?

Çelë Lamaj: Menjëherë, pasi që të votohet, se pa u votuar pa pare qysh me krye punë Dafina.

Bajram Kastrati: Ani e bëjmë te Noteri ne një marrëveshje.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, fjalën e ka Florenti.

Florent Ukaj: Faleminderit Kryesuese. Atëherë ne e dimë që KAB-i nuk është përfundimtare. S'ka që është si projekcioni i pushtetit, dihet që është projekcioni ka me shku buxheti ne tashmë me KAB u paraqitë. Domethënë s'ki sa mujta me parë unë, kanalizim, kocka, nuk patë ndonjë projekt tjetër! Edhe shqetësuese besoj janë, sidomos nëpër fshatra, çka jeni tuj kovat, për mua është shqetësuese. Seriozisht po them, me shkuar me shtruar njerëzve oborre. Po politikisht nuk ju ndihmon, keni me u bind që politikisht kjo nuk ka me ju ndihmuar. Kushdo që po i bëni drejtor ato, me shkuar për një shtëpi, me ja shtruar oborrin me kocka.

Çelë Lamaj: Jo, s'ka shanca.

Florent Ukaj: Qe janë mediat poshtë, si KPF shkojmë krejt komplet kështu. Unë transportin ju siguroj. Shkojmë, çka jeni duke bërë në fshatin Piranë?

Çelë Lamaj: As te një projekt nuk mundet me bërë për zona private. Nëse ka planifikuar rrugë, shkojmë te noteri, e noterizojnë, ajo pjesë kalon në pronë të komunës në emër të rrugës edhe normalisht që ne jemi për me ja u rregullu.

Florent Ukaj: Ajo pjesë, ajo pjesë, tash a ka shku te noteri a jo, është problem tjetër Veç po ta vërtetoj unë. Është 5 metra rrugë, nuk është rrugë ajo, oborr është, po tash ai e ka mund me shku te noteri me thënë që kjo është rrugë edhe do shkoj jashtë.

Çelë Lamaj: Jo, noterit sun i thotë rrugë, thotë, unë këtë pjesë të ngastrës kadastrale, kaq metër katror i dorëzoh në kadastër, kadastri e regjistron si pronë komunale.

Florent Ukaj: Po nuk mund të bëhet rruja o drejtor se veç një shtëpi është aty, nuk ka ku me shku rruga aty, në oborr të atij.

Çelë Lamaj: 5 metra, 5 metra del në emër të komunës. Nuk ka mundësi me ndodhë ajo, nuk guxon.

Florent Ukaj: Edhe nëse është qashtu drejtor edhe nëse është ashtu për mua është e paarsyeshme për shembull me u lënë një pjesë me 10 shtëpi mos me u shtru sepse i përket një.

Çelë Lamaj: Për atë janë këshilla e fshatrave të cilët përcaktojnë prioritetet.

Florent Ukaj: Çka pashë në buxhet krejt kanalizim, infrastrukturë. Domethënë ato projektet që kanë nevojë në Prizren nuk po i shoh, si teleferiki, diçka më madhështore nuk po shoh! Jeni lëshuar veç në asfalt.

Çelë Lamaj: Prej ministrisë bre ky investim bëhet ne e kemi thënë saherë, Ministria e Kulturës ka me financu, është projekt i përbashkët.

Florent Ukaj: Edhe beso drejtor edhe nënkryetar nëse vazhdoni me këtë logjikë, gabim e keni. Nashta ju jeni më të mençur e ma ja dini që themi ne zanatin kësaj punës veç personalisht mendoj

që jeni duke gabuar dhe jeni duke krijuar precedant shumë të rrezikshëm që kush është me një parti me ja shtruar edhe oborrin, kush është me një parti tjetër.

Çelë Lamaj: Bëhen matjet gjeodezike, ai privatisht mundet me e shtruar oborr e me bë çka të don, Matjet gjeodezike që i bënë mbanë përgjegjësi prej menaxhimit të projektit nëse dikujt i paguhet një metër a gjysmë metri ka një kubzë në pronë private.

Florent Ukaj: Po e zëmë si po pajtohen plotësisht me ty në këtë rast. Pak a e din si institucion, si komunë, a s'është marre qashtu me vepru a, te marrja tash është puna. Me shku me shtru oborre njerëzve.

Çelë Lamaj: Si është shtru oborri, privatisht ai mundet me shtru oborri se sun e nali une.

Bajram Kastrati: Drejtor, megjithatë unë jam kundër kësaj që po thotë Lenti. Tani e kemi se unë kam telashe në lidhje me këtë. E kemi një rrugë që komplet del private edhe mas pakti ai aty duhet me ardhur te noteri.

Florent Ukaj: Edhe unë jam me shku te noteri me liru, edhe unë jam pro asaj që lagjia, mahalla për me pas.

Bajram Kastrati: Unë s'jam tuj e thënë atë, unë jam kundër me shku, te noteri se brenda një rrugës, i kemi rreth 100 veta, mos më shumë që duhet me shku te noteri. Ata 100 veta nja 60 s'janë këtu. Edhe ajo rrugë po mbetet komplet e lagjes veç se figuron nëpër prona private. Unë jam kundër kësaj edhe jam kundër me shkuar veç një personit me ja shtru rrugën deri te shtëpia. Ama veç me mbetur edhe komplet nja gjashtë shtatë familje, vetëm e vetëm që s'mund me i mbledh krejt me shku te noteri, drejtor qekjo është e papranueshme.

Çelë Lamaj: është vepër penale nëse ti.

Bajram Kastrati: Jo bre s'ka vepër penale se deri tash krejt janë shtru.

Çelë Lamaj: Mirë bre Bajram, unë jap përgjegjësi për punën time unë jap përgjegjësi.

Bajram Kastrati: Unë për projektin e Arbanës duhet me i marrë 1000 veta me i qu te noteri.

Çelë Lamaj: S'kam çka me bë, është vepër penale ti si operator me shtru pronë private. Nëse është rrugë që figuron.

Bajram Kastrati: A bënë ani me një nënshkrim mos me shku te noteri, a bënë me një nënshkrim?

Çelë Lamaj: Jo s'ban pa noter.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Egzona fjalën.

Egzona Hoxhaj: Unë i kam dy pyetje. Një për drejtorin e financave dhe një për nënkryetarin. Nënkyetar unë e kam një pyetje të parën konkrete, a është marrë parasysh prej secilës drejtori kur

janë bërë këto planifikime strategjia komunale për aftësi të kufizume. Se po shoh kështu ndërtimi i aneksit, shkollave, kulme, qasje, sende po prapë se prapë komunën në Prizren po vazhdon me qenë shkollat, krejt shkollat publike të paqashme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Edhe pyetja e dytë është edhe vitin e kaluar kur e kemi bërë KAB-in, u kanë e planifikuar ndërtimi i objektit të ri shkollor në Zym të Hasit, u kanë i ndan ky buxheti 500.000 euro për vitin 2025, tash ku ka bart në 2027. Atje është një kërkesë shumë e madhe e banorëve, atje krejt ujë është ajo shkolla, as nuk është shkollë mas pari herë. Kështu që nuk po besoj që është e nevojshme me u shty me u bartë kështu vite e vite përderisa më e rëndësishme është me u maru një në Zym të Hasit sesa me u bë qesi anekse nëpër shkolla.

Kujtim Gashi: Atëherë po të përgjigjem shkurtë se përgjigjet detaje i merr ora 15:30 të grupit parlamentar që janë drejtorat aty. Përndryshe strategjia duhet me u përfshijë, kërkesat që kanë ardhur prej drejtorive janë për nja tre katër herë më të mëdhaja sesa është tavani i KAB-it, edhe natyrisht që s'ka mundur me përfshijë ndoshta as 20% e kërkesave të drejtorive. Po përfundimisht buxhetin edhe këtë planifikim e bëjmë drejtoritë bashkë në muajin gusht ku edhe mbahet punëtorja me drejtorë, natyrisht pas debateve dhe pas kërkesave që dalin në terren. Se ju e dini që kanë me u zhvilluar 11 debate me këshillat e fshatrave, me lagjet, me zona të ndryshme, masi të merren krejt propozimet, bëhet projekti përfundimtar i buxhetit edhe aty mundemi tani me diskutuar detajet. Për momentin është herët me fol se hala s'janë zhvilluar dëgjimet publike që janë edhe obligim ligjor.

Çelë Lamaj: Kontratën që ka me bërë drejtoresha Lule, për objekteve shkollore, unë e kam informacionin, kam u paraqitë në një kontratë që tana shkollat kanë me pasë pjerrina dhe qasje, për personat me aftësi të kufizuara.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Ademi fjalën e ka.

Adem Shabanaj: Faleminderit kryesuese, përshëndetje të gjithë. I kemi pasur edhe disa takime me kryesitë e fshatrave edhe të bashkësive lokale të lagjeve të qytetit. Atje ku frekuentoj dhe banoj edhe kam prejardhjen për fshatin Malësi e Vrrinit edhe lagjen Tusuz. Sinqerisht nuk më ka rënë me e parë edhe kornizën afatmesme buxhetore. Mirëpo po më intereson a është e futme rrugët malore në fshatin Malësi e Vërrinit edhe i kemi disa matje të disa rrugëve dhe mureve mbajtëse në tusuz?. Janë veç se të matura nga kompania e studio hapësirës, edhe për rrugët malore kemi pasur edhe një takim me kryesinë e fshatit Malësi e Vërrinit me drejtorin, është kërkesa e vetme edhe e dimë që qe dy vitet e fundit nuk është investuar në Malësi të Vërrinit, përveç se sivjet që është në buxhet rruga Jeshkovë - Malësi e Vërrinit, asfaltimi, tjetër gjë nuk është investuar. Ma prioritet edhe kërkesë e kryesisë të fshatit është për rrugët malore të cilat e lidhin qytetin e Prizrenit me fshatrat e komunës së Dragashit, përkatësisht me Zgatarin edhe me Zapluxhën. Edhe për në Tusuz, thashë janë bërë matjet prej studio hapësirës, është një projekt që ka mbetur tash e dy vite për disa rrugë të lagjes edhe disa mure mbajtëse në një rrugë kryesore e cila lidh Hoqën e Qytetit me Tusuzin. Këto ishin dy kërkesa të cilat i kam edhe në emër të këshillit të këshillave të bashkësive lokale edhe si kuvendar nuk është që kam bërë shumë kërkesa, se e di që buxheti i komunës së Prizrenit nuk mundet me i përfshirë të gjitha. Mirëpo po besoj që si kuvendar dhe si dy lokalitete të ndryshme e kanë hapësirën me u fut dy projekte që nuk po kërkohet.

Çelë Lamaj: Edhe unë mendoj Adem, që në Malësi të Vërrinit jam pro këtyre dy projekteve, po mendoj po keni me vendos ju, vendos asambleja komunale dhe mundësitë buxhetore që kanë me genë. Në Tusuz ne e dimë që e kemi një kontratë e cila është kah implementohet që nuk është bash e vogël, mbi 1 milion euro. Kështu që për mure mbrojtëse ne e kemi një kontratë kornizë, normalisht që aty ku nuk kemi mundur me përfshirë me projekte kemi me realizuar përmes kësaj kontrate e cila veç është aktive, ka nja 1 muaj ditë që punohet me atë kontratë. Kështu që, të gjitha këto kontrata që i ka drejtorja e shërbimeve publike, sidomos kontratat kanë me u rimbursuar normalisht me mjete që mund të kryejmë shumë punë. Mirëpo projektin për Malësi të Vërrinit është mirë edhe unë mendoj që me mund me e futur në kod buxhetor edhe me.

Kujtim Gashi: Dje kemi pasur diskutim me drejtorin, e lamë që me e thirrë Kryetarin e Këshillit se edhe më herët i kanë bërë këto kërkesa. Përndryshe si rrugë malore ato janë, se ne e kemi një kontratë për rrugë malore. Po janë kërkesa që i kanë pasur vazhdimisht ata dhe kemi me i takuar.

Dafina Alishani: Këtu janë disa kode të cilat janë të pakuqimta, por pikë së pari po du me e pyet çka ka ndodhur me urbanizmin që s'ka asnjë kod? Mbylleni drejtorinë pasi s'ka kurrfarë planifikimi. A derën na zeni për punën e riparcializimit të zonës ekonomike. PZHK-ja, është seni shumë me rëndësi që është vitin e ardhshëm. PZHK-ja, unë këtu nuk po shoh asnjë kod buxhetor në urbanizëm.

Kujtim Gashi: Me mallëra paguhet.

Dafina Alishani: Projektimi me mallëra paguhet a?

Kujtim Gashi: E kanë në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit.

Dafina Alishani: Urbanizmi asnjë investim kapital nuk ka a! Lyerja e banesave, mirëmbajtja e kulmeve? Duhet me e pas si drejtori, edhe inspektorati! s'është në rregull kjo çka e paske bë. Epara. E dyta, te arsimit janë tre projekte të reja nga 100.000 euro, e cila e ka emërtimin projektet e komunitetit. Cili komunitet? cili komunitet është edhe pse kaq të përgjithësuara këto projekte? Nëse ka emërtim, ose kjo është pak si më hamendje. Komuniteti cilido që vjen, 100.000 euro i kemi edhe kjo nuk është planifikim. Pastaj ka shumë projekte të reja, projekte shumë të reja të cilat vitin e ardhshëm janë zero. Kjo është vetëm domethënë me bë fushatë edhe mi ul disa gjakra që me thënë ne i kemi pasur parasysh kërkesën tënde, po mbetet mbas dy viteve dhe tre viteve. E ka këtu që ose unë jam gabim ose është ndonjë gabim leshimi, ndërtimi i memorialit Xhavit Elshani, buxheti që është ndarë është 800 euro! Pastaj ndërtimi i tribunave, tribuna në stadiumin e Gjonaj. Me sa e di unë, gjonaj është tu u bë. Tash paskët harruar tribunat edhe tash po e vendosim një projekt të ri.

Kujtim Gashi: Faza, faza.

Dafina Alishani: Qysh faza?

Egzona Hoxhaj: Po se është buxhet shumë i madh, është bërë pjesa e fushës se këto tribunat nuk janë të bëme, për këtë i duhet buxhet për me u bërë tribunat.

Dafina Alishani: Po kur ta bëni stadiumin duhet me planifikuar edhe tribunat, edhe stadiumin edhe krejt. Edhe diçka që është duke u krijuar një pak precedenti që mua po më duket kjo e tregon qasjen ndaj legjislativit. Ju tash po thirrni që veç këshillat e bashkësive lokale i merrni parasysh. Ne i kemi 41 asamble që vazhdimisht bëjnë kërkesa. Tash po bijnë komplet roli i asambleistit.

Çelë Lamaj: Apolutisht jo.

Dafina Alishani: Po qysh jo, Florenti po ta jep një kërkesë ju po thoni bashkësia lokale.

Dafina Alishani: Kërkesa thashë ka qenë e bashkësisë lokale. Florenti mundet me ardhur edhe ti kurdo në zyre pa kërkesë protokolare, me bë një kërkesë me gojë, unë e shënoj edhe me kontratat e mia nëse ka mundësi e realizoj. Nuk të shti hiç me bërë një kërkesë protokolare, me e protokoluar. Por ne funksionojmë, se unë në Pirenë nuk e di cila rrugë duhet me u shtruar. Është Këshilli i fshatit, ata janë të cilët flasin, duhet me fol me komunitetin edhe me parë cilat janë prioritetet e tyre. Ne i prezantojmë, ne i shohim ligjërisht, a ka mundësi edhe në mënyrë buxhetore, a mundemi me i buxhetuar ato projekte, edhe fillojmë edhe i startojmë procedurat tona, kjo është. Po Florenti ma dha mua një informacion që unë kam me u intresuar. Por nuk ka një kontratë edhe një rrugë apo një oborr privatisht që është shtruar që është paguar prej drejtorisë së DShP-së prej vitit 2022 që unë jam drejtor, këtë përgjegjësi e mbaj unë, nuk ka, nuk ekziston.

Dafina Alishani: A bën edhe një pyetje juve si qeverisje? Përveç asfaltit edhe kubzave, mirëqenien e qytetarëve, a e keni në mend me menduar apo komplet e keni anashkaluar? Mirëqenia sociale po shihet çfarë kode buxhetore.

Çelë Lamaj: Rasim Demiri është në Drejtorië e Mirëqenies Sociale.

Dafina Alishani: Po edhe ti ke përgjegjësi bre drejtor, si qeverisje po them.

Çelë Lamaj: Nënkryetarin e ke këtu.

Dafina Alishani: Shëndetësia është, domethënë edhe buxheti është i juaj edhe i keni disa parashikime. Seriozisht po ju pyes mirëqenien e qytetarëve a e keni plan me menduar apo hiq? Se ju keni keni obligim edhe për mirëqenie, nuk është veç asfalt mirëqenia e qytetarëve.

Çelë Lamaj: Kur ta rregullojmë Shadërvanin, i rregullohet katërfish puna e tij qeshtu ju krijohet.

Dafina Alishani: Kjo qasje, ne secilin çdo vjet e kemi këtë problem edhe në KAB edhe në buxhet. Asambleisti nuk ka çka vjen në KAB edhe në buxhet me ju dhënë propozime, asambleisti secilën seancë i ka kërkesat e veta. Mua më vjen keq në dëgjime publike me ardhë me ja zonë vendin e një qytetari, se unë e kam hapësirën çdo muaj në seancë me ngritur çështje. Tash ju po thirrni po thoni, hajdeni në KAB jepni propozime. Ose hajdeni, nëse unë e kam ngritur tre, katër herë në kuvend, ajo është një nevojë prej një qytetari. Fundja nuk është kërkesa ime personale, edhe ne dikë po përfaqësojmë. E mua nuk pomë duket në rregull qekjo që këshillat e bashkësive janë prioritet, asambleistat janë prioritet derisa keni interes, kur s'keni interes ose ku jeni mirë me vota.

Çelë Lamaj: Nuk e thashë ashtu.

Dafina Alishani: Qasja qashtu, edhe ju këtë e thatë, bashkësitë lokale i kemi dhe në rregull. Atëherë nëse s'po vijmë në kuvend, merrni bashkësitë lokale edhe vazhdo.

Çelë Lamaj: Nuk e thashë ashtu, ti nëse don me i shtrembëru fjalitë, shtrembëroji por nuk e thashë ashtu. A don me të kallxu tash një mesazh i një qytetar që e merr edhe unë ja implementoj. Hiç s'është kryetari, as nuk është asambleist, as s'është kryetari i degës ose i fshatit. Ju krejt, krejt kërkesat e juaja që mi keni bërë mua, kam mundësi buxhetore dhe kam mundësi me ja realizuar absolut të këqyri si Dafinë e jo si vetëvendosje.

Adem Shabanaj: Nënkryetari tha që ekziston një kontratë për rrugë malore dhe mundem me e bërë me ato, por është një kosto që ndoshta nuk e mbulon me mirëmbajtjen, duhet me qenë projekt i ri. Poashtu, edhe tek muret edhe rrugët në Tusuz, muret mbajtëse e di që ekziston një kontratë dhe janë duke u bërë punimet. Mirëpo janë goxha do mure që janë të kushtueshme, nuk është një mur 20 m ose 30 m, por është goxha një rrugë 500 m që ka mu bë me mure dhe me trotuare. Dhe për atë po them me pas mundësi me fut një projekt të ri në Tusuz, për mure mbajtëse edhe disa rrugë janë le të maten, ndoshta dhe projekti ekziston prej 2022-tës.

Çelë Lamaj: nëse hyn në buxhet pse jo.

Kujtim Gashi: Veç një përgjigje për Dafinën. E para projektet me komunitet, këtu është një gabim i një zyrtarit të Drejtorisë së Financave që s'e ka përmbyllur, se fjala është për projektet që janë në kod të projekteve paratë tona, idetë tona përzgjedhja juaj. Domethënë janë pesë projekte me kah 100.000 euro të parapame, tre i kanë shkuar në arsim, një në kulturë me sa kujtoj, pesë janë në përgjithësi, por shumica janë në arsim, se këto i votojnë, e dini ju modelin qysh është. Ne shkojmë atje, marrim propozimet, dalin shtatë propozime, tetë, shkojmë mbas dy jave, ato shtatë tetë propozime i vendosim në votim, banorët i votojnë vetë, njëri që kalon me vota më shumë, bëhet pjesë e buxhetit.

Dafina Alishani: Një detaj po harron. Para se me shkuar ja jepni projektet të cilat doni me i bë.

Kujtim Gashi: Sinqerisht janë shumë të hapura këto.

Bajram Kastrati: Jo kam marrë pjesë edhe unë në njërin, janë shumë transparente.

Kujtim Gashi: Sa i përket mirëqenies, Dafina veç po ta kujtoj që janë disa projekte që realizohen në këtë. Investimet kapitale janë të drejtpërdrejta në mirëqenien e qytetarëve, të drejtpërdrejta sepse i krijojnë kushte qytetarëve për një jetë më të mirë. Investimet te nënat lehona janë në kuadër të mirëqenies, investimet te pagesa mbulimi i shpenzimeve për familjarët që kanë anëtarë të sëmurë janë po ashtu mirëqenie sepse ky fond prej 200.000 ka arritur 500.000. është rritur për 300.000. Për 100% janë arritur, janë rritur edhe bursat për studentë, besoj e dini edhe vlerën edhe numrin. Po ashtu subvencionimi i më shumë se 200 projekte për biznese të reja startup, që janë në buxhet të komunës së Prizrenit, pavarësisht kur i realizon ato, GIZ apo organizatat e Prizrenit, por janë investime të Prizrenit në mirëqenë, sepse i kemi 200 biznese të reja, secili ka me dy- tre të punësuar edhe prej tyre ka edhe 10 që kanë të punësuar. Domethënë këto janë projekte që shkojnë drejtpërdrejtë me mirëqenjen e qytetarëve, unë se s'di ndryshe qysh duhet me investuar për

mirëqenjen e qytetarëve. Ne tash sun i marrim paret e komunës e me ja dhanë sepse ajo është edhe antilegjore, por edhe nuk lejohet. Kështu që po besoj janë vetëm disa që po i përmendi që shkojnë drejtpërdrejtë mirëqenjen e qytetarëve. Për sa i përket Ademit për rrugët malore, unë thash ka kontratë, por nëse ka kosto të madhe, ne duhet me diskutuar tani me drejtorin e bujqësisë me Bexhatin a duhet me bërë kontratë të veçantë të re vetëm për vend, nëse kosto është shumë e lartë. Edhe për muret në Tusuz drejtori ta dha përgjigjen. Gjithçka që është e nevojshme dhe prioritet e kemi paraparë.

Antigona Bytyqi: A ka dikush tjetër?

Levent Bus: Pounë kam. Për lagjen Terzimahallë, pazarin se keni shti në buxhet për vitin 2025.

Çelë Lamaj: S'koka në buxhet, edhe unë jam për me parapa. Po kishte me qenë tepër mirë kishte me qenë unë veç jam në hartim të një projekti për atë pjesë. Jam për me realizuar atë treg që është mëse i nevojshëm.

Dafina Alishani: Qysh po e harton pa planifikim?

Çelë Lamaj: Po unë e kam projektin, kurdo që lypni ju diçka, unë jam i gatshëm, s'ka lidhje.

Dafina Alishani: O drejtor, më falni bre, po shumë jeni duke na konsideruar që s'jemi duke ditur kurrëgjë. Premtim bre keni pasur për tregje, vetë kryetari ka dalë te secili shitës aty dhe ka premtuar e ka thënë do ta keni infrastrukturën.

Çelë Lamaj: Tregun e Shqipërisë jemi duke e bërë, a ke parë?

Dafina Alishani: Tregun e Shqipërisë po e bën Xhaviti jo ti.

Çelë Lamaj: Xhaviti? Po ajo është politikë e komunës, ne kemi një kontratë të nënshkruar me dikë.

Dafina Alishani: Po, tash u bë treg ajo apo?

Çelë Lamaj: Po tregu fatoni, ka pasur emër gjithmonë.

Dafina Alishani: Tregjet të cilat i keni premtuar asnjë vit nuk i keni paraparë.

Çelë Lamaj: Po me bë edhe tregun edhe tri mandate të tjera i fitojmë oj Dafina. Na në 2025 kemi me implementuar.

Dafina Alishani: Kjo arrogancë ka me ju hangër krye, mbaje mend çfarë po të them.

Çelë Lamaj: Kjo është arrogancë, por n'varet prej pyetjeve të juaja.

Dafina Alishani: Po qysh pyetjen e Leventit po e shtremon, hajde unë opozitë.

Çelë Lamaj: Unë i thashë Levent jam pro, jam në hartim të projektit.

Dafina Alishani: Po edhe Leventi, edhe Ertani edhe Dafina, krejt secilën seancë kanë thënë tregu, edhe Bazhdarhanja, edhe lagjja ku e përmendi.

Çelë Lamaj: Duhet me pas në buxhet, futne në buxhet, unë unë jam implementues, unë jam në qeveri edhe unë i implementoj projektet të cilët i votoni dhe i futni ju në buxhet, në moment që e futi projektin në buxhet unë jam i obliguar me implementuar.

Dafina Alishani: Ti po thua unë e kam planin, e kam projektin e gatshëm.

Çelë Lamaj: Po pom, unë po rri gati, po ju pres ju me e futur në buxhet, futne në buxhet.

Dafina Alishani: Okej, me projekte imagjinare.

Antigona Bytyqi: Faleminderit, a ka dikush tjetër rreth kësaj pike?

Karanfil Haxhillari: Korniza afatmesme buxhetore planifikohet edhe për vitin 2025, 2026, 2027. Definitivisht ky planifikim nuk e prek zhvillimin ekonomik të komunës së Prizrenit, nuk e prek mirëqenien e qytetarit. Përsëri kemi stagnim si në aspektin shëndetësor, si në aspektin arsimor, kom pritë që planifikimet si në shëndetësi, si në arsim, si në mirëqenie sociale, drejtorja e mirëqenie sociale, po ashtu edhe në turizëm dhe në zhvillim ekonomik, me të vërtetë len shumë për të dëshiruar dhe nuk ka asnjë vizion që pritet me pasë zhvillim qyteti i Prizrenit. Prandaj me të vërtetë unë edhe shtoja çastin që jam opozitë, unë nuk e mbështes këtë KAb.

Dafina Alishani: Edhe veç një pyetje për te bursat. A janë ndarë bursat nënkryetar? Apo si lehonat qeshtu keni me i lënë.

Kujtim Gashi: Janë kryer, ka dalë lista, ka qenë koha e ankesave edhe tash procedohen pagesat, sepse janë disa faza.

Dafina Alishani: Është kryer koha e ankesave.

Kujtim Gashi: Po tash vazhdojmë pagesat.

Dafina Alishani: Kur?

Kujtim Gashi: Në çdo 10 ditë e para të çdo muaji.

Dafina Alishani: Deri në fund të vitit domethënë bëhet.

Kujtim Gashi: Se besoj që deri në fund deri kah gushti, kysmet ata në në shtator me bursat në xhep.

Dafina Alishani: Lehonat po i merrni si sukses i juaj, jo i grupit të asambleistëve.

Kujtim Gashi: Po se na mundemi edhe mos me implementu, mos me pas vullnet.

Dafina Alishani: Jo valla s'mundeni.

Kujtim Gashi: Mundemi që çuditesh.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër a ka? Atëherë më çoj se jo nëntë anëtarë jemi prezent, po e hedh në votim që ti rekomandohet kesaj mbledhje që do mbahet. Kush është për? Shtatë jemi për, dy kundër. Kjo pikë i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimi mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.

Antigona Bytyqi: Drejtor, fjala për juve.

Çelë Lamaj: Po faleminderit kryesuese. Kur kemi filluar projektin e rrugës Shuaip Spahiu edhe të Shatërvanit, i kam premtuar qytetarëve që komuna do të interesohet për një parking aty afër në atë zonë ku mundet me qenë shumë produktiv, funksional për qytetin. Fatmirësisht edhe atëherë është menduar edhe e kam cekur edhe atëherë që jemi në hulumtim të atij lokacionit ku është Ina sot, apo IP Petroli që e ka me qira. Se ajo punë ne e dimë që ka pasur gjithmonë diskutime, unë e di se qysh pas luftës kemi diskutuar edhe me ato drejtoritë e urbanizmit edhe me ato qeveritë e kaluara po nuk është marrë asnjë iniciativë për largimin e atij objekti i cili është rrezik permanent për objektet përreth. Dihet që me ligjin mbi zonën historike, neni 6 thotë: aktivitetet e ndalume, një prej atyre aktivitetet thotë pompat e derivateve të naftës edhe ndërtime industriale, fabrikat ose zhvillime përfshirë eksplotimin, eksploatimin e burimeve minerale nuk lejohet. Krejt ajo zonë aty ku vepron ajo pikë e karburantit, shfrytëzohet prej IP Petrolit, ku si pronë e ka vetëm një pikë 104 m2 është pronë e IP petrolit. Edhe ne mendojmë që me shpronësimin e asaj atij një ari e 04 m2, ne mund ta bëjmë një parking nëntokësor, është bërë një skicë sa thamë prej drejtorisë, kjo është bërë vetëm një fizibilitet, një mini fizibilitet me parë se çfarë mund të ndodhet në atë zonë edhe na rezulton që ne mundemi pasur diku 96 parkingje. Që kishte me qenë për pjesën qëndrore një prej hapësirave që kisha lutur të gjithë që me mundur me gjetur edhe një hapësirë të tillë, kishim me mundur që pjesën qëndrore të qytetit ta furnizojmë që qytetarët që vijnë edhe si turizmi të ketë një vend parking të mirë. Kështu që është në interesin e komunës që të bëhet shpronësimi i kësaj. Është kryer disa shpronësime që kam pasur kontakt me zyrtarë kështu ose me lidhjet private të AP-së, që ka pasur Rahoveci, ma kanë dhënë si informacion që ka bërë një shpërdësim me çmime shumë të ulëta. Domethënë, INA ja paska dhënë IP Petrit në shfrytëzim si objekt. Kështu që kishte me qenë shumë mirë që ne ta shpronësojmë atë pompë edhe ta bëjmë një projekt që kishte me qenë në të mirë edhe në funksion të qytetarëve.

Antigona Bytyqi: Faleminderit drejtor. Po Bajrami fjalën, pastaj Karanfili.

Bajram Kastrati: Faleminderit. Fillimisht drejtor e përmende Rahovecin. Nëse keni nevojë për naj takim me kryetarin e Rahovecit edhe stafin tregoni. E shoh që ka nevojë. E dyta, ne kemi disa prona që po i shpallim si interes që sa kohë edhe s'kemi asnjë përgjigje! Tash po i drejtohem nënkryetarit. Ne i kemi dy prona për shembull që kanë bërë kërkesë edhe i ka aprovu asambleja

që janë në Arbanë. Te kush po duhet me u drejtuar për ato prona? Ka me intervenuar politikisht. I kam shfrytëzuar unë do element absolut s'kam kurrfarë përgjigje. A është duke bërë në këtë drejtim kryetari, nënkryetari, ish-ministri, dikush prej komunës po e lajmë qeverinë, a është duke insistuar që këto prona me u zhvilluar procesi edhe me dalë në interes, me fillu ne me ndërtuar qysh është stadiumi në Arbanë edhe prona tjetër që është për prona arsimore, edukative që e kemi bërë, do të thotë prej asamblesë. Mua po më intereson tash edhe këtë pronë, jam për, prezantim i mirë, fenomenal. Po çka do të bëhet? Apo veç po i shpallëm ashtu edhe po i lajmë? A është tuj u marrë dikush apo po merret dikush veç për qato prona që po kanë ndonjë interes dikush personal. Ta quaj në këtë rast nënkryetari mund me pas ndonjë interes personal edhe me intervenuar gjëra. Thjesht po dua me ditë unë jam i interesuar fillimisht për qato pronat që kemi bërë kërkesën në Arbanë. A është tuj u marrë dikush për ato a kemi përgjigje konkrete sepse u bën një dy vite e sa.

Çelë Lamaj: Shumë shpejt, tani AKP-ja, në bazë të informacioneve që kamë unë, asnjë pronë asnjë pronë në territor të komunave nuk ka me e shpallë për privatizim në shitje pa e njoftu komunën. Në këtë rast për pronat të cilat ne na kanë interesuar dhe na interesojnë, unë paraprakisht pata një takim me kryetarin, e kam njoftuar për disa prona tjera e normalisht edhe për pikën që po e diskutojmë. Thash që komuna e Prizrenit shumë shpejt ka me dërguar prej zyrës së kryetarit, një e-mail Agjensionit Kosovar të Privatizimit, jemi në identifikim të gjithë atyre pronave që kanë me qenë me interes që ne ti, filozofia ishte me e bllokuar si pronë, se ne jemi të interesuar, atëherë me pa rregullat edhe ligjshmëria qysh është ardhur deri te privatizimi i atyre edhe kjo është krejt. Edhe në Arbanë, le të identifikohen ato prona që nënkryetari ka me pasur përgjigjen sigurisht.

Bajram Kastrati: Si proces AKP a ka këtë që me i bllokuar secilën kërkesë me bllokuar moti e ka. Ama kur po kryhet ajo.

Kujtim Gashi: Ta plotësoj pak drejtorin edhe po përgjigjem për Bajramin. E para me thënë të drejtën unë kam shumë interesa saherë që ka nevojë për komunën, ne jemi aty për interesin publik, nuk kemi naj interes personal asnjëherë. Jemi marrë intenzivisht për dy çështje që janë shumë të rëndësishme siç e dini edhe ju, varrezat e qytetit jemi kanë besoj nja 10 herë edhe ata nja 2-3 herë këtu edhe u zgjidh si problem. Tani po ashtu u zgjedh si problem edhe çështja e objektit të lirisë, sepse AKP-ja, kërkesat i ka me prioritet varësisht qysh i sheh edhe ajo të rëndësishme, varrezat i ka parë si projekt të rëndësishëm për ne. Edhe largimin e objektit të lirisë për me zgjeru rrugën e ka parë si prioritet. Po nuk i ka trajtuar edhe parcelën për shkollën të njëjtin me prioritet qysh e ka bërë dhe këtu, për shkak se nuk i ka menduar që janë urgjent, të karakterit urgjent. Nuk janë veç të dyja, për shembull objekti ose parcela për stadiumin e Arbanës dy herë është bë, njëherë në kohën e juaj, edhe njëherë në kohën kur unë kam qenë Kryesues i Kuvendit. Po asnjëherë s'ka pasur domethënë vendimmarrje të AKP-së, nuk i di arsyet. Ata e kanë në tavolinë e kemi diskutuar kur jemi kanë edhe atë çështje janë, edhe tash së fundmi edhe të shkollës. Po ajo çka na kanë siguruar është atë nuk kanë me u privatizuar, kjo është e sigurtë, edhe kanë me u kthye krejt këto proina në fondin sovran që e themelon qeveria, edhe kanë me qenë në dispozicion për komunën kur bahet. Për momentin nuk ka vendim për këto dy parcelat qysh nuk ka vendim edhe për nja 3-4 tjera të cilat poashtu i kemi shpallur. Unë besoj që takimet që do ti kemi do të jenë si çështje stadiumi është i karakterit urgjent sepse dojmë me bë një zgjidhje atje. Ju e dini edhe këto të dyja, përkundër që janë kryer procedurat, nuk kanë kaluar ende në pronë të komunës se janë tuj pritë mjetet. Domethënë pa ja bërë pagesën 20% nuk mundën me me i kaluar tek na. Unë besoj hap pas hapi ka me u zgjidhur edhe për ato, po nuk janë vetëm ato. E po besoj për te rasti i pumpës që e

përmendi drejtori, kjo ka me u cilësu si projekt prioritar meqenëse është interes i qytetit me bërë një zgjidhje për parkimin. Edhe kështu funksionon edhe AKP-ja, kështu funksionon bordi. Ata janë disa anëtarë aty që qysh ishin prioritetet marrin vendime.

Bajram Kastrati: A i shohin prioritetet ata në bazë të bordit që kanë apo në bazë të kërkesave që ja bëjnë këta, në bazë të presionit.

Kujtim Gashi: Në bazë të lëndës.

Bajram Kastrati: Edhe në bazë të presionit pak sigurisht. Jo unë edhe me kolegun tonë Filin, që ka diskutuar direkt me kryeministrin por se di unë.

Kujtim Gashi: Nëse ti ke kanale që mundesh me shfrytëzuar unë të përkrahi.

Bajram Kastrati: Jo, unë me pas kanale unë i kisha shfrytëzuar.

Antigona Bytyqi: Florenti fjalën e ka.

Florent Ukaj: Faleminderit. Drejtor të përgëzoj, ti drejtor ose kushdo që e ka marrë këtë iniciativë për këtë parcelë edhe jo veç për këtë, po qyteti, sidomos qyteti, zona historike ka nevojë shumë për parkingje. Domethënë të bjen 20 herë në sëllë dhe nuk ki ku mu parku, beso që edhe shumë njerëz ki që largohen, nuk ndalen në Prizren shkakut parkingut. Kisha inkurajuar që edhe identifikoni dy tre vende të tjera sidomos afër qytetit edhe normalisht personalisht këtë herë do ta votoj çdo propozim që vjen për parkime në qytet.

Antigona Bytyqi: qoftë Nëntokësor apo mbi tokësor.

Florent Ukaj: Qyshdo qoftë, ka nevojë edhe nëntokësor dhe mbitokësor. Pasi tha Bajrami për konsulta, unë ta kisha dhënë një propozim me shku mu konsultu te Isa Mustafa për një parking që e ka bërë aty te lagjja e spitalit që është në funksion shumë të mirë te intereksi, dmth. një shembull i mirë.

Kujtim Gashi: Florent, Modelin e Isa Mustafës ne e kemi marrë moti,

Antigona Bytyqi: Faleminderit, Karanfili e ka fjalën.

Karanfil Haxhillari: Këtu po parashihet 103m2,

Çelë Lamaj: 104, ashtu është matja.

Karanfil Haxhillari: Edhe edhe ashtu, si 103 si 104 është goxha vendi i vogël, sa sa vetura mund ti nxen aty? Prejse ekziston ekziston qajo pompë është si oazë, me të vërtetë shëmtim për qytetin edhe rrezikshmëri shumë e lartë për qytetarët e asaj pjese. Në qoftëse arrihet me e larguar si pompë, çkado që bëhet qoftë edhe një sheh mu ba është më e mirë sesa është kjo. Personalisht me të vërtetë lam për largimit të pompës, shpresojmë që mos ta kemi fatin e shpronësimeve tjera apo kërkesave të AKP-së për jo shpronësim sepse në fund të ditës shpronësimi i mbetet komunës për me tha lekun

sa i kushton, por që mos të mbeten dhe të mos shkohet deri në fund kjo iniciativë. Prandaj vetëm e kam një vërejtje që është prap vend i ngushtë sa do të mjaftoj apo do të bëhet vetëm për ata kjoshi aty dhe qato biznese.

Çelë Lamaj: Jo, dëgjom tash. Kjo është pjesa e podrumit, shkohet me gërmim deri në trotuar dhe knej deri te Lumbardhi. Bëhet podrumi, qitet plloqja, përmbi te bëhen 42 parkingje dhe përfundi janë dhe rruga mbetet e njejtë. Çkado që ka me ndodh sipas projektit ka me pasë qarkullim të automjeteve në qat zonë. Ka me funksionu trotuari kah bizneset, nuk i pengon kërkush. Domethënë vetëm pjesa e trotuarit, dmth. rruga në këtë anë kah pompa edhe rruga tjetër dmth që është një qarkore aty, ajo gërmohet, punohet, vendosen në bazë të projektit nalt i nxen 42 vende sepse rruga na pamundëson 54. Ky është bë si projekt prej zyrtarëve të mi, arkitektave në DSHP. Ne pasi ta marrim ligjshmërinë ne kena me hartu projektin kryesor edhe kena me implementu si projekt.

Kujtim Gashi: Përndryshe te çështja e shpronësimit është 103 m2, janë vetëm pronë që ka mu bë shpronësimi, të tjerat tonat janë.

Antigona Bytyqi: A keni diçka dikush tjetër rreth kësaj pike? Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: Drejtor, këtu nëse s'gaboj është edhe një pjesë e parkingut ku i leni veturat e komunës.

Çelë Lamaj: Jo, është tjetër.

Dafina Alishani: Po pse mos me bashkuar edhe atë pjesë, se ju e keni edhe një parking të cilën jeni duke e shfrytëzuar më herët u kan publike ajo në qeverisjen e kaluar, tash e keni marrë ju edhe personeli po e përdor, ngjitë me shkollën që është mbas shkollës.

Çelë Lamaj: Ka kontest pronësorë, është në kontest pronësor.

Dafina Alishani: Po në rregull dhe qato veturat e juaja që i keni që i vendosni këtu, pse mos me bashkuar këtë parking edhe me krijuar hapësirë më të madhe.

Çelë Lamaj: S'ka mundësi se është lumi, mbi lum nuk shkohet, a e ke qartë?

Dafina Alishani: E di që është Lumi.

Çelë Lamaj: Po edhe qysh me bashkuar?

Dafina Alishani: Epo një hyrje prej mbrapa siç qysh është prej urës.

Kujtim Gashi: Nëpër nën tokë sun hyn se është impianti.

Çelë Lamaj: Po aty ka me e pasë atë hyrje. Bahen tualetet, pjesa tjetër e parkingut mbetet parking, është ky projekti i përuar për tualete. Nejse ajo është infrastrukturë tjetër, por ne i bëjmë toalet, pjesa tjetër sipër është parking, është parking përsëri.

Dafina Alishani: Qekjo a është 1 kat a?

Çelë Lamaj: Qajo është pudrumi, kjo është përdhesa, kjo është infrastruktura ekzistuese.

Dafina Alishani: Edhe me pjesën e zonës historike ose këto a janë paraparë edhe me këto?

Çelë Lamaj: Me ligj jemi në rregull.

Adem Shabanaj: Në kufi e rrok, nuk e rrok zona historike.

Çelë Lamaj: Janë dy a tre zona por nuk e kam zona e parë. Janë paraparë disa zona të mdrojtej por nuk kena pa naj problem për me implementu si projekt. . Zona e parë janë nëntë zona mbrojtës, po nuk kemi ndonjë ndonjë problem për me implementuar. A keni diçka tjetër rreth kësaj pike? Atëherë nëse s'keni dikush diçka tjetër rreth pikës së katërt, po e hedhi në votim. Prezent jemi tetë anëtarë. Kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së nesërme? Shtatë për, zero kundër dhe 1 abstenim. Atëherë edhe pika e katërt i rekomandohet kuvendit. Po kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën janar-qershor 2024.

Antigona Bytyqi: Fjala për juve drejtor.

Kujtim Gashi: A po doni edhe këtu apo veç në kuvend?

Karanfil Haxhillari: Unë shpresoj që të vjen kryetari.

Antigona Bytyqi: Atëherë po e hedhi në votim. Prezent jemi nëntë, kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së nesërme? Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Inaformatë rreth raportit të punës së zyrës për integrimë evropiane për vitin 2023.

Antigona Bytyqi: Eleonora po të shoh që je edhe pa zë, të kisha lutur sa më shkurt.

Eleonora Fetollari: Vetëm te emërtimi i pikës ndoshta duhet me u përmirësu.

Antigona Bytyqi: Ashtu është në plan të punës. A po e lëmë edhe këtë për neser? Atëherë pasi jeni dakort po e hedhim në votim. Kush është për që t'i rekomandojmë mbledhjes së ardhshme? Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika tjetër.

Pika e shtatë:

Raporti i Këshillit të fshatit Zym i Hasit për periudhën janar-qershor 2024;

Antigona Bytyqi: Lajde fjala për juve.

Lajde Kolgjeraj: Unë e kam shumë shkurt. Atëherë në muajin janar është diskutuar rreth temave të ndryshme si dhe për trashëgiminë kulturore, është diskutuar gjithashtu edhe për një bashkëpunim me QRTK-në, në Prizren për një projekt për konzervimin dhe restaurimin. Në muajin shkurt dhe mars është diskutuar rreth gjendjes së Liqenit i cili është si projekt i trashëgimisë kulturore i cili gjendet në rrezik dhe gjithashtu gjendja e përgjithshme në të cilin ndodhet vende arkeologjike e kishës së Shën Gjergjit dhe mundësitë që kjo hapësirë t'i nënshtrohet procesit të konservimit, afër Liqenit të Berishës dhe në afërsi të kishës së Shën Gjergjit. Në muajin prill me datën 27.04.2024 u mbajt programi në shtëpinë e muzeut Katarina Josipi, u tregua jeta e saj dhe u kujtua për 55 vjetorin e kalimit në amshim të Katarina Josipit, si dhe ashtu te varri i saj. Gjithashtu gjatë muajit maj me datën 4, 5, u tregua historiku i shoqërisë Katarina Josipi e cila tash ka marrë emrin e ansamblit e etnokulturor dhe ka shpërndarë disa mirënjohje për kryetarët e deritashëm të ansamblit. Në muajin qershor anëtarët janë ftuar nga Kryesuesja e Këshillit për t'i vizituar këto ndërtesat trashëgimore dhe kulturore. Ku konkretisht si pika të rendit të ditës për t'i vizituar ish-in Liqeni i Berishës, gërmadhat e kishës së Shën Gjergjit, Shtëpia e Muze e Katarina Josipit. Qëllimi kryesor i kësaj mbledhje ishte vizita e disa nga ndërtesat trashëgimore kulturore për të parë dhe të diskutuar gjendjen e tyre momentale. Për këto lokalitete është mirë që të ftohen arkeologët të vlerësojnë gjendjen nga afërt dhe që në të ardhmen t'i nënshtrohen gërmimeve arkeologjike nga institucionet vendore, sepse është me interes kombëtar që të ruhen këto lokalitete. Zhvillimi i këtyre lokaliteteve do të ndikojë edhe në rritjen e turizmit vendor që është në interesat e komunës së Prizrenit, si dhe të shfrytëzohen mundësitë për të për të njoftuar organet kompetente rreth këtij rasti dhe për të gjetur rrugë për të filluar zhvillimin e ndonjë aktiviteti arkeologjik në lokalitet rreth zonës.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Veç desh me pyet se i kemi nja dy kolegë që janë në komision. A i njeh ata, a i ke taku ndonjëherë?

Lajde Kolgjeraj: Po i njoh, qysh jo, kemi kontakt të rregullt me ta.

Bajram Kastrati: Eh ok, thashë ai i ke taku najherë.

Lajde Kolgjeraj: Desha me pyet çka është puna e pagave, a mundesh ndonjë sqarim se po na vesin edhe këta të tjerët?

Antigona Bytyqi: Sqaimi është i njëjtë qysh e kam thënë, ministria thotë që vetëm komitetet obligative. Për besë ti e di shumë mirë që e kemi bërë ma të pamundur.

Lajde Kolgjeraj: Po po, veç çka ka të re, a janë duke punuar në këtë punë a jo a? A është ndonjëherë?

Antigona Bytyqi: Me sa e di unë para dy javëve e ka pasur drejtori i financave një takim sepse edhe KKSB-ja e asnjë komitet, asnjë komision nuk po paguhet këtu. Edhe po thotë që janë duke punuar në atë drejtim. Po derisa, ata zakonisht na kanë thënë po punojmë në këtë drejtim po. Me pa diçka të re unë ju kam thënë që ju njoftoj. Prezent jemi tetë anëtarë. Kush është për që t'i rekomandohet kjo pikë e së ardhshme? Unanimisht ju faleminderit. Po kalojmë te propozimet e reja që u bën sot.

Pika e tetë;

Antigona Bytyqi: Po kështu e bëra njëfarë emërtimi. Propozim për lirim nga pagesa për lokalet pronë komunale dhe hapësirat publike në zonën historike për gjashtë muaj apo?

Karanfil Haxhillari: Po për gjashtë muaj.

Antigona Bytyqi: Ama qetash ta konkretizojmë, ta dimë çka kemi me qitë. A po e bëjmë në fillim veç komisionim apo qysh po e marr mendimin e juve.

Bajram Kastrati: A ka mundësi bre Fil nesër me e pru diçka pak më konkret?

Karanfil Haxhillari: Ka plot zyrtar ligjor komuna o Bajram.

Egzona Hoxhaj: çka me diskutu na o Karanfil!

Bajram Kastrati: Puna është thjeshtë në aspektin kolegial të jemi pak më të arsyeshëm, s'po dua me bë politikë absolut. Por ta dimë se çka me diskutu.

Antigona Bytyqi: Qekjo mbetet tash çfarë kemi me vendos.

Bajram Kastrati: Se unë kam çka të diskutoj, unë veç kam i përmendur qata emra, nja dy tre emra që janë aty, që jam kundër asaj pune. Edhe se kam atë problem ama ndoshta unë.

Karanfil Haxhillari: Po le ta bëjë bre Blerimi. Unë thashë e hekim pikën e tretë, ra që është subvencionimi me pare në qarkullim, le të mbeten vetëm dy pikat e para. Mundësitë për faljen e qirasë edhe hapësirave.

Bajram Kastrati: Për këto lokale që janë të komunës.

Karanfil Haxhillari: Po, edhe ka hapësirë publike komuna që i shfrytëzojnë, prej te kinezit që ja nis atje lartë, teposhtë vjen nuk janë veç ato deri te ura e.

Levent Bus: Valla Karanfil ki me i votu edhe tjerat.

Karanfil Haxhillari: Bjere bre edhe e kqyrim e votojmë.

Antigona Bytyqi: A po e ndëgjojmë Blerimin për cilat opsione janë me të mira.

Blerim Rakaj: Së pari nëse më lejoni lidhur me atë Dafina që i tha disa të pavërteta. E para tha që unë kam deklaruar në këtë formë që nuk bënë, nuk është e vërtetë. E dyta tha vendimet, komuna e ka shefin e zyrës ligjore, i ka 25 jurista, në sektor të kuvendit ka shtatë vite që është mungesë shefi, mungesë stafi, jemi duke tentuar me e bë më të mirën e mundshme sa dimë sa mundemi. Tjetra është e pa e pandershme me bërë gjyq publik, kur nuk dihet hala qysh ka me përfunduar ai proces gjyqësor. Më ka ndodhur mua, mundet me i ndodh ndonjërit prej juve secilit edhe unë kam bazë

tash me shku me të ngritë kallëzim penal në fakt, që nuk dihet qysh rrjedhë, dhe me thënë Dafina po e keqpërdorur detyrën, po thotë të pavërteta dhe po e shkel prezumimin e pafajësisë. Ti në këtë rast po e keqpërdorur detyrën e anëtarës të Komitetit dhe po bën gjyq publik kur nuk dihet epilogu se qysh ka me përfundu ajo. Edhe nuk e përcapton ti, s'ta lejon asnjë procedurë ligjore se a jam unë, apo a duhet me dhënë sqarime a s'duhet me dhënë. Kur të bëhesh kryesuese mi përcakton detyrat, çka duhet me bë unë, çka kam me bë unë. Gyqin publik ish kanë mirë mos me e bë. Këtë rast sot e bane një gjyq publik ndaj meje. Edhe tjetra këto procedurat ligjore ju lejojnë mundësisë e lirimit të hapësirës. Mirëpo zonë historike përfshinë edhe jashtë punimeve, janë këto kah sheshi. A mundet me u përcaktuar saktësisht cila pjesë? Zonën historike i përfshin edhe ma gjërë lokale dhe hapësira publike, janë edhe lokale të tjera tash me emra s'po i di.

Karanfil Haxhillari: Duhet bre me e ditë në momentin kur thuhet në Shadërvan.

Florent Ukaj: Çka parashihet në hartën zonale, qajo është zonë historike.

Blerim Rakaj: Po por ka edhe pjesë ku s'ka punime.

Dafina Alishani: Na spo thojmë qetu o punohet e qetu jo. Nëse s'punohet këtu, unë s'mundem me shku as atje.

Këtu po është problemi, që nuk ka vullnet edhe tash mundohuni, specifikoni. Ne tre herë e kemi kallëzuar që.

Florent Ukaj: Jo se kisha me specifikuar këtu, e specifikuar është. Tash kush do me votu e voton, kush s'don.

Blerim Rakaj: Keni mundur si grup i kuvendarëve ose si kuvendar me ju drejtuar Shefit të Zyrës Ligjore, e kishte përgatitur, obligimet të zyrës ligjore janë këto.

Dafina Alishani: Cilat?

Blerim Rakaj: Edhe këto kërkesa me i përgatitur, Shefi i Zyrës Ligjore.

Dafina Alishani: E pse prej neve kërkohet me përgadit.

Blerim Rakaj: Si inicues mundesh me i thënë për kërkesë më duhet me u përgatit një dokument, një propozim vendim me e bë të gatshëm dhe Zyra Ligjore e përgatit në ju drejtohuni me kërkesë.

Dafina Alishani: Po de, pse se ka bërë zyra ligjore.

Blerim Rakaj: Po s'ju keni drejtuar ju.

Dafina Alishani: Qysh s'ju kemi drejtuar Zyrës ligjore. Po jo a jeni bre në tokë të bukës çfarë jeni duke kërkuar? Organi më i lartë është kuvendi, unë nuk kam bre nevojë në secilën zyre me bë kërkesë. Në emër të grupit u qu Ilir Gashi e ka propozuar. Tash unë me ju ardhë secilit në zyre me ju thënë allahile bëma një propozim vendim a?. Vendimi është votuar në organin më të lartë.

Blerim Rakaj: Nuk është votuar vendimi, u votu për rend dite, për secilën mbledhje votohet rendi i ditës.

Dafina Alishani: Në rregull tash unë duhet secilën zyrtar me taku për një kërkesë të asambleistëve a?

Blerim Rakaj: Edhe gjyqin publik të lutem Dafina mos ma bën asnjëherë gjyq publik.

Dafina Alishani: Leje ti gjyqin publik a e bëj a s'e bëj.

Blerim Rakaj: Jo, s'ta lejoj as ty e askujt tjetër.

Dafina Alishani: Njeri ka premtuar, ka premtuar që s'ka me pas staf asnjë me aktakuzë, ti çka po e merr personale këtë farë punë.

Blerim Rakaj: Normale që e marr personale sepse për mua fole.

Dafina Alishani: Jo jo, ti merre personale për që na kthejnë vendime të paligjshme, qatëherë merre personale.

Blerim Raskaj: Cilat vendime kanë ardhë të paligjshme? Kanë ardhë vendimet e zyrtarit të ministrisë që i ka përgatit.

Dafina Alishani: Edhe kush ka përgjegjësi këtu?

Blerim Rakaj: Ka Shefi i Zyrës Ligjore, ka zyrtari i ministrisë, unë se marr përgjegjësinë e zyrtarit të ministrisë.

Dafina Alishani: Se di unë kush është shef, kush s'është shef, mungesa e vullnetit politik po na bën që kështu me mbetur disa orë pa definuar. Propozimin e bën kuvendari, hartimin e propozim vendimit e bën zyra ligjore. Nëse s'janë të aftë zyra ligjore me bë, le t'i lirojnë ato vende të punës.

Blerim Rakaj: Konkretizoni kërkesat.

Antigona Bytyqi: Nuk ka mungesë të vullnetit politik, unë edhe sot e votova.

Dafina Alishani: Unë s'po di se di a jam asambleiste, a jam shërbyese civile, a jam krime ekonomike, a jam gjyqtare, a shka jam unë nuk po di.

Antigona Bytyqi: Unë jam duke kërkuar me ditë çfarë materiali me dërgu?

Dafina Alishani: Tre propozime kanë qenë. Propozimet thatë nuk ka kuorum, po e diskutojmë. Bazë ligjore prej tre propozimeve dy të parat kanë edhe është puro në kompetencë të komunës.

Antigona Bytyqi: Tash kur e diskutuam para se me futë në rend të ditës u përmend edhe një komision. Tash a kemi nevojë, a po shohim të arsyeshme me formuar komision apo jo? apo të bëjmë propozim-vendimin vetëm për këtë po e them.

Karanfil Haxhillari: Dafina veç pak, unë kisha thënë mos me shkuar me komision se është telashe në vehte.

Dafina Alishani: Komisionin le ta bëjë kryetari nëse ka vullnet për subvencionim. Për mua subvencionimi.

Antigona Bytyqi: Na jemi tuj fol për qeto dy pika, subvencionimi është diçka tjetër.

Dafina Alishani: Veç pak më fal, me pas pasur vullnetin kryetari shumë lehtë ish kry kjo puna e subvencionimit. E kishe bë një thirrje i kishe qit kriteret. Ti e kishe përcaktuar si qysh është bërë në pandemi. Pandemi, kush është dëmtuar e kanë pasur kriteret, sa punëtorë, sa krejt i ke paraqit edhe ja ke subvencionuar, me pas vullnetin, tash nuk e ka vullnetin! Ideja e komisionit erdh prej Kujtimit mos po na bind me u tërheq prej kësaj pune. Nëse don ekzekutivi, ju jeni ekzekutiv, grahni bëni edhe komision, edhe vlerësim, edhe dilni në terren. Por këto të dyja janë në dorën e komunës.

Antigona Bytyqi: Po urdhëro Florent.

Florent Ukaj: Kryesuese, sa po mund me e kuptuar unë këta e kanë bërë një propozim që të lirohen prej pagesës prej hapësirave publike në zonën historike. Tash besoj që ne krejt e dimë ku është zona historike, në bazë këta e kanë, këta janë propozues, s'na mbetet neve të tjerëve diçka tjetër më. Veç qite në votim propozimin apo kalon ajo edhe krejt në rregull është.

Antigona Bytyqi: Deshta që me u qartësu se tash me votuar këtë, anej komisioni u përmend, unë këtë desha me qartësu.

Blerim Rakaj: Nëse munden me u saktësu Kryesuese, sepse gjashtë muaj u përmend, por prej cilit muaj deri në cilin.

Antigona Bytyqi: A mundet me u saktësu?

Karanfil Haxhillari: Shihe, propozimi është subvencionimi i bizneseve që veprojnë brenda qendrës historike të qytetit të përfshirë në vehte, e kemi të shkruar. Faljen e borgjit të taksave komunale për shfrytëzimin e hapësirave publike për gjashtë muajt e kaluar dhe lirimin nga taksat për gjashtë muajt e ardhshëm. Po pajtohemi që është shumë, a e din. Le të mbetet vetëm për gjashtë muajt.

Blerim Rakaj: Prej cilit muaj deri në cilin muaj? Po veç gjashtë muaj.

Karanfil Haxhillari: Tre muaj të kaluar se i bjen prej qysh bëhen këto pagesat. Prill, maj qershor, korrik, gusht, shtator.

Dafina Alishani: Këta i kanë takso krejt, kanë dal në terren ja kanë marrë paret poleni, tash po menoni.

Karanfil Haxhillari: Një, edhe e dyta është lirimi nga pagesa e qirasë nga muaji mars deri në dhjetor, po prapë këta bëjnë në përputhje me tjetrën.

Blerim Rakaj: Domethënë prej muajit prill me të dyja? Lirim nga pagesa për qira lokaleve pronë komunale, po edhe për hapësirat publike që shfrytëzohen për karrige dhe tavolina.

Karanfil Haxhillari: Po edhe treshi hiqet komplet, domethënë që është kompenzimi i humbjes së biznesit gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve duke llogaritur diferencën në mes të hyrave. Këtë treshin po e hjekim, vetëm këto dy të para, po besoj jemi të qartë dhe pa komplikuar, zona historike e qytetit.

Blerim Rakaj: Më duhen për një propozim-vendim me bë. Atëherë e para me u liruar lokalet pronë komunale për periudhën prill- shtator, edhe hapësira publike që shfrytëzohen për karrika dhe tavolina në zonën historike, krejt zonën historike apo kërkesa është edhe aty ku s'ka pasur punime në ato pjesë?

Karanfil Haxhillari: Po.

Bajram Kastrati: Është humbje kohe për KPF-në, edhe për kuvendarët. Jo veç, pasi ne e mbajtëm një takim, u dash me i diskutuar këto sene më herët bre Fil edhe me Blerimin edhe me atë tjetrin kush ke.

Karanfil Haxhillari: O Bajram, kjo nuk është bre se jemi qu na në një mëngjes, a e din jemi qu në krah të djathë apo të qmajtë edhe hajde po propozojmë. Këto janë kërkesa të bizneseve.

Bajram Kastrati: Qashtu po duket o Fil, vallahi që shtu duket.

Antigona Bytyqi: Hajde a po gjesim votim? Atëherë meqë u qartësuam pak a shumë, tash kjo po i bie si pikë tetë. Prezent jemi tetë anëtarë. Kush është për që ti rekomandohet mbledhjes së nesërme. Katër për, katër kundër!

Dafina Alishani: Ka ardhur dita me përdorur. Votimin e dyfisht!

Antigona Bytyqi: Po erdhi, atëherë edhe kjo pikë i rekomandohet mbledhjes së ardhsmë. Kjo është kryesuesja që janë të gjithë. Kalojmë te pika e fundit.

Pika e nëntë:

Antigona Bytyqi: Ndarja e fondit për ndihmë bujqësore apo qysh?

Florent Ukaj: A ti e vlerësoje, unë nuk e vlerësoj.

Bajram Kastrati: Lenti, qysh e ke menduar këtë tash pasi veç e kemi në rend dite?

Antigona Bytyqi: Blerimi e ka fjalën.

Blerim Rakaj: Mjetet e para, Ministria gjithmonë nëse ndanë fonde për ndihmë prej të komunës kërkon me i pasur të planifikuara, me u dit ku kanë me u marrë ato mjete. Nëse nuk i ke të përcaktuara saktësisht ku i merr, Ministria ta kthen të kundërligjshme. Se a ka mundësi, a është pyet ekzekutivi në përgjithësi, se a kanë mjete në dispozicion për me mund me i nda me i paguar qato dëme. Nëse nuk ka mjete, vjen i kundërligjshëm.

Florent Ukaj: Unë si kuvendar po e propozj, tani ku e marrin është punë e ekzekutivit.

Blerim Rakaj: Ta zëmë kur ta bëjmë vendimin duhet me e shënu prej cilës kategori kanë me u marrë mjetet?

Florent Ukaj: Prej Subvencioneve a bënë?

Blerim Rakaj: Edhe prej subvencioneve shkojnë me plainifikim. Me u liruar prej pagesës prej të hyrave vetanake mundet me u bë, mirëpo me ndarë mjete nëse s'ka të planifikume nuk mundet me u bë, por ju e dini qysh vendosni.

Florent Ukaj: Ne jse de, por nëse s'ka vullnet me ju ndihmuar bujqve që përnime janë dëmtuar atëherë përgjegjësia bjen te këta.

Bajram Kastrati: Kjo ndihmë zakonisht shkon prej Ministrisë Lenti, ti e din. Po propozimi konkret tash i yti që është që jemi ne për.

Florent Ukaj: Të ndahet buxhet i veçantë për dëmet e shkaktuara në bujqësi për vitin 2023 nga fatkeqësitë natyrore.

Bajram Kastrati: Kur me u planifiku, tash me këtë buxhetin e ri apo kur? A është pyetja qekjo.

Blerim Rakaj: Për momentin buxhetin aktual se di a ka të planifikuara.

Bajram Kastrati: Se ne jemi për, por a realizohet?

Florent Ukaj: Sa kam mund me parë në buxhet ka qenë një fond i veçantë, u kanë një fond për fatkeqësitë.

Blerim rakaj: Nëse ka mjet në dispozicion, diskutojeni edhe në seancë.

Florent Ukaj: Unë e kam bërë edhe vitin e kaluar si propozim këtu, u fol që vitin e ardhshëm.

Bajram Kastrati: Ama propozimi më kanë konkret, të ndahet prej këtij buxheti kjo edhe tani me na pyet kryesuesja a jemi për apo kundër a po kupton?

Florent Ukaj: Ose prej të hyrave vetanake, a mundet me shku prej të hyrave vetanake kjo?

Bajram Kastrati: Se kjo po bjen veç si diskutim.

Blerim Rakaj: Por a ka të planifikime sepse planifikohen gjithmonë ku kanë me shku.

Florent Ukaj: Ne e kemi në sistemin e grave lehona që janë subvencionuar.

Blerim Rakaj: Janë të planifikuara ato.

Florent Ukaj: Po a mund me planifikuar edhe në këtë buxhetin e ardhshëm për këto.

Blerim Rakaj: Në buxhetin e ardhshëm po, po deri tash nuk mundesh.

Florent Ukaj: Na ashtu, kështu po e dimë ata janë duke i pritë qe dy vjet e kam.

Antigona Bytyqi: Nesër çka kemi me bë.

Blerim Rakaj: Ose eventualisht, ju e dini prap qysh vendos unë po jap ato sygjerimet e mia. Ndoshta më e qit eventualisht nëse doni si diskutim edhe ndoshta nga ekzekutivi dikush me sqaruar a ka mundësi apo s'ka. S'kisha rekomanduar me shti miratim i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve kur se ku ke me i marrë mjetet.

Antigona Bytyqi: A ta lëmë vetëm diskutim?

Bajram Kastrati: Florent, a ka mundësi propozimin që e dhe ti, veç me na treguar formën qysh edhe ne me votuar, çka kemi me votuar ne, a po kupton? Cili është propozimi konkret që ne atë buxhet kemi me marrë me ja propozuar drejtorit edhe ne me votuar.

Florent Ukaj: Propozimi, drejtori e di më mirë se krejtë, besoj që deklarohet edhe nesër. Raportet prej terreni krejt i ka drejtori që ba, i kanë lyp edhe foto me krejt i kanë, kanë edhe shifra të caktuara për secilin bujk kush sa ka dam.

Bajram Kastrati: Për ministri janë ato.

Florent Ukaj: Jo jo, pa marrë parasysh që për ministri, mundesh me marrë informa prej raportit edhe me i bë një fond të veçantë që me u nda mjetet.

Dafina Alishani: Florenti po thotë e ki identifikimin e dëmit.

Bajram Kastrati: Ajo nuk diskutohet, ajo është bërë për ministrinë identifikimi. Tash mbasi e kemi ne, e kemi ne, gjithçka është ok. Po ne çka me votu nesër te propozimi yt?

Florent Ukaj: Me votu me ju nda fond.

Bajram Kastrati: Kur me ju nda? A din me qenë pak më konkret, a me nda për buxhetin e ardhshëm a tash? Nëse thotë drejtori s'ka hapësira atëherë çka me bë.

Florent Ukaj: Pse s'ka hapësirë, për çfarë për çfarë arsye s'ka hapësirë?

Blerim Rakaj: Nuk mundesh me marrë vendim për në të ardhmen, në të ardhmen mirret vendim kur të bëhet buxheti i 2025.

Bajram Kastrati: A po kupton, ja jemi të gjithë për ja..

Dafina Alishani: Veç pak, Zyra e Kryetarit ka një buxhet për subvencionime që mundet me e shfrytëzuar. Pse s'po mundet me e shfrytëzuar?

Florent Ukaj: Kjo është kjo është një propozim konkret që ja jep, 400.000 euro diku vlera krejt sa kam mund me pa.

Bajram Kastrati: Veç edhe diçka Lenti. Nëse është 400.000 euro, ministria e ndihmon diku me 30-40% nuk e ndihmon krejt dëmin që u shkaktu.

Florent Ukaj: Ani de edhe ne po ja ndihmojmë edhe bëhet 100%.

Bajram Kastrati: Veç duhet me pas parasysh qeta. Ministria ka si rregull 30% më duket.

Florent Ukaj: S'po kuptoni ose spo doni me kuptu.

Bajram Kastrati: Dafina ke më konkrete, po e kërkojmë prej subvencionimit të buxhetit të kryetarit. Okej edhe propozohet që me ditë edhe Kryesuesja.

Blerim Rakaj: Edhe te subvencionet te kryetari zakonisht planifikohen subvencionet ku shkojnë. A ka në dispozicion mjete?

Florent Ukaj: Kqyere tash diçka, qeta bujqit janë dëmtuar me të vërtetë nuk po e them unë këtë. Domethënë është komisioni që u formua që ka shkuar me kerr 04Z komuna e Prizrenit ka shkru, edhe ka dalë një komision prej gjashtë personave nëpër secilën fushë, e ka bërë fotografimin edhe vlerësimin e dëmit. Edhe që një vjet e sa po bëhen nuk kanë marrë asnjë send hiç. Tash ne unë tuj e kajt hallin e qatyne po e propozoj që, ku i merr kryetari i parat ose ekzekutivi ose Drejtori i Bujqësisë, përderisa ka para me qit çdo në buxhet, çdo vjet nga 6-700.000 euro me i qit nëpër rrugë fushore ose male, hiç nuk kanë nevojë buqit me i qu në male ata, ata kanë nevojë në fusha me me i dalë në krah. Drejtori i Bujqësisë le ta planifikojë ku ka me i parapa tek e fundit ajo nuk është problemi jem tek e fundit qysh ka me marrë tek ka me marrë. Ai planifikimin le ta bëj ku edhe s'ka lidhje që vonohen edhe pesë gjashtë muaj, se kanë pritur qe një vjet, pesë gjashtë muaj. Kryesorja me ditë cilën ditë asambleja ka marrë, ose hiç mos t'i paguajnë, tek e fundit mos ti paguajnë hiç. Por kur të vjen fushatë na i kallëzojnë që ky drejtori me këtë kryetari nuk ka dashur me i paguar qato dëmët që i kanë pasë familjarët.

Blerim Rakaj: Florent, për qëndrimet politike ose tjera nuk më përket mua. Po mundohem procedurën ligjore. Edhe te rastet e fatkeqësive ligji qysh e parasheh formohet komisioni, raportin e komisionit e miraton kryetari, kryetari mandej me propozim shkon në asamble për me u miratu. Në këtë formë mos po tejkalohet kryetari?

Florent Ukaj: Kryetari, në fushatë zgjedhore ka premtuar për fatkesësitë 2 milionë euro për. Përderisa e ka dit me bë atëherë.

Blerim Rakaj: Për premtimet politike unë nuk mund të deklarohe.

Florent Ukaj: Po ne për politikë kemi ardhë këtu me bë, s'kemi ardhur këtu me.

Blerim Rakaj: Jo, unë po mundohem për procedurat ligjore. Ministria, nëse merret ky vendim pa u përcaktuar ku janë mjetet edhe a ka mjete, ka me ardhë i kundërligjshëm ky vendim.

Florent Ukaj: O te subvencionet, o i gjen diku.

Blerim Rakaj: Nëse s'ka nuk bënë sepse Ministria e Financave e këqyr ku i ke të planifikuara.

Florent Ukaj: A ma tregon veç pak qysh ka shkuar te nënat lohona qysh ka shkuar?

Blerim Rakaj: Për nënat lehona në 2022, s'kanë mundur për shkak se s'kanë qenë të planifikuara në buxhet, ndërsa për vitin 2023 në janë paraparë.

Florent Ukaj: Po a mujna na tash në buxhetin e vitit të ardhshëm me shti këtë?

Blerim Rakaj: Po, por vendimarrjen s'mundesh pa e votu buxhetin s'mundesh me marrë vendim për 2025-tën qetash.

Florent Ukaj: E bëjmë ne një propozim le të del të deklarohet edhe kryetari edhe Blerimi edhe të tjerët, edhe.

Blerim Rakaj: Por Unë s'kam çka me shkruar në Propozim-vendim ku me i cekë, prej cilës kategori buxhetore?

Florent Ukaj: Qaty p.sh qysh dha propozim Dafina, prej subvencioneve me marrë.

Blerim Rakaj: Ose unë po mendoj më e arsyeshme, le të merren edhe mundësitë e ekzekutivit, më e arsyeshme personalisht në procedurën ligjore po më duket me e qit diskutim dhe me e këqyr nëse ka hapësira edhe mundësi.

Florent Ukaj: Po e dimë që po shkon tani diskutimi, e dimë krejt qysh po përfundon, lihet pikë e fundit edhe e dimë qysh përfundon.

Dafina Alishani: Sa është totali?

Florent Ukaj: Afër 400.000 euro.

Dafina Alishani: Pse s'po ja bëjmë ani me përqindje, me thënë kaq përqindje me.

Florent Ukaj: Po mundemi na edhe me përqindje me bë me caktuar.

Bajram Kastrati: Edhe ministria nuk e mbulon 100%.

Antigona Bytyqi: Qeto po dojmë me e qartësu se çka me shkru në propozim-vendim?

Blerim Rakaj: Po, se nuk e kemi as Drejtorin e Financave, ku janë planifikimet, se unë s'po e di krejt buxhetin ku janë dhe sa janë.

Karanfil Haxhillari: Leje bre herën tjetër.

Dafina Alishani: Jo jo tash është koha, mirë e ka.

Florent Ukaj: Qite në votim Kryesuese.

Antigona Bytyqi: Çka me shkruar propozim-vendim? Sepse sot duhet me bë gati.

Bajram Kastrati: Duhet me qenë ma të arsyeshëm, për kur me u nda me buxhetin e ardhshëm apo tash?

Florent Ukaj: Ku të gjejnë hapësirë këta, kudo që mund me i marrë.

Bajram Kastrati: Propozimi i Dafinës ke është shumë konkret. Nëse ti vjen me atë propozim edhe me lut kryetarin me nda edhe me qitë.

Dafina Alishani: Po veç edhe diçka duhemi me pas parasyshë. Ju po thoni duhet me planifiku, fatkeqësitë natyrore s'mundesh me i planifikon.

Blerim Rakaj: Fatëkeqësitë natyrore për kësi raste zakonisht paguhen prej qeverisë.

Florent Ukaj: Prej mallërave dhe shërbimeve a mundet me u marrë Blerim?

Dafina Alishani: Zyra e Kryetarit ka subvencione.

Egzona Hoxhaj: Florent, a mundesh me um ngu 2 minuta. Pse nuk po e bëjmë për 2025 edhe le të jetë kjo një opsion për me pagu edhe le të jetë kjo një lloj planifikimi. Le të jetë si kod buxhetor për krejt vitet e ardhshme që mu nda një fond. Këta po thojnë se kena na për fatkeqësi natyrore.

Dafina Alishani: Qysh se kemi.

Florent Ukaj: I keni qitë bujqit shumë në lajthitje, domethënë e kanë marrë qeta që ministria, ju ka publiku shifra, une e di x personi borgj ka hy borgj tuj mendu që ka me i marrë në fund të vitit, seriozisht po foli e ka pa vlerësimin e dëmit edhe me xenta e kanë nxjerrë sa kanë me i marrë, edhe ai tuj mendu që jo këtë muaj, jo qe në ministri, keni mi marrë paret edhe borgj ka hy njeri, hajgare është kjo, këta e dinë ku i marrin.

Bajram Kastrati: Lenti, edhe subvencionimi edhe ndihma për bujqit në kësi raste bëhet prej ministrisë, drejtoria e ka për detyrë veç me dalë me bë vlerësimin.

Florent Ukaj: O Bajram, në rregull është.

Bajram Kastrati: Kjo pjesa tjetër që ne po dojmë me ju ndihmu bujqve, është shumë normale kërkesa jote.

Florent Ukaj: Ka ndarë ministria saherë.

Bajram Kastrati: Jo që ka ndarë, por e ka obligim, jo veç për Prizrenin.

Florent Ukaj: Ka ndarë disa herë, Peci deklaroj që për Rahovec ka ndarë s'di sa, në Mamushë ka ndarë, kanë marrë prej ministrisë. Për Prizren hala s'kanë dhënë, ne po i shohim që nuk janë tuj dhënë pare edhe pse vlerësimi u bë, ne si komunë duhet me nda një fond të veçantë. Përderisa ju japim klubeve, që duhet me i dhënë hala ma shumë, nuk jam kundër. Përderisa japim në shumë lëmi tjera, qet mundësi na e kemi si.

Bajram Kastrati: është shumë normale kjo që po thu ti.

Florent Ukaj: Pse nuk mujna me nda një fond të veçantë.

Antigona Bytyqi: Kujt me ju drejtu për këtë punë?

Florent Ukaj: Kryetarit të Komunës.

Antigona Bytyqi: Kryetarit,

Blerim Rakaj: Nëse doni mundeni me ja drejtu një rekomandim kryetarit dhe drejtorisë me i evidentu ku janë mjetet e problemet dhe me përgatit një propozim-vendim.

Florent Ukaj: Tana ku i gjen paret ai që po thu ti.

Blerim Rakaj: I kqyrin ato krejt mundësitë ku i kanë.

Florent Ukaj: A mundemi mi ndarë tash me rishikim këto mjete?

Egzona Hoxhaj: Fili tha në qershor u dashtë me u bë rishikimi.

Karanfil Haxhillari: Rishikimi i buxhetit nuk mundet me u ba, qershori është muaji i fundit për rishikim të buxhetit.

Bajram Kastrati: A mundet me shku pika si diskutim dhe rekomandim edhe ti Lenti e përgatit një rekomandim.

Dafina Alishani: Qe bre ku i keni premtimet e kryetarit.

Antigona Bytyqi: Jemi tuj këqyr me bë një zgjidhje edhe.

Blerim Rakaj: Për kuvend të jetë diskutim kurse kryetarit edhe drejtorisë ti shkon një rekomandim.

Dafina Alishani: Po diskutim.

Egzona Hoxhaj: Mirë e ka po më pëlqen ideja, nesër me qu si diskutim edhe me ja qu një rekomandim kryetarit, tani për seancën e...

Levent Bus: Mirë tha Blerimi, me u rregullu për seancën e ardhshme edhe bahet gati edhe me këqyr për 2025 me shti në buxhet edhe në rregull jemi.

Florent Ukaj: Edhe a mundet tani dikush me na ofru mundësitë psh. cilat i ka kryetari?

Levent Bus: E këqyr kryetari bashkë me drejtorin e bujqësisë a ka apo ska mundësi.

Antigona Bytyqi: Tani nëse marrim naj propozim-vendim, unë po planifikoj mbledhjen e korrikut sepse sipas përvojës që e kemi pasë me e lënë kah fundi kemi pasur shumë mungesa, arsytet ma po dihen, kurbetqarët, dasmat, pushimet. Po mundohem, veç kam filluar me u përgatit për me u mbajtë më herët. Atëherë për nesër po mbetet diskutim. Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit dhe shihemi nesër.

Përfundoi në ora: 12.20 minuta.

**Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi**



PROPOZIM

Kryetari i Komunës së Prizrenit në bazë nenit 7. paragrafi 3. të Ligjit për Dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 50. shkronja (a), të Statutit të Komunës së Prizrenit, merr këtë:

VENDIM PARAPRAK **MBI DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR** **ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE**

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit që të merret Vendimi Paraparak për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ngastrën kadastrale nr.1/45 ZK Prizren, Organizatës Shoqërore Civile e cila vepron në territorin e Komunës së Prizrenit, me qëllim të përmbushjes së Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve, shërbimin dhe ofrimin e kuzhinës popullore për familjet sociale dhe ato me nevojë.

Neni 2

Ngastra kadastrale që do të epet në shfrytëzim, pranë zyrës së kadastrit, është evidentuar si pronë komunale KK Prizren me nr.1/45, në sipërfaqe prej 2127 m² ZK Prizren.

Neni 3

Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim organizatës shoqërore civile, konform këtij Vendimi është arsyeshmëria e Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve, shërbimin dhe ofrimin e kuzhinës popullore për familjet sociale dhe ato me nevojë.

Neni 4

Periodha kohore për dhënie e pronës komunale që epet në shfrytëzim është afatshkurtër dhe atë në periudhën prej 15 viteve.

Prona komunale që do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër është në pajtueshmëri me dokumentacionin e planifikimit hapësinor.

Neni 5

Prona Komunale që epet në shfrytëzim afatshkurtër, nuk mund ta ndërron titullarin juridik, pronarin e ngastrës kadastrale mbetet në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe si e tillë nuk mund të epet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit të zgjedhur si fitues në ankand-nuk mund të tjetërsohet, prona nuk mund të jetë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë komunale.

Neni 6

Komuna e Prizrenit e ruan të drejtën kurdo herë sipas nevojës me qëllim të realizimit të interesave shoqërore apo publike të bëjë ndryshimin e kontratës me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

Neni 7

Procedura e dhënies së Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

Neni 8

Obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunimin me organet tjera komunale si dhe në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues të Ofertave për Dhënie të Pronës Komunale në Shfrytëzim, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-092 dhe Rregullores nr.09/2020.

Neni 9

Kryetari Komunës së Prizrenit pas përfundimit të procedurave të tenderimit nga Komisioni Vlerësues, obligohet që të nënshkruajë kontratën mbi shfrytëzimin e pronës komunale në mes të Komunës dhe fituesit të ankandit, ku do të përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e të dyja palëve.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së këtij vendimi nga ana e MAPL-së.

KRYETARI I KOMUNËS

Shaqir Totaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813068-00001-45

| | |
|--|-----------------------------|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 07-029-4348-24-Ç |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 06.06.2024 - 10:01 |
| Komuna / Opština / Municipality: | PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Prizren / Prizren / Prizren |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN |

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m ²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|--|--|---------------------------|---|----------------------------------|---|----------------------------------|
| P-71813068-00001-45 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 2127 | 321-2006 fl par 212/2020 | 09.10.2020 | |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|--|---|---|---|----------------------------------|
| PARK- | | | 09.10.2020 | |

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class | Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²) |
|-------------------|--|--|---|--|
| 1 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | 2127 |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. personal Licni broj ID. No. | Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi postal Poštanski kod Postal code | Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Pershkrimi Opis Description | Azhuruar Azurirano Updated |
|---|---------------------------|---------------------------------------|--|---|---|--|---|----------------------------------|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Prizrenit | 600292057 | /// | | ADEM JASHARI | 1/1 | 07-463-04-62490-24 Vendim: 01-291/24. dt.10.05.2024-Komuna e Prizrenit | 22.05.2024 |




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prizren

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina |
|----------------------|----------------------------|---------------------|
| P-71813068-00001-45 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2127 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Luljeta
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Luljeta



Data/ Data/Date: 06.06.2024
Koha/ Vreme/ Time: 02:45:05



- në largësi më të madhe se 100 m nga lokacionet me ndërtesat e garazheve;
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale;
- në largësi më të madhe se 2000 m nga deponitë e mbeturinave.

8.5. NDËRTESTAT PËR SHËRBIME SOCIALE

Institucionet për shërbime sociale përfshijnë qendrën për punë sociale e cila kryen shërbimet e asistencës sociale, shërbimeve sociale dhe shërbimeve administrative financiare. Ky institucion është i një rëndësie të veçantë pasi që ofrojnë asistencë sociale për një numër të konsiderueshëm të familjeve në nevojë në komunën e Prizrenit.

Sipas standardeve të përcaktuara me NTPH, si dhe bazuar në numrin e popullsisë të planifikuar për komunën e Prizrenit, për periudhën 8 vjeçare të këtij plani nuk planifikohet ndërtimi i objekteve të reja për shërbime sociale.

| ZONË E SHËRBIMEVE – INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE TË MIRËQENIES SOCIALE DHE KOMUNITETIT | | | |
|---|--|-----|--|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | | |
| 3.3.1 | Shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale | | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI- INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE TË MIRËQENIES SOCIALE DHE KOMUNITETIT | | ZSH |
| Sipërfaqja e parcelës | Numri i banorëve (Min.) | | Institucione për shërbime sociale dhe familjare: 0.25 m ² /banor Institucione të komunitetit: 0.20 m ² /banor |
| Vijat | Vija rregulluese | | Përcaktohet me vendosjen e profilit të rrugës |
| | Vija ndërtimore e përparme | VN | Sipas NTPH. |
| | Vija ndërtimore anësore- djathtas/ majtas | VN | Sipas NTPH. |
| | Vija ndërtimore e pasme | VN | Sipas NTPH. |
| Lartësia | Lartësia (min.) | | |
| | Lartësia (maks.) | | |
| | Lartësia e strukturës dytësore (maks.) | | |
| | Raporti (përgjatë rrugës publike) | | 1,5 L / 1 GJ |
| | Raporti (anash) | | 0.5 L / 1 GJ |
| Intensiteti | Raporti (prapa) | | 0.5 L / 1 GJ |
| | IShPKZh | | Maks. 50 |
| | ISN | | Maks. 2.0. |
| | SGJAP | | Min. 50 % |
| | SGJP | | 30% |
| SAP | | 20% | |



| | |
|--------------|---|
| Vend parkime | Shtëpi për të moshuar - 0.5 Vend parkime / 100 m ² |
|--------------|---|

Infrastruktura e institucioneve mirëqenies sociale dhe komunitetit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- në terren të rrafshët;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore).

8.6. NDËRTESTAT E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor përbëhet nga:

1. Ndërtesat e çerdheve: grupmoshat ≤ 3 vjet;
2. Ndërtesat e kopshteve: grupmoshat 3- 5 vjet.

Bauzar në investimet kapitale nga PZHK-ja, sipas nevojave të identifikuara të PZHK-së, dhe Planit të Veprimit, parashihet ndërtimi i 58 çerdheve në kuadër të shkollave ekzistuese dhe shkollave të reja, si dhe ngritja e përmbajtjeve për çerdhe në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Siç është përmendur në Raportin e Vlerësimit të PZHK-së, ndërtimi i këtyre 58 institucioneve parashkollore është realizuar dhe shërbejnë të gjithë fëmijët e zonave përkatëse.

Sipas standardeve të përcaktuara me NTPH, si dhe bazuar në numrin e popullsisë të planifikuar për komunën e Prizrenit, është planifikuar sipërfaqe prej 9,166.8m² për ndërtimin e çerdheve në zonën urbane të komunës, përkatësisht 5 lokacione në zonën urbane të Prizrenit të cilat janë paraqitur saktësisht në pjesën hartografike, në Hartën e Infrastrukturës Publike/ Sociale.

Funksionalizimi dhe ndërtimi i këtyre hapësirave rekreative duhet të bazohet në këto kushte të përgjithshme nga NTPH:

| ZONË E SHËRBIMEVE – INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE | | |
|---|--|---------|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | |
| 3.3.2 | Shërbim arsimor | |
| 3.4.3. | Infrastrukturë sportive | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI – INSTITUCIONE PARASHKOLLORE | ZSH |



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-0076691

Më: 18.06.2024

Prizren



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

| | |
|---------|--|
| Për: | Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prizrenit |
| Nga: | Gazmend Berisha - Bashkëpunëtor profesional pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit |
| Përmes: | Florentina Çoçaj, Zyrtare Ligjore pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit |
| Lënda: | Informim sipas HZK-së |

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar shërbimit të DUPH-së për dhënien e informacionit, rreth Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit për ngastrën Nr. 00001-45 ZK Prizren, ju informojmë si në vijim:

Ngastra kadastrale me nr. P-71813068-00001-45 ZK Prizren, pronë shoqërore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2127 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "Park", me lloj të shfrytëzimit të parcelës tokë tjetër, në shfrytëzim aktual të parcelës jo pjellore dhe është në posedim individual të Komuna e Prizrenit, e evidentuar sipas Certifikatës për njësinë kadastrale nr. P-71813068-00001-45 ZK Prizren, të datës 06.06.2024.

Ndërsa në bazë të Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030, Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, sa i përket lokacionit ku gjendet ngastra në fjalë e njëjta gjendet në kuadër të HZK-së dhe bënë pjesë në Zonën e Shërbimeve.

Informimi për ngastrën në fjalë është lëshuar sipas Certifikatës dhe kopjes së planit për njësinë kadastrale nr. P-71813068-00001-45 ZK Prizren, të datës 06.06.2024.

Të bashkangjitur këtij informimi gjeni pjesën tekstuale sipas HZK- së për Zonën e Shërbimeve, në trembëdhjetë (13) faqe.



| ZONË E SHËRBIMEVE – PARQET PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E HAPURA | | |
|---|--|--|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | |
| 3.4.4 | Hapësirë e hapur rekreative | |
| 3.4.5 | Shërbime tjera rekreative | |
| SHFRYTËZIMET E VEÇANTA | | |
| 4.1.1 | Infrastrukturë e rrjetit rrugor - Hapësira për parkim nëntokësor | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI- PARQET PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E HAPURA | ZSH-P |
| Sipërfaqja parcelave | Numri i banorëve (Min.) | Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m ² /banor; Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m ² /banor; Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m ² /banor; Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m ² /banor |

Hapësirat e gjelbra, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në afërsi të zonave të banimit;
2. në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

8.2. FUSHAT SPORTIVE DHE HAPËSIRAT REKREATIVE

Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative përbëhet nga:

- i. Ndërtesat e stadiumeve;
- ii. Ndërtesat e sallave sportive;
- iii. Ndërtesat sportive shume- funksionale;
- iv. Fushat sportive- rekreative shume- funksionale;
- v. Shtigjet për gara motorike;
- vi. Shtigjet për kalërim;
- vii. Shtigjet për ngjitje dhe marshim alpin;
- viii. Shtigjet për çiklizëm;
- ix. Shtigjet për skijim;
- x. Shkëmbinjte natyror dhe artificial për ngjitje;
- xi. Fushat e golfit.

Zona urbane e komunës së Prizrenit ka një stadium futbollit si dhe disa terrene sportive kryesisht në kuadër të shkollave. Në zonën rurale ekzistojnë disa terrene sportive në kuadër



të shkollave dhe terrene private. Disa prej tyre janë jashtë funksionit për shkak të mungesës së kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme.

Sipas kushteve për themelimin e aktiviteteve publike të paraqitur në PZHK, përveq fushave sportive, rëndësi të veçantë i kushtohet edhe hapësirave rekreative të cilat mund të dizajnohen për panaiere, konvenciale dhe qendra për ekspozitë, akuaparqet dhe objekte të akomodimit të cilat shërbejnë për shëndetin dhe turizmin sportiv. Në zonat e dizajnuara për panaiert dhe festivalet, do të përcaktohen me planet e shkallës së ulët të planifikimit, duke përfshirë funksionet e panaiereve, objekteve konvencionale dhe mbështetjen e objekteve administrative, objekteve sociale dhe infrastrukturës teknike, hapësirat e hapura dhe të gjelbra, objektet akomoduese dhe funksionet komerciale siç janë njësitë shitëse, të gjitha këto në pajtim me planet detaje. Në hapësirat tjera të hapura me rëndësi natyrore, historike dhe kulturore, është thelbësore për organizimin e ngjarjeve festive të zhvilluara në bashkëpunim me organizata dhe institucionet përkatëse.

Me Planin Zhvillimor Komunal janë planifikuar ndërtimi/ funksionalizimi i 10 qendrave sportive në qendrat rurale të cilat tanimë janë realizuar dhe shërbejnë të gjithë banorët e zonave përkatëse. Kështu këto qendra sportive kanë mundësuar aktivizimin e kulturës sportive tek të rinjtë që e përbëjnë numrin më të madh të popullatës në komunën e Prizrenit.

Sipas standardeve të përcaktuara me NTPH, si dhe bazuar në numrin e popullsisë të planifikuar për komunën e Prizrenit, është planifikuar sipërfaqe prej 47 377 m² të shpërndahen në vendbanimet e Gjonaj, Lubizhdës, Velezhës, Zymit dhe Zhurit.

Gjithashtu për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme sportive në zonën urbane, janë përcaktuar katër parcela me sipërfaqe totale 11 338.38 m² në lagjen Dardania. Këto lokacione janë paraqitur saktësisht në pjesën hartografike të dokumentit, përkatësisht në Hartën e Infrastrukturuës Publike/Sociale.

Funksionalizimi dhe ndërtimi i këtyre hapësirave rekreative duhet të bazohet në këto kushte të përgjithshme nga NTPH:

| ZONË E SHËRBIMEVE – INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SPORTIVE DHE HAPËSIRAVE REKREATIVE | | |
|--|---|---------|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | |
| 3.4.2. | Shërbim argëtues | |
| 3.4.3 | Infrastrukturë sportive | |
| 3.4.4 | Hapësirë e hapur rekreative | |
| 3.4.5 | Shërbime tjera rekreative | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI- INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SPORTIVE DHE HAPËSIRAVE REKREATIVE | ZSH |



| | | |
|-----------------------|---|--|
| Dimensionet parcelave | Sipërfaqja e parcelës (Min.) | ≤ 5000 banor: 2.50 m ² /banor $\geq 5001 - 20000$ banor: 4.50 m ² /banor >20001 banor: 5.00 m ² /banor |
| Intensiteti | IShPKZh | Maks. 60 % |
| | ISN | 2.0 |
| | SGJAP | Min. 40 % |
| | SGJP | 25% |
| | SAP | 15% |
| Vend parkime | Numri i Vend parkimeve përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta | |
| Distanca Shërbyese | Distanca optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore është 800 m | |

Infrastruktura e institucioneve të sportit dhe rekreacionit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
2. në lokacion të rrafshët pranë burimeve dhe pasqyrave ujore.

8.3. NDËRTHESAT E INSTITUCIONEVE KULTURORE

Institucionet kulturore në kuadër të komunës së Prizrenit janë të një rëndësie të veçantë, pasi që paraqesin zhvillimin kulutoror dhe shoqëror të komuniteteve. Në zonën urbane dhe në disa vendbanime rurale janë gjithsej 16 qendra dhe shtëpi të kulturës të cilat nuk plotësojnë kushtet bazë për funksionalizim të sigurt si institucione. Në kuadër të shtëpisë së kulturës në zonën urbane funksionon biblioteka e qytetit. Në zonën urbane funksionon edhe teatri i qytetit.

Infrastruktura e institucioneve kulturore përbëhet nga: Ndërtesat e bibliotekave, Ndërtesat e muzeve, Ndërtesat e galerive të arteve dhe sallave ekspozuese, Ndërtesat e 'shtëpive' të kulturës, Ndërtesat e teatrove dhe Ndërtesat e kinemave.

Si obligime që rrjedhin nga PZHK-ja janë ndërtimi i 5 objekteve kulturore me shumë destinime në zonat rurale të komunës, të cilat janë realizuar dhe shërbejnë të gjithë banorët e zonave përkatëse.

Sipas standardeve të përcaktuara me NTPH, si dhe bazuar në numrin e popullsisë të planifikuar për komunën e Prizrenit, është planifikuar sipërfaqe prej 3 700 m² të shpërndahen në vendbanimet e Romajës, Lubizhdës dhe Zhurit.

Funksionalizimi dhe ndërtimi i këtyre ndërtesave të institucioneve kulturore bazohet në NTPH si në vijim.



| ZONË E SHËRBIMEVE – INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE KULTURORE | | |
|---|--|--|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | |
| 3.4.1. | Shërbim kulturor | |
| 3.4.5. | Shërbime tjera rekreative | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI- INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE KULTURORE | ZSH |
| Dimensionet e parcelave | Sipërfaqja e parcelës (Min.) | Ndërtesat e bibliotekave: 0.25 m ² /banor Ndërtesat e teatrove: 0.20 m ² /banor Ndërtesat e kinemave: 0.20 |
| Intensiteti | IShPKZh | Ndërtesat e bibliotekave: 60% Ndërtesat e teatrove: 80% Ndërtesat e kinemave: 80% |
| | ISN | 2.0 |
| | SGJAP | Min. 20- 40 % |
| | SGJP | 10-25% |
| | SAP | 10-15% |
| Vend parkime | Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike – 1Vend parkim/100m ² | |

Infrastruktura e institucioneve kulturore, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- në pjesën/ pjesët qendrore të vendbanimeve;
- në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
 - në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
 - në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
 - në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
 - në largësi më të madhe se 100 m nga ndërtesat e garazheve.



8.4. HAPËSIRAT DHE NDËRTIMET PËR SHËRBIME MJEKËSORE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në zonën urbane të komunës shërben të gjithë banorët e komunës së Prizrenit.

Në bazë të NTPH, popullsia e vendbanimeve të komunës së Prizrenit lejojnë ndërtimin e institucioneve shëndetësore të nivelit parësor (QKMF, QMF dhe PMF), dytësor (Ndërtesat e spitaleve të përgjithshme dhe specialistike me njësitë përbërëse, poliklinikave specialistike, ambulancave specialistike, ambulancave stomatologjike, qendrave të shëndetit mendor me Shtëpinë për integrim në bashkësi, qendrave të transfuzionit të gjakut, qendrave të rehabilitimit fizik dhe klimatik, qendrave të mjekësisë sportive, qendrave të mjekësisë së punës, qendrave rajonale të shëndetësisë publike, qendrave për rehabilitimin e të dëgjuarit dhe të folurit) dhe nivelin tretësor (Ndërtesat e qendrave klinike universitare, qendrave klinike universitare stomatologjike, instituteve kombëtarë të shëndetësisë publike, qendrave kombëtare të mjekësisë së punës, qendrave kombëtare të mjekësisë sportive, qendrave kombëtare të transfuzionit të gjakut, qendrave kombëtare të telemjekësisë) që si kusht për zhvillim ka vendbanimet me më shumë se 100 000 banorë.

Sipas PZHKP-së, parashihet fokusimi i institucioneve shëndetësore nëpër fshatërat qendrore, duke ofruar infrastrukturë të mjaftueshme për qasje të lehtë nga fshatërat e tjera rurale. Në bazë të numrit të banorëve të planifikuar në zonën urbane, nevojitet ndërtimi i institucioneve të reja shëndetësore apo rritja e kapaciteteve të institucioneve ekzistuese.

Funksionalizimi dhe ndërtimi i këtyre hapësirave rekreative duhet të bazohet në këto kushte të përgjithshme nga NTPH:

| ZONË E SHËRBIMEVE - INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE | | | |
|--|---|----|--|
| HILUCS | SHFRYTËZIMET E LEJUARA | | |
| 3.3.3. | Shërbim shëndetësor dhe shoqëror | | |
| KUSHTET ZHVILLIMORE & NDËRTIMORE | ZONA | | Simboli |
| | ZONË SHËRBIMI- INFRASTRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE | | ZSH |
| Sipërfaqja e parcelës | Numri i banorëve (Min.) | | Niveli parësor: 0.20m ² /banor Niveli dytësor: 1.20m ² /banor |
| Vijat | Vija rregulluese | | Përcaktohet me vendosjen e profilit të rrugës |
| | Vija ndërtimore e përparme | VN | Sipas NTPH. |
| | Vija ndërtimore anësore- djathtas/ majtas | VN | Sipas NTPH. |
| | Vija ndërtimore e pasme | VN | Sipas NTPH. |

KOMUNA E PRIZRENIT
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 Harta Zonale e Komunës së Prizrenit 2021-2029



| | | |
|---------------------------|---|--------------|
| Lartësia | Lartësia (min.) | |
| | Lartësia (maks.) | |
| | Lartësia e strukturës dytësore(maks.) | |
| | Raporti (përgjatë rrugës publike) | 1,5 L / I GJ |
| | Raporti (anash) | 0.5 L / I GJ |
| | Raporti (prapa) | 0.5 L / I GJ |
| Intensiteti | ISHPKZh | Maks. 50% |
| | ISN | Maks. 2.0 |
| | SGJAP | Min. 50 % |
| | SGJP | 30% |
| | SAP | 20% |
| Vend parkime | Ndërtesat e spitaleve, klinikave,qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme - 1 Vend parkime / 100 m ² | |
| | Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit - 3 Vend parkime / 100 m ² | |
| | Shtëpi për të moshuar - 0.5 Vend parkime / 100 m ² | |
| Distanca Shërbyesë | Ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare: 10 km; Ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare: 3 km; | |

Infrastruktura e institucioneve të shëndetësore të nivelit parësor, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ndotura;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industrial

Infrastruktura e institucioneve të shëndetësore të nivelit dytësor, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- në vendbanime me popullsi më të madhe se 10000 banor;
- në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ndotura;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;



PROPOZIM

Kryetari i Komunës së Prizrenit në bazë të nenin 17 dhe nenit 19 paragrafi 1 dhen 2, pika 2.1, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 17 dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e proceduarve të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në bazë të nenit 50 të Statutit të Komunës së Prizrenit, merr këtë:

V E N D I M **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

Neni 1

Themelohet Komisioni Vlerësues prej pesë (5) anëtarësh në përbërje prej dy (2) deputetëve të Kuvendit të Komunës (emrat dhe mbiemrat), dy (2) përfaqësuesve të ekzekutivit të Komunës (emrat dhe mbiemrat) dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, për vlerësimin ekonomik të ofertave pas mbylljes së ankandit, për dhënien e pronës komunale dhe atë ngastrën kadastrale nr.1/45 ZK Prizren, OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Prizrenit.

Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës për shpalljen e ankandit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale formohet komisioni vlerësues.

Neni 2

Kompetencat e Komisionit do të jenë ato kompetenca të parapara konform dispozitave të neneve të përshkruara më lartë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) për Përcaktimin e proceduarve për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit dhe Njësit përkatëse të Administratës së Komunës që i ofrojnë përkrahje komisionit vlerësues.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së këtij vendimi nga ana e MAPL-së.

KRYETARI I KOMUNËS

Shaqir Totaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR
KOMUNËN E PRIZRENIT 2024-2029**

Përmbajtja

| | |
|---|------------------------------|
| Lista e Shkurtesave | 4 |
| Lista e Figurave | 6 |
| Lista e Tabelave | 7 |
| Grupi Punues (GP) | 8 |
| Fjala hyrëse nga Kryetari i Komunës | 9 |
| Përmbledhje Ekzekutive | 11 |
| Përshkrimi i shkurtër i qëllimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal | 12 |
| Objektivat e përgjithshme të SZHEL - (njihen edhe si prioritete) | Error! Bookmark not defined. |
| Objektivi 1: Ekonomi lokale konkurruese | Error! Bookmark not defined. |
| Objektivi 2: Punësim gjithëpërfshirës | Error! Bookmark not defined. |
| Objektivi 3: Infrastrukturë lokale e përmirësuar | Error! Bookmark not defined. |
| Objektivi 4: Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese | Error! Bookmark not defined. |
| Hyrja | 13 |
| Pse hartohet strategjia? | 14 |
| Metodologjia | 15 |
| Misioni | 17 |
| Vizioni | 17 |
| Sfondi | 17 |
| Analiza e gjendjes aktuale | 20 |
| Demografia e Komunës | 20 |
| Shtrirja gjeografike | 26 |
| Administrata | 27 |
| Arsimi | 35 |
| Infrastruktura | 38 |
| Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale | 45 |
| Bujqësia dhe Zhvillimi Rural | 48 |
| Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore | 50 |
| Përkufizimi i problemit | Error! Bookmark not defined. |
| Krahasimi me vendet/komunat tjera | 58 |

| | |
|---|------------------------------|
| Analiza SËOT | 60 |
| Analiza e pemës së problemit (opcionale) | Error! Bookmark not defined. |
| Përmbledhja e sfidave..... | 62 |
| Sfidat në sektorin e arsimit | 62 |
| Sfidat në sektorin e Infrastrukturës | 63 |
| Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 63 |
| Sfidat në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 64 |
| Sfidat në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore | 65 |
| Objektivat..... | 65 |
| Objektiva e përgjithshme 1: Arsimi | 65 |
| Objektiva e përgjithshme 2: Infrastruktura..... | 66 |
| Objektivi i përgjithshëm 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale | 68 |
| Objektivi i përgjithshëm 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural..... | 68 |
| Objektivi i Përgjithshëm 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore..... | 69 |
| Monitorimi dhe Raportimi..... | 70 |
| Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor | 71 |
| I. Plani i Veprimit..... | 72 |

Lista e Shkurtesave

| | |
|---|----------|
| Grupi Punues..... | GP |
| Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug..... | AZHR Jug |
| Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal..... | SZHEL |
| Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030..... | PNZHEL |
| Plani Zhvillimor Komunal..... | PZHK |
| Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020..... | PHK |
| Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr.2003/14..... | LPH |
| Harta Zonale 2020-2028..... | HZ |
| Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats..... | SWOT |
| Ekipi Rajonal për Projekte Komunale..... | ERPK |
| Agjencia e Statistikave të Kosovës..... | ASK |
| Biznes Individual..... | B.I |
| Ortakëri e Përgjithshme..... | O.P |
| Shoqëri Aksionare..... | SH.A |
| Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar..... | SH.P.K |
| Ortakëri e Kufizuar..... | O.K |
| Degë e Shoqërisë së Huaj..... | DSHH |
| Kooperativë Bujqësore..... | K.B |
| Drejtoria e Shërbimeve Publike..... | DSHP |
| Kompania Rajonale e Ujësjesit..... | KRU |
| Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave..... | RKMM |
| Plani Lokal i Mjedisit..... | PLM |

| | |
|---|-------|
| Leje Mjedisore Komunale..... | LMK |
| Qendra për Punë Sociale..... | QPS |
| Skema e Asistencës Sociale..... | SAS |
| Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit..... | AKK |
| Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik..... | DTZHE |
| Organizata Jo Qeveritare..... | OJQ |
| Klubi i Futbollit..... | KF |
| Shkolla e Futbollit..... | SHF |
| Klubi i Veteranëve të Futbollit..... | KVF |
| Klubi i Basketbollit..... | KB |
| Klubit Sportiv..... | KS |
| Klubi i Mundjes..... | KM |
| Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë..... | MASHT |
| Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve..... | ZHPM |

Lista e Figurave

Fig.1 - Prizreni multi-etnik

Fig.2 - Zhvillimi social dhe ekonomik

Fig.3 - SHFMU "Mati Logoreci"

Fig. 4 - Grafiku i përbërjes së mbeturinave në përqindje

Fig.5 - Shtigje të ecjes në malet e Sharrit

Fig.6 - Liqenet e maleve të Sharrit

Lista e Tabelave

Tab. 1 -Popullsia e komunës së Prizrenit sipas etnicitetit dhe gjinisë

Tab. 2 – Ekonomitë familjare pernga numri i anëtarëve

Tab. 3 - Popullsia e komunës së Prizrenit sipas vendbanimit dhe etnicitetit

Tab. 4 – Tabela e banorëve sipas vendbanimit dhe grupmoshave

Tab. 5 – Notat dhe mesatarja e nxënësve në shkollat e komunës së Prizrenit

Tab. 6 – Shënime për infrastrukturën rrugore

Tab. 7 – Sipërfaqet tokësore sipas pronësisë

Tab. 8 – Parkingjet

Tab. 9 – Të dhënat për kanalizimet

Tab. 10 – Të dhëna për ujin

Tab. 11 – Të dhëna për mbeturinat

Tab. 12 – Baza ligjore

Tab. 13 – Tabela e llojit të mbeturinave sipas përqindjes dhe viteve

Tab. 14 – Të dhëna për mjedisin

Tab. 15 - Skema tabelare e familjeve dhe anëtarëve të familjeve të cilët gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale

Tab. 16 – Kulturat bujqësore në ha (km²)

Tab. 17 – Përbërja e fondit blegtoral për frymë blegtorie

Tab. 18 – Kulturat vjeshtore sipas llojit në ha

Tab. 19 – Kulturat pranverore sipas llojit në ha

Tab. 20 – Analiza SWOT

Grupi Punues (GP)

1. Kujtim Gashi, nënkryetar i komunës së Prizrenit – kryesues i grupit
2. Ramadan Tarashaj, drejtor i Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
3. Çelë Lamaj, drejtor i Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpetimit
4. Sulltan Badallaj, drejtor i Buxhetit dhe Financave
5. Ramize Shala, drejtoreshë e Emergjencës dhe Sigurisë
6. Bexhat Bytyqi, drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
7. Nderim Bytyqi, drejtor i Agjencisë për Zhvillim Rajonal – Jug
8. Ekipi i Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug)

Fjala hyrëse nga Kryetari i Komunës

Të nderuar/a bashkëqytetarë/e të komunës së Prizrenit,

Sot kam nderin për të shkruar një çështje me rëndësi të madhe për të gjithë ne: zhvillimin ekonomik të komunës sonë të dashur. Prizreni multietnik, me historinë e tij të pasur dhe kulturën e gjallë, ka potencial të jashtëzakonshëm për rritje dhe prosperitet. Por për të zhbllokuar këtë potencial, ne duhet t'i përqendrojmë përpjekjet tona në të ardhmen e Prizrenit – rininë tonë – dhe të sigurojmë që mundësitë për avancim të jenë të disponueshme për të gjithë, pavarësisht nga gjinia.

Të rinjtë tanë janë shtylla kurrizore e ekonomisë së Prizrenit. Ata janë inovatorët, sipërmarrësit, punëtorët që do ta çojnë komunën tonë përpara. Megjithatë, shumë nga të rinjtë tanë ndihen të detyruar të kërkojnë mundësi diku tjetër, duke lënë pas një pasuri talentesh dhe energjie që mund të shfrytëzohen për përmirësimin e komunitetit tonë. Ne duhet të krijojmë një mjedis që inkurajon të rinjtë tanë të qëndrojnë, të ndërtojnë jetën dhe karrierën e tyre këtu në Prizren.

Kjo do të thotë investim në programe arsimore dhe trajnimi që pajisin rininë tonë me aftësitë e nevojshme për punët e së ardhmes. Do të thotë ofrimi i çasjes në kapital dhe mentorim për ata që kanë pasion për të filluar bizneset e tyre. Dhe kjo do të thotë të sigurohemi që të rinjtë tanë të kenë një vend në tavolinë në proceset vendimmarrëse, në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet dhe perspektivat e tyre të vlerësohen.

Por zhvillimi ekonomik i Prizrenit nuk mund të arrihet pa barazi gjinore. Për një kohë të gjatë, gratë dhe vajzat janë përballur me sfida për pjesëmarrjen e tyre të plotë në ekonominë tonë. Kjo jo vetëm që është e padrejtë, por edhe kufizon potencialin tonë për rritje. Kur grave u jepet mundësia për të pasur sukses, ato bëhen shtytëse të fuqishme të zhvillimit ekonomik, duke krijuar vende pune dhe prosperitet nga të cilat përfitojnë komunitete të tëra.

Ne duhet të punojmë për të thyer barrierat që qëndrojnë në rrugën e pjesëmarrjes së plotë të grave në ekonominë tonë. Kjo nënkupton zbatimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore, të tilla si paga e barabartë për punë të barabartë, kujdesi i përballueshëm për fëmijët dhe mbrojtja kundër diskriminimit dhe ngacmimit. Do të thotë t'u ofrohet grave çasje në arsim, trajnim dhe kapital, në mënyrë që ato të mund të fillojnë biznese dhe të ndjekin karrierë në të gjitha fushat. Dhe kjo do të

thotë të sigurohet që gratë të përfaqësohen në pozita udhëheqëse, ku mund të marrin vendime nga të cilat përfitojnë e gjithë komuna jonë.

Duke u fokusuar tek të rinjtë tanë dhe duke promovuar barazinë gjinore, ne mund të krijojmë një ekonomi të lulëzuar në Prizren nga e cila përfitojnë të gjithë qytetarët. Një ekonomi që ofron vende pune të mira, stimulon inovacionin dhe ngre më të rrezikuarit mes nesh. Një ekonomi që e bën Prizrenin një vend ku të rinjtë duan të qëndrojnë, ku gratë mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe ku të gjithë kanë mundësi të kenë sukses.

Ky është vizioni për të ardhmen e Prizrenit për të cilin propozoj të punojmë. Nuk do të jetë e lehtë dhe nuk do të ndodhë brenda natës. Por me vendosmëri, punë të palodhur dhe përkushtim ndaj vlerave të drejtësisë dhe barazisë, kam besim se ne mund ta bëjmë realitet këtë vizion.

Le ta nisim këtë rrugëtim së bashku, për të mirën e Prizrenit dhe të gjithë qytetarëve të tij. Le të ndërtojmë një ekonomi të drejtë, të barabartë dhe të begatë. Një ekonomi që e bën Prizrenin një komunë ku të gjithë mund të lulëzojnë.

Faleminderit!

I juaji
Shaqir Totaj

Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) është një dokument strategjik i përgatitur nga komuna e Prizrenit, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë, për krijimin e kushteve më të mira për zhvillim ekonomik, mirëqenie dhe gjenerim të punësimit në komunë. Qëllimi kryesor i SZHEL-së është të ndërtojë kapacitete ekonomike lokale të komunës së Prizrenit, duke përmirësuar kështu të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët.

SZHEL është përqendruar në rritjen e konkurrueshmërisë komunale, rritjen e qëndrueshme dhe sigurimin që rritja të jetë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, SZHEL përfshin edhe ndërtimin e forcës ekonomike të komunës së Prizrenit duke optimizuar burimet dhe kapacitetet lokal të palëve të interesuara ekonomike në qytet dhe fshatra, duke rritur rëndësinë e identifikimit dhe hapjes së mundësive për të bërë biznes, mbështetjes së iniciativave të ndërmarrjeve, duke lehtësuar hyrjen në treg dhe krijimin e një klime të favorshme për investime dhe aktivitete biznesi. SZHEL do të kontribuojë si në dimensionin ekonomik, ashtu edhe në atë arsimor, social, infrastrukturor, turistik/kulturor dhe mjedisor.




Fig 1. Prizreni multi-etnik

Sipas Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 (PNZHEL) ku flitet për zhvillimin e politikave efektive për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale, thuhet se komunat duhet të jenë konkurrenente ndërmjet vete për të rritur mundësitë e tyre për të tërhequr sa më shumë fonde nga donatorët. Kështu, SZHEL do të ndihmojë në planifikimin më të mirë të investimeve kapitale, si dhe adresimin e çështjeve të zhvillimit ekonomik lokal përmes hartimit të politikave strategjike gjithëpërfshirëse për zhvillimin

ekonomik lokal, si dhe institucionalizimin dhe sistemimin e politikave zhvillimore lokale. Për të pasur këtë qasje sistemore, është hartuar kjo strategji për zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë kuadër, aftësimi i të rinjve dhe fuqizimi i grave është një komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik lokal. Rritja e kapaciteteve profesionale të tyre, sidomos sa i përket çështjes së ndërmarrësisë dhe aftësimin e tyre se si t'i qasen themelimit dhe funksionimit të biznesit, duke marrë në konsideratë resurset natyrore të zonave të caktuara rurale dhe urbane në komuna, zhvillimin e turizmit urban dhe rural, veprimtaritë që kanë të bëjnë me prodhimin në agrikulturë dhe plasimin e këtyre produkteve në treg janë disa nga parametrat që do të ndikojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik lokal. Përmes programeve tematike, SZHEL në bashkëpunim me komunitetin lokal do të krijojë mundësi trajnimi në fushën e zhvillimit socio-ekonomik. Përmes skemave stimuluese për të rinjë dhe gra, si dhe grupe të tjera të marginalizuara do t'u jepet mundësia që të kenë qasje më të lehtë në tregje, për të shitur mallrat dhe shërbimet e tyre. Gjithashtu hartimi i skemave programore për punësimin e të rinjve dhe grave në sektorë me prioritet mundëson uljen e papunësisë dhe rritjen e zhvillimit ekonomik lokal. Mbështetja e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (NMV) nga sektori i bujqësisë, turizmit dhe energjisë së ripërtëritshme janë ndër prioritetet kryesore për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Prizrenit. Skemat e granteve për mbështetje të bizneseve dhe krijimi i mekanizmave tjerë për të stimuluar bizneset do të ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Përshkrimi i shkurtër i qëllimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal

Qëllimi i SZHEL të komunës së Prizrenit është që të krijohet një mjedis më i favorshëm për zhvillimin ekonomik lokal, si dhe ngritja e nivelit të mirëqenies së komuniteteve të komunës së Prizrenit. SZHEL do të ndihmojë në përfshirjen e komuniteteve në projektet komunale, pastaj në diversifikimin e ekonomisë lokale, zhvillimin e infrastrukturës, aftësimin e fuqisë punëtore, mbështetjen e bizneseve lokale, promovimin e turizmit, përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit, zhvillimin e partneriteteve dhe krijimin e kushteve për mbështetje sociale dhe ambientale.

Hyrja

Komuna e Prizrenit është komuna e dytë për nga madhësia në Kosovë, si dhe qendër rajonale në jug të vendit. E vendosur nën bjeshkët e maleve të Sharrit, qyteti i Prizrenit është një nga vendbanimet më të vjetra të banuara në Evropën juglindore. Prizreni ka qenë gjithmonë udhëkryq i kulturës dhe tregtisë gjatë historisë. Për shkak të ndryshimeve të mëdha politike, shoqërore dhe ekonomike gjatë periudhave të ndryshme kohore, Prizreni ka pësuar luhatje zhvillimore kulturore, sociale dhe ekonomike. Mirëpo, lufta e



fundit ka ndikuar në stagnimin e shumë proceseve për të ardhmen e komunës. Sot Prizreni ballafaqohet me sfida të ndryshme gjatë zhvillimit të vet ekonomik, siç janë niveli i lartë i papunësisë, prezenca

Fig 2 - Zhvillimi social dhe ekonomik

e ekonomisë joformale, mungesa e prodhimit të organizuar industrial dhe bujqësor, si dhe mungesa e kuadrove profesionale të kërkuara nga komuniteti i biznesit. Prizreni, poashtu pëson nga degradimi i madh ambiental, si dhe migrimi i vazhdueshëm. Komuna e Prizrenit është e përkushtuar që ta zbatojë Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), duke iu referuar Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020 (PHK) dhe bazuar në Ligjet e Kosovës, Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.2003/14 (LPH) dhe Hartat Zonale 2020-2028 (HZ), gjë që reflekton dëshirën e saj që të përgatitet për të ardhmen duke u bazuar në parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, teknologji dhe infrastrukturë moderne dhe përfshirje sociale dhe barazi. SZHEL të komunës së Prizrenit është mjet i rëndësishëm për bashkërendimin e këtyre parimeve dhe për orientimin e zhvillimit të ardhshëm të komunës së Prizrenit për pesë vitet e ardhshme, duke iu referuar ligjeve përkatëse të Kosovës.

Pse hartohet strategjia?

SZHEL është shumë e rëndësishme për disa arsye, me ç'rast udhëzon dhe optimizon përpjekjet për promovimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike në nivel lokal. Këto janë disa nga arsyet se pse duhet hartuar SZHEL-në:

1. Krijimi i vendeve të punës - me ç'rast rritet punësimi dhe mirëqenia e komuniteteve të komunës dhe zvogëlohet shkalla e papunësisë.
2. Diversifikimi i ekonomisë - SZHEL inkurajon diversifikimin e ekonomise, duke u mbështetur në bizneset që janë të suksesshme, sektorin ku veprojnë dhe produktin që e nxjerrin.
3. Gjenerimi i mirëqenies - Zhvillimi ekonomik lokal gjeneron mirëqenie brenda komuniteteve të komunës. Rritja e aktiviteteve ekonomike shpie deri te të hyrat më të larta për individët dhe bizneset, duke kontribuar kështu në rritjen e standardit të jetesës së banorëve.
4. Zhvillimi i infrastrukturës - SZHEL përfshin edhe zhvillimin e infrastrukturës. Infrastruktura më e mirë (transporti, komunikimi, rrugët, etj) tërheq bizneset dhe e bën ambientin më konkurrues.
5. Përmirësimi i kualitetit të jetës - duke përfshirë qasjen më të mirë në arsim, kujdesin shëndetësor, vlerat kulturore dhe mundësitë e argëtimit.
6. Ndërmarrësia dhe inovacioni - SZHEL ndikon në ambientin e të bërit biznes dhe inovacion. Përkrahja e bizneseve të vogla dhe startup-ëve mundëson zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe industrive të reja.
7. Përfshirja e komunitetit - Hartimi i SZHEL-së përfshin edhe kyqjen e komuniteteve në proceset vendimmarrëse. Kjo ndihmon në sigurimin që plani zhvillimor është në përputhje me aspiratat e popullatës lokale.
8. Tërheqja e investimeve - Një SZHEL e definuar qartë dhe mirë e bën komunën e Prizrenit më tërheqës për investitorët e huaj dhe të brendshëm.
9. Zvogëlimi i varfërisë dhe pabarazive - SZHEL shpesh përfshin iniciativa për adresimin e varfërisë dhe pabarazisë. Kjo nënkupton ofrimin e trajnimeve dhe mundësive arsimore për popullatën e marginalizuar dhe krijimin e shtigjeve të reja për vende pune me pagesa më të mira.

Metodologjia

Në mënyrë që SZHEL Prizren 2024-2029 të jetë sintetizim i politikave ekonomike zhvillimore të nivelit lokal, përmes instrumenteve të ndryshme për mbledhje të të dhënave, është nxjerrë perspektiva e përgjithshme e nivelit lokal. Gjatë përcaktimit të kornizës metodologjike për hartimin e kësaj strategjie janë marrë parasysh “Udhëzimi Administrativ për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit” si dhe “Manuali për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit”.

| | |
|---|--|
| Puna përgatitore | Komuna e Prizrenit, me vendim të kryetarit ka themeluar Grupin Punues, si ekipin përgjegjës për të drejtuar procesin e hartimit të SZHEL. Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) ka hartuar draftin e parë të dokumentit. |
| Punëtorja e parë e GP | Gjatë punëtorisë së parë anëtarët e GP kanë shfrytëzuar rastin të njoftohen me njëri-tjetrin, të diskutojnë mbi draftin e parë të dokumentit dhe të hartojnë analizën Strengths, Ëeaknesses, Opportunities and Threats (SËOT). |
| Rishikimi i strategjive dhe dokumenteve tjera relevante | Në këtë fazë, GP ka rishikuar dokumentet tjera strategjike sektoriale, të miratuara apo në proces të miratimit. Rishikimi dhe konsultimi i dokumenteve strategjike të nivelit qendror ka qenë i rëndësishëm për të kuptuar më shumë rreth orientimeve strategjike të nivelit qendror që lidhen me zhvillimin ekonomik lokal. |
| Punëtorja e dytë e GP | Gjatë punëtorisë së dytë GP i ka identifikuar sfidat preliminare të zhvillimit ekonomik lokal dhe pastaj i ka |

| | |
|---|---|
| | <p>sistemuar ato në sfida madhore. Përpos kësaj, janë zhvilluar diskutime për mjetet për mbledhjen e të dhënave shtesë. Është dakorduar që të punohet në planit e veprimit dhe pastaj ti dergohet grupit për diskutim/plotesim/ndryshim.</p> |
| <p>Takimet me komuna dhe me asociacione të biznesit</p> | <p>Në këtë punëtori GP ka prezantuar të dhënat e anketës dhe e ka shfrytëzuar mundësinë që përmes diskutimeve me palët e ftuara t'i verifikojë dhe shtjellojë më tutje ato. Njëkohësisht, është përgatitur një draft më i avancuar i sfidave dhe problemeve kryesore, duke i kombinuar të gjitha burimet e të dhënave. Në fund, pjesëmarrësit janë ftuar që të diskutojnë rreth objektivave preliminare.</p> |
| <p>Punëtorja e tretë e GP</p> | <p>Në këtë punëtori, GP e ka përcaktuar misionin dhe vizionin, objektivat specifike, indikatorët dhe aktivitetet kryesore në kuadër të SZHEL-së. Njëkohësisht, është përcaktuar edhe korniza për monitorimin dhe vlerësimin e këtij programi dhe është bërë një vlerësim i ndikimit financiar. Me përfundimin e kësaj punëtorie është finalizuar drafti i SZHEL-së dhe është përgatitur për konsultime publike.</p> |
| <p>Konsultimet Publike</p> | <p>Në fund të këtij procesi është organizuar diskutimi paraprak dhe publik me qëllim të marrjes së komenteve dhe inputeve nga hisedarët. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik është punuar në versionin final të dokumentit, i cili në fund</p> |

| | |
|--|--|
| | është proceduar në asamblenë komunale për aprovim. |
|--|--|

Misioni

Misioni i komunës së Prizrenit për zhvillimin ekonomik lokal është krijimi i një ekonomie vendore të gjallë, të përshtatshme dhe të vetëqëndrueshme, që përmirëson mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të komunës së Prizrenit dhe i inkurajon gratë dhe të rinjtë të mirren me ndërmarrësi.

Vizioni

Vizioni i komunës së Prizrenit nga aspekti i zhvillimit ekonomik lokal është një komunë me një ekonomi të qëndrueshme, të larmishme dhe konkurruese, e cila mundëson krijimin e kushteve për punë, mirëqenie dhe zhvillim dinjitoz për të gjithë, tërheqjen e investimeve dhe parandalimin e tendencave për migrim.

Sfondi

Sot, komuna e Prizrenit ka zvogëluar ndjeshëm ngarkesat administrative që ndërliken me themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve. Përkundër këtij progresi, ndërmarrjet ende ballafaqohen me sfida të shumta që ua pamundësojnë realizimin e potencialit të tyre konkurrues. Investimet në nivelin komunal janë të orientuara kryesisht në projekte të natyrës infrastrukture, sidomos në rrugë. Prona komunale dhe mundësia që ajo të ofrohet për shfrytëzim përbën një mjet të rëndësishëm për komunën për t'i stimuluar investimet. Sektori privat, duke qenë i dominuar nga mikro-ndërmarrjet në pronësi familjare (BI) ka qenë pak i gatshëm të realizojë investime me efekte të konsiderueshme për zhvillimin ekonomik lokal. Zonat ekonomike apo parku industrial ende i pa përfunduar, pamundëson tërheqjen e investimeve. Komuna e Prizrenit ka një sërë materialesh promovuese që ofrojnë informata mbi potencialet dhe mundësitë për të investuar. Kështu, investitorët potencial shpeshherë kanë qasje në informatat e nevojshme për të ndërmarrë hapa drejt investimit. Bujqësia është qenësore për zhvillim rural dhe luan një rol mjaft të rëndësishëm në ekonominë lokale. Ndonëse komuna e Prizrenit përmes projekteve për subvencione ofron mbështetje për zhvillim të bujqësisë, kjo mbështetje mbetet e pamjaftueshme për t'i adresuar disa nga problemet parësore të

këtij sektori, siç janë: fermat e vogla, teknologjia dhe mjetet e vjetruara të punës, kostot e larta të inputeve bujqësore, si dhe integrimi i kufizuar në industri të ushqimit. Turizmi, si sektor tjetër me rëndësi, veçanërisht turizmi rural apo agroturizmi, përkundrazi potencialit që ka, nuk është zhvilluar aq sa duhet. Atraksionet turistike, përkatesisht monumentet e trashëgimisë kulturore, vihen pak në funksion të promovimit të ekonomisë kreative. Zejtaret lokalë, si akterë të rëndësishëm të komunave, ballafaqohen me vështirësi të theksuara në aspekt të qëndrueshmërisë financiare. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) në përgjithësi kanë nevojë për përkrahje për të ndjekur trendin e vendeve tjera. Ato kanë ngecur sidomos në aspekt të digjitalizimit dhe inovacionit, si në nivel të produkteve, ashtu edhe të proceseve. Komuna e Prizrenit njihet për modele të qëndrueshme të financimit dhe nuk ka vështirësi të shërbejë si inkubator tipik i inovacionit. Tek sektori privat dhe palët që merren me zhvillim ekonomik lokal ekziston një nivel i ulët i vetëdijes mbi ekonominë qarkore dhe përparësitë që sjellë kjo qasje në aspekt ekonomik dhe në kontekst të ruajtjes së burimeve natyrore dhe përgjithësisht mjedisit. Ndonëse riciklimi konsiderohet element integral i ekonomisë qarkore, në komunën e Prizrenit nuk ka infrastrukturë të etabluar mirë për riciklim. Ndarja e mbeturinave, në masë të madhe bëhet në mënyrë jo formale dhe materiali riciklues kryesisht eksportohet pa u përpunuar. Vlerësohet se një përqindje e vogël e ndërmarrjeve shfrytëzojnë material të ricikluar. Aspektet e ekonomisë qarkore, si ripërdorimi i materialit dhe mundësitë për riparim kanë zënë shumë pak vend në praktikën biznesore. Në tregun e punës ekziston një mungesë e theksuar e shkathtësive për t'i përmbushur nevojat e sektorit privat. Përderisa në të kaluarën, ndër sfidat kryesore të bizneseve ka qenë gjetja e fuqisë punëtore të kualifikuar, në vitet e fundit, veç kësaj, bizneset po hasin gjithnjë e më shumë vështirësi në gjetjen e profileve me shkathtësi të ulëta. Shkak kryesor për këtë janë tendencat migruese të kësaj kategorie, qoftë jashtë Kosovës apo nga komunat e vogla drejt komunave të mëdha, kryesisht drejt kryeqytetit. Komuna e Prizrenit duhet të ketë të dhëna sistematike për t'i identifikuar profilet që nevojiten në tregun e punës. Disa nga profilet të cilat mungojnë më së shumti janë salduesit, inxhinierët softuerik me përvojë, operatorët e pajisjeve dhe axhustatorët. Bashkëpunimi në mes të sektorit privat dhe shkollave profesionale apo qendrave të akredituara të trajnimit është në nivel të kufizuar. Mungojnë mekanizmat funksionalë që u krijojnë mundësi bizneseve të ofrojnë ndihmën e tyre në hartimin e standardeve të profesionit për shkollim/ aftësim profesional. Në anën tjetër, bizneset shumë pak shfaqin interesim për të ofruar mundësi për përvojë praktike në vend të punës. Ndonëse një pjesë e madhe e

buxhetit të komunave investohet në infrastrukturë, sidomos në infrastrukturë rrugore (rreth 27%), ekzistojnë pakënaqësi në lidhje me furnizimin me ujë e pijshëm, menaxhimin e mbeturinave, transportin lokal, infrastrukturën rrugore, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të zeza. Kur vjen puna te financat lokale, komunat i mbulojnë shpenzimet e tyre nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Sasia e mjeteve që alokohet tek komunat nga niveli qendror përmes grantit të përgjithshëm dhe granteve tjera përcjellëse, në raport me të hyrat që ka vendi, konsiderohet relativisht e kënaqshme. Megjithatë, mënyra e shpërndarjes përmes granteve, duke e anashkaluar ndërlidhjen e drejtpërdrejtë me të hyrat nga disa lloje të tatimeve (psh. tatimi në të ardhura personale), nuk vlerësohet mënyra më e përshtatshme dhe dallon nga praktikat në vendet e ngjashme në rajon dhe më tej. Për më tepër, ndarja e granteve qeveritare në formë lineare ka bërë që komunat të mos jenë shumë aktive në realizimin e të hyrave vetanake dhe të mos zhvillojnë një lloj konkurrence ndërmjet veti në këtë drejtim. Në anën tjetër, kompetencat që u janë lënë komunave për të krijuar të hyra nga burimet vetanake (tatimi në pronë, taksat, tarifrat dhe ngarkesat tjera komunale) janë të pamjaftueshme për t'i bërë ato të vetëqëndrueshme financiarisht. Si rezultat, këto komuna nuk kanë mjete të mjaftueshme për investime në projekte dhe ushtrim të mirëfilltë të kompetencave vetanake. Në përgjithësi, varësia në masë të madhe nga niveli qendror, përkatësisht mungesa e qëndrueshmërisë financiare, nënvizohet si një prej problemeve të mëdha të komunave për zhvillim ekonomik lokal. Në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal, lartësia e tarifave komunale duhet të jetë në proporcion me shpenzimet e komunës. Si pasojë, ekzistojnë dallime të mëdha në mes të komunave përsa i takon nivelit të tarifave. Problem tjetër i komunave për përdorimin e buxhetit është kufizimi në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe subvencioneve. Në shpenzim të buxhetit, mangësi konsiderohet mbikëqyrja e punëve që realizohen nga kontraktorët. Duke e ditur se zhvillimi ekonomik lokal është prioritet i komunave, ky dokument do të ketë edhe një kornizë e monitoruese uniforme që e do ta mat realizimin e aktiviteteve dhe ndikimin në objektiva. Kapacitetet profesionale për zhvillim ekonomik në institucione komunale janë të pamjaftueshme. Gjithashtu, kapacitetet janë të kufizuara edhe kur vjen puna te hartimi i projekteve për të tërhequr fonde nga donatorët e huaj. Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me AZHR Jug ka siguruar këtë shërbim. Ky është viti i III i punës së ERPK dhe veqse tanimë janë parë rezultatet e para. Bashkëpunimi në mes të komunës dhe komunitetit të biznesit vlerësohet të jetë në nivel jo të kënaqshëm, por me mundësi zhvillimi. Komuna e Prizrenit ka shoqata/organizata biznesi funksionale të cilat përfaqësojnë dhe ndihmojnë sektorin

privat duke i artikuluar nevojat e tyre. Probleme ka edhe në mes të nivelit lokal dhe qendror në lidhje me zhvillimin ekonomik. Paqartësia rreth kompetencave në mes të nivelit lokal dhe atij qendror është renditur si barriera më serioze në anketën e zhvilluar me komuna. Bashkëpunimi ndër-komunal, në anën tjetër, është kryesisht në projekte investuese infrastrukturore.

Analiza e gjendjes aktuale

Demografia e komunës

Përnga popullsia, Prizreni është një komunë e madhe në nivel të Kosovës. Të dhënat e vlerësimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që Komuna e Prizrenit i ka 177,400 banorë.²

Tabela në vijim pasqyron gjendjen sipas përkatësisë etnike³:

| | Shqiptar | Serb | Turk | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptian |
|----------|----------|------|------|----------|------|---------|-----------|
| Gjithsej | 145718 | 237 | 9091 | 16896 | 2899 | 1350 | 168 |
| Meshkuj | 73329 | 105 | 4431 | 8450 | 1416 | 700 | 79 |
| Femra | 72389 | 132 | 4660 | 8446 | 1483 | 650 | 89 |

Tab.1 -Popullsia e komunës së Prizrenit sipas etnicitetit dhe gjinisë

Komunën e Prizrenit, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Prizrenit, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i komunës së Prizrenit përfshin 76 vendbanime, përfshirë Prizrenin dhe fshatrat: Atmagjë, Arbanë, Arbanas i Epërm, Arbanas i Poshtëm, Billushë, Caparc, Dedaj, Dobrushtë, Dojnicë, Drajçiq, Gërncar, Gornjesellë, Gorozhup, Grazhdanik, Hoçë e Qytetit, Jabllanicë, Jeshkovë, Kabash, Kabash i Hasit, Karashëngjergj, Kobajë, Kojushë, Korishë, Krajk, Krushë e Vogël, Kushnin, Kushtendili, Landovicë, Legjendë, Leskovec, Lez, Lubiçevë, Lubinjë e Epërme, Lubinjë e Poshtme, Lubizhdë, Lubizhdë e Hasit, Lukinaj, Llokvicë, Malësi e Re, Manastiricë, Mazrek, Medvec, Milaj, Muradem, Mushnikovë, Nashec, Nebregosht, Novakë, Novosellë, Petrovë, Piranë, Pllanej, Pllanjan, Poslisht, Pouskë, Prevallë, Randobravë, Reçan, Romajë, Skorobisht, Smaq, Sreckë,

¹ ASK Data 2021

² Popullsia e komunës së Prizrenit sipas regjistrimit të vitit 2011

³ ASK Data 2011

Struzhë, Shkozë, Shpenadi, Trepeticë, Tupec, Velezhë, Vërbiçan, Vërmicë, Vlashnje, Zojz, Zym, Zhivinjan dhe Zhur.

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) nga regjistrimi i vitit 2011, komuna e Prizrenit ka dendësi banimi prej 275.56 banorë/km² në një sipërfaqe prej 640 km². Lartësia mesatare mbidetare e komunës është nga 400 m deri në 1,760 m.

Ekonomitë familjare

Sipas të dhënave që bazohen në regjistrimin e fundit zyrtar të vitit 2011, komuna e Prizrenit ka 29,625 ekonomi familjare. Paraqitja tabelare e ekonomive familjare përnga numri i anëtarëve është paraqitur si më poshtë:

| Anëtarë | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10> | Total |
|----------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|---------------|--------------|
| Prizren | 925 | 1893 | 2402 | 4909 | 5724 | 4613 | 2998 | 1676 | 1057 | 3428 | 29625 |

Tab. 2 – Ekonomitë familjare përnga numri i anëtarëve

Popullsia e komunës së Prizrenit sipas vendbanimit dhe etnicitetit, sipas regjistrimit të fundit (2011) është paraqitur si më poshtë:

| | Shqiptarë | Serb | Turq | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptian | Goran | Të tjerë |
|-------------------|-----------|------|------|----------|-----|---------|-----------|-------|----------|
| Atmaxhë | 1677 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Billushë | 1490 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Caparc | 818 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 25 | 0 | 0 |
| Dedaj | 615 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dobrushtë | 495 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dojnicë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Drajçiq | 28 | 26 | 0 | 95 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dushanovë | 8810 | 0 | 0 | 220 | 172 | 186 | 0 | 2 | 2 |
| Gërçar | 12 | 0 | 6 | 1285 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15 |
| Gornjasellë | 12 | 9 | 0 | 268 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Gorozhup | 289 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Grazhdanik | 879 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 3 | 0 | 0 |
| Gjonaj | 4805 | 1 | 0 | 4 | 0 | 1 | 0 | 0 | 2 |
| Hoçë e Qytetit | 3405 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Jabllanicë | 0 | 0 | 1 | 346 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 |
| Jeshkovë | 434 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kabash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kabash i Hasit | 881 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Karashëngjergj | 1095 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kobajë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kojushë | 506 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Korishë | 5278 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Krajk | 1676 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Krushë e Vogël | 919 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15 | 0 | 0 | 0 |
| Kushnin | 2109 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kushtendil | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Landovicë | 1027 | 0 | 0 | 1 | 0 | 110 | 0 | 0 | 0 |
| Leskovec | 133 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lez | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lubinjë e Epërme | 0 | 0 | 0 | 1873 | 0 | 0 | 0 | 1 | 44 |
| Lubinjë e Poshtme | 5 | 0 | 0 | 1178 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17 |
| Lubiqevë | 1602 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lubizhdë | 4207 | 5 | 237 | 1286 | 48 | 0 | 0 | 75 | 107 |
| Lubizhdë e Hasit | 2719 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lukinaj | 557 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lutogllavë | 1218 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Llokvicë | 1 | 5 | 0 | 330 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | |
|-------------------|--------|-----|------|-------|------|------|-----|-----|-----|
| Malësi e Re | 742 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Manastiricë | 0 | 0 | 0 | 1106 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mazrek | 1076 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Medvec | 1046 | 0 | 0 | 0 | 0 | 16 | 0 | 0 | 0 |
| Milaj | 37 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Muradem | 514 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mushnikovë | 900 | 47 | 0 | 143 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 |
| Nashec | 1379 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nebregoshtë | 1 | 0 | 0 | 577 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Novak | 57 | 31 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Novosellë | 17 | 0 | 0 | 243 | 0 | 0 | 0 | 0 | 46 |
| Petrovë | 1194 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Piranë | 2213 | 0 | 0 | 0 | 0 | 200 | 1 | 0 | 0 |
| Pllanajë | 680 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pllanjan | 11 | 4 | 7 | 1080 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Poslishtë | 1517 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pouskë | 0 | 0 | 0 | 684 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prizren | 67020 | 47 | 8833 | 4914 | 2666 | 742 | 58 | 576 | 133 |
| Randobravë | 1142 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Reçan | 2 | 0 | 2 | 944 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Romajë | 2745 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Sërbicë e Epërme | 179 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sërbicë e Poshtme | 600 | 0 | 0 | 2 | 11 | 39 | 20 | 0 | 0 |
| Skorobishtë | 766 | 0 | 0 | 303 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Smaç | 374 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sredskë | 9 | 58 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Struzhë | 102 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shkozë | 763 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Shpenadi | 1089 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18 | 60 | 0 | 0 |
| Trepetnicë | 133 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 | 0 |
| Tupec | 398 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Velezhë | 460 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vërbiçan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vërmicë | 658 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vlashnjë | 1698 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zojz | 813 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15 | 0 | 0 | 0 |
| Zym | 1782 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zhivinjan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zhur | 5897 | 0 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| Gjithsej | 145718 | 237 | 9091 | 16896 | 2899 | 1350 | 168 | 655 | 386 |

Tab. 3 - Popullsia e komunës së Prizrenit sipas vendbanimit dhe etnicitetit

Paraqitja tabelare e banorëve sipas vendbanimit dhe grupmoshave duket si ne vijim:

| Vendbanimi | 0-4 | 5-9 | 10-14 | 15-19 | 20-24 | 25-29 |
|-------------------|-----|-----|-------|-------|-------|-------|
| Atmaxhë | 187 | 167 | 176 | 157 | 162 | 159 |
| Billushë | 133 | 140 | 164 | 153 | 152 | 130 |
| Caparc | 65 | 82 | 89 | 113 | 74 | 81 |
| Dedaj | 66 | 74 | 74 | 71 | 46 | 55 |
| Dobrushtë | 61 | 44 | 38 | 40 | 60 | 70 |
| Dojnicë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Drajçiq | 19 | 18 | 3 | 7 | 10 | 14 |
| Dushanovë | 849 | 966 | 1017 | 946 | 948 | 774 |
| Gërçar | 125 | 138 | 93 | 89 | 123 | 135 |
| Gornjasellë | 23 | 12 | 6 | 29 | 30 | 25 |
| Gorozhup | 42 | 45 | 22 | 24 | 31 | 25 |
| Grazhdanik | 82 | 112 | 114 | 99 | 65 | 64 |
| Gjonaj | 545 | 533 | 553 | 475 | 509 | 437 |
| Hoçë e Qytetit | 268 | 309 | 420 | 457 | 349 | 232 |
| Jabllanicë | 6 | 26 | 36 | 39 | 40 | 16 |
| Jeshkovë | 21 | 36 | 47 | 50 | 51 | 35 |
| Kabash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kabash i Hasit | 113 | 116 | 103 | 89 | 98 | 78 |
| Karashëngjergj | 105 | 102 | 111 | 121 | 98 | 95 |
| Kobajë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kojushë | 82 | 65 | 46 | 46 | 49 | 53 |
| Korishë | 482 | 477 | 553 | 518 | 563 | 489 |
| Krajk | 198 | 202 | 187 | 175 | 173 | 155 |
| Krushë e Vogël | 76 | 82 | 128 | 117 | 85 | 79 |
| Kushnin | 289 | 244 | 251 | 209 | 213 | 179 |
| Kushtendil | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Landovicë | 107 | 110 | 147 | 113 | 115 | 88 |
| Leskovec | 11 | 11 | 10 | 21 | 20 | 10 |
| Lez | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lubinjë e Epërme | 134 | 151 | 160 | 231 | 155 | 145 |
| Lubinjë e Poshtme | 73 | 101 | 99 | 107 | 108 | 79 |
| Lubiqevë | 213 | 233 | 177 | 146 | 156 | 141 |
| Lubizhdë | 478 | 523 | 551 | 536 | 536 | 528 |
| Lubizhdë e Hasit | 317 | 261 | 323 | 291 | 304 | 255 |
| Lukinaj | 58 | 57 | 63 | 76 | 53 | 54 |
| Lutogllavë | 97 | 120 | 109 | 140 | 126 | 99 |
| Llovakicë | 7 | 19 | 37 | 30 | 26 | 29 |
| Malësi e Re | 69 | 81 | 67 | 71 | 79 | 79 |

| | | | | | | |
|-------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Manastiricë | 77 | 85 | 123 | 135 | 81 | 74 |
| Mazrek | 123 | 122 | 152 | 123 | 89 | 91 |
| Medvec | 83 | 100 | 146 | 123 | 94 | 74 |
| Milaj | 8 | 2 | 5 | 3 | 4 | 3 |
| Muradem | 55 | 51 | 64 | 63 | 64 | 40 |
| Mushnikovë | 82 | 101 | 122 | 116 | 85 | 81 |
| Nashec | 149 | 133 | 166 | 166 | 114 | 124 |
| Nebregoshtë | 24 | 30 | 52 | 83 | 38 | 42 |
| Novak | 6 | 8 | 9 | 7 | 5 | 2 |
| Novosellë | 32 | 27 | 27 | 22 | 23 | 28 |
| Petrovë | 113 | 119 | 126 | 145 | 125 | 88 |
| Piranë | 201 | 245 | 287 | 265 | 222 | 176 |
| Pllanejë | 110 | 84 | 67 | 58 | 65 | 63 |
| Pllanjan | 108 | 104 | 111 | 89 | 84 | 99 |
| Poslishtë | 161 | 146 | 179 | 157 | 153 | 133 |
| Pouskë | 59 | 61 | 53 | 69 | 59 | 68 |
| Prizren | 6537 | 7091 | 8011 | 8211 | 7478 | 6511 |
| Randobravë | 99 | 116 | 146 | 121 | 108 | 76 |
| Reçan | 63 | 77 | 94 | 85 | 75 | 55 |
| Romajë | 327 | 276 | 307 | 314 | 307 | 267 |
| Sërbicë e Epërme | 11 | 11 | 25 | 24 | 24 | 8 |
| Sërbicë e Poshtme | 43 | 49 | 66 | 91 | 78 | 53 |
| Skorobishtë | 89 | 79 | 102 | 129 | 87 | 92 |
| Smaç | 37 | 29 | 31 | 43 | 31 | 47 |
| Sredskë | 2 | 2 | 0 | 1 | 2 | 0 |
| Struzhë | 4 | 7 | 10 | 18 | 10 | 3 |
| Shkozë | 67 | 70 | 80 | 95 | 86 | 83 |
| Shpenadi | 87 | 88 | 127 | 130 | 125 | 106 |
| Trepetnicë | 14 | 13 | 12 | 14 | 13 | 8 |
| Tupec | 48 | 31 | 32 | 33 | 51 | 53 |
| Velezhë | 23 | 24 | 46 | 50 | 32 | 33 |
| Vërbiçan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vërmicë | 67 | 56 | 78 | 74 | 83 | 61 |
| Vlashnjë | 191 | 200 | 206 | 177 | 174 | 119 |
| Zojz | 75 | 73 | 76 | 113 | 97 | 63 |
| Zym | 126 | 118 | 151 | 180 | 174 | 171 |
| Zhivinjan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zhur | 550 | 580 | 619 | 633 | 606 | 481 |
| Gjithesej | 15252 | 16065 | 17882 | 17946 | 16553 | 14363 |

Tab.4 – Tabela e banorëve sipas vendbanimit dhe grupmohave

Shtrirja gjeografike

Komuna e Prizrenit gjendet në Jug të Kosovës. Tërësia territoriale e komunës së Prizrenit ka një sipërfaqe prej 640 km² dhe paraqet 5,94 % të territorit të Kosovës, me gjithsej 74 vendbanime. Qyteti i Prizrenit shtrihet në një lartësi mbidetare prej 412-500 m. Është i rrethuar nga masivi i Sharrit, maja më e lartë e të cilit është 2,748 m mbi nivelin e detit. Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar ku lartësia mbidetare sillet prej 300 m - 2600 m. Përderisa qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m. Koordinatat e Prizrenit janë 42° 00' dhe 42° 20' veri dhe 20° 30' dhe 21° 00' Lindje. Prizreni është qendër e madhe kulturore dhe tregtare, me pamje shumë pitoreske, me kisha, xhamia, shumë shtëpi të vjetra të banuara dhe të hapura për turistët. Lashtësia urbane e Prizrenit bie në shekullin III dhe shumë më herët. Njëkohësisht Prizreni është i njohur për diversitetin etnik dhe gëzon traditë të lashtë të tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik, andaj edhe konsiderohet si qyteti më heterogjen i Kosovës në aspektin etnik. Trashëgimia Kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar gjatë shekujve deri në ditët e sotme. Duke zotëruar një pozitë të mirë gjeografike dhe gjeopolitike, Prizreni gjithmonë është gjendur në udhëkryq të kulturave të mëdha, si dhe të kulturave etnike, të cilat kanë jetuar njëra pranë tjetrës, si: dardano-iliro-shqiptare, romake, bizantine, serbe, turko-osmane, etj. Në qytetin e Prizrenit gjatë shekujve fliteshin disa gjuhë zyrtare.⁴

Pozita gjeografike e Prizrenit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrinë e ushqimit dhe turizmin. Territori i Prizrenit mbulohet me një pjesë të maleve në vijim: Sharr, Oshlak, Koritinik, Pashtrik dhe pjesërisht përbëhet nga fusha të rrafshëta të luginës së Dukagjinit. Pjesët malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Maja më e lartë në Komunën e Prizrenit ndodhet në Malet e Sharrit në anën lindore dhe juglindore me një lartësi mbidetare prej 2600 m. Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë në juglindje, me Komunën e Dragashit në Jug, me Komunën Shtërpçës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës, baza e lumit Lumëbardhi, shtrihet përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Malet e Pashtrikut në kufirin shqiptar në perëndim janë malet e dyta me lartësi mbidetare me 1,950 m. Prizreni është një nga lokacionet fatlume sa i përket resurseve

⁴ Strategjia për Zhvillimin e Turizmit të Prizrenit

ujore. Lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm në Prizren është Drini i Bardhe (111 km). Ai hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në mes të fshatit Dobrusht dhe fshatit Vërmicë. Në terma hidrografie, tërë territori i Komunës së Prizrenit është pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë dhe pellgut ujqor të lumit Vardar, përkatësisht Detit Adriatik dhe Detit Egje. Lumi Lumëbardhi i gjatë 35 km, rrjedh përgjatë luginës së Zhupës dhe vazhdon nëpër qendrën e Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm është Lumi Toplluha, i gjatë 37 km, i cili hyn në komunën e Prizrenit nga ana veriore prej Mamushës dhe derdhet ne Drinin e Bardhë në fshatin Krajk. Sipas Profilit Komunal të Prizrenit ky lum ka rrezikshmëri më të madhe të vërshimit. Prizreni është i pasur me rezervat e ujërave nëntokësore si dhe ujërave sipërfaqësore që formojnë një potencial të rëndësishëm hidroenergjetik.

Administrata

Komuna e Prizrenit ka në përbërje gjithsej 13 drejtori:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Drejtorja për Administratë,
3. Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër,
4. Drejtorja për Ekonomi dhe Financa,
5. Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
6. Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor,
7. Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
8. Drejtorja për Shërbime Publike,
9. Drejtorja e Arsimit,
10. Drejtorja e Shëndetësisë,
11. Drejtorja për Emergjencë dhe Siguri,
12. Drejtorja për Punë dhe Mirëqenie Sociale,
13. Drejtorja për Inspektorate

Numri i stafit aktual (shkurt 2024), duke i përfshirë të gjitha kategoritë e zyrtarëve publik është: 3108 të punësuar.

Në kuadër të Administratës Komunale janë 334 të punësuar. Kategoritë funksionale, grada, titulli, mosha, kualifikimi, gjinia e stafit, shërbimet administrative dhe lista e shërbimeve publike të ofruara nga komuna janë dhënë më poshtë.

| Numri i stafit aktual (shkurt 2024) | Femra | Meshkuj |
|--|--------------|----------------|
| 334 | 121 | 213 |

| Kualifikimi | Femra | Meshkuj |
|--------------------|--------------|----------------|
| Shkollë fillore | 4 | 12 |
| Shkollë e mesme | 29 | 77 |
| Universitet | 71 | 101 |
| Master | 17 | 23 |

| Kategoritë funksionale | Femra | Meshkuj |
|-------------------------------|--------------|----------------|
| Pozita Drejtuese | 8 | 20 |
| Profesionale | 101 | 144 |
| Administrativo - teknik | 8 | 35 |
| Postet politike | 4 | 14 |

| Mosha e stafit aktual | Femra | Meshkuj |
|------------------------------|--------------|----------------|
| 20 deri 30 | 6 | 7 |
| 31 deri 40 | 49 | 33 |
| 41 deri 50 | 25 | 61 |
| 51 deri 65 | 41 | 112 |

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit janë 2,328 të punësuar:

| Numri i stafit aktual | Femra | Meshkuj |
|------------------------------|--------------|----------------|
| 2,328 | 1,379 | 949 |

| Kualifikimi | Femra | Meshkuj |
|--------------------|--------------|----------------|
| Shkollë fillore | 34 | 99 |
| Shkollë e mesme | 26 | 128 |
| Universitet | 1,145 | 531 |
| Master | 174 | 191 |

| Kategoritë funksionale | Femra | Meshkuj |
|-------------------------------|--------------|----------------|
| Pozita drejtuese | 21 | 47 |
| Profesionale | 1,295 | 674 |
| Administrativo - teknik | 63 | 228 |

| Mosha e stafit aktual | Femra | Meshkuj |
|------------------------------|--------------|----------------|
| 20 deri 30 | 166 | 27 |
| 31 deri 40 | 449 | 205 |
| 41 deri 50 | 334 | 247 |
| 51 deri 65 | 430 | 470 |

Në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë janë 446 të punësuar:

| Numri i stafit aktual | Femra | Meshkuj |
|------------------------------|--------------|----------------|
| 446 | 253 | 193 |

| Kualifikimi | Femra | Meshkuj |
|--------------------|--------------|----------------|
| Shkollë fillore | 3 | 29 |
| Shkollë e mesme | 167 | 84 |
| Universitet | 65 | 68 |
| Master | 18 | 12 |

| Kategoritë funksionale | Femra | Meshkuj |
|-------------------------------|--------------|----------------|
| Pozita drejtuese | 25 | 22 |
| Profesionale | 210 | 125 |
| Administrativo - teknik | 18 | 46 |

| Mosha e stafit aktual | Femra | Meshkuj |
|------------------------------|--------------|----------------|
| 20 deri 30 | 11 | 10 |
| 31 deri 40 | 37 | 33 |
| 41 deri 50 | 54 | 33 |
| 51 deri 65 | 151 | 117 |

Shërbimet administrative të ofruara nga komuna:

Nr. Emri i shërbimit

- 1 Ndërrimi i emrit personal
- 2 Ndërrimi i emrit personal për rastet e rikthimit të mbiemrit të vajzërisë / djalërisë pas shkurorëzimit
- 3 Çertifikatë e lindjes
- 4 Çertifikata e bashkësisë familjare
- 5 Çertifikate vendbanimi
- 6 Çertifikate shtetësie
- 7 Ekstrakti i lindjes
- 8 Çertifikatë e vdekjes
- 9 Akti i vdekjes
- 10 Çertifikate e martesës
- 11 Çertifikate e statusit martesor
- 12 Korrigjimi dhe plotësimi në dokumentet e arkivuara
- 13 Korrigjimi i emrit personal
- 14 Kurorëzimet gjatë orarit të punës
- 15 Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Republikës së Kosovës që kanë kaluar moshën 12 vjeçare
- 16 Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve që nuk mund të ofrojnë asnjë dëshmi
- 17 Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve jashtë territorit të Republikës së Kosovës që nuk janë regjistruar në shtetin e lindjes
- 18 Regjistrimet e mëvonshme të të lindurve në institucionet shëndetësore që kanë kaluar afatin ligjor 30/tridhjetë ditë
- 19 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjeve jashtë teritorit të Republikës së Kosovës kur nuk është regjistruar vdekja në shtetin e vdekjes
- 20 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes jashtë institucioneve shëndetësore brenda territorit të Kosovës

- 21 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjeve kur nuk është regjistruar lindja dhe vdekja
- 22 Çertifikate per raportin farefisnor
- 23 Çertifikatë që është i njejt person
- 24 Çertifikate qe personi ka jetuar ne bashkesi familjare deri ne vdekjes e tij
- 25 Çertifikate qe eshte nen mbikqyrjen materiale te anetarit te familjes
- 26 Çertifikate per vendbanim te perkohshem per shtetasit e huaj ne Komunen e Prizrenit
- 27 Çertifikate per varshmeri materiale
- 28 Çertifikate per lejimin e shtesave per femije
- 29 Deklarate per Ushqimin per vitin kalendarik
- 30 Çertifikate qe personi ka banuar ne Komunen e Prizrenit, deri ne 6 muaj me se paku, para marrjes se patente shoferit
- 31 Pëlqim rreth plotësimit të kushteve minimale sanitare të bizneseve individuale dhe shoqërive tregtare
- 32 Kërkesë për asgjësim të mallit
- 33 Regjistrimi i pronësisë në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore
- 34 Regjistrimi i pronësisë apo posedimit në bazë të trashëgimisë
- 35 Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve
- 36 Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme
- 37 Regjistrimi i pronësisë në bazë të dokumentit mbi dhuratën
- 38 Regjistrimi i ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët
- 39 Ndarja e parcelave
- 40 Përcaktimi i kufijve të parcelave
- 41 Bashkimi i parcelave

- 42 Regjistrimi dhe modifikimi i servitutit
- 43 Fshirja e servitutit
- 44 Regjistrimi dhe modifikimi i hipotekës
- 45 Matja e ndërtesave
- 46 Matja e pjesëve të ndërtesave
- 47 Regjistrimi, modifikimi, dhe fshirja e barrave dhe ngarkesave tjera
- 48 Regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes
- 49 Identifikimi i parcelave
- 50 Korrigjimi i të dhënave kadastrale
- 51 Lëshimi i të dhënave kadastrale në formë digjitale
- 52 Ri-rregullimi i kufijve të parcelave
- 53 Regjistrimi i pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme
- 54 Regjistrimi i bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët
- 55 Ndërrimi i kulturave të parcelave
- 56 Historiati për parcelën/njësinë kadastrale
- 57 Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona
- 58 Kopja e planit
- 59 Koordinatat (baza) gjeodezike
- 60 Çertifikata e pronësisë
- 61 Fshirja e hipotekës së regjistruar
- 62 Leje mjedisore komunale
- 63 Pëlqim për gjërmim/dëmtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbërta
- 64 Shfrytëzimi i hapësirës publike me orman dhe pajisje tjera për energjetikë dhe telekomunikim
- 65 Leje për taxi individual

- 66 Vazhdimi i lejes për taxi (pagesë vjetore)
- 67 Leje për operatorë lokal për transport të udhëtarëve (pagesë çdo 5 vjet)
- 68 Leje për hyrje në shatërvan (vetëm për biznese)
- 69 Vërtetim i pagesës së tarifës komunalë për regjistrim të automjeteve
- 70 Pëlqim për shfrytëzim të hapësirës publike (për DUPH)
- 71 Leje ndërtimi për kategorinë I (dhe kushtet e ndërtimit)
- 72 Leje ndërtimi për kategorinë II (dhe kushtet e ndërtimit)
- 73 Leje rrenimi
- 74 Pëlqim në projekt dokumentacion për plotësimin e kushteve ndërtimore të masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore (ndërtime të larta dhe afariste)
- 75 Pëlqim në lokacion (stacion i derivateve, gazit, depo e materieve të rrezikshme)
- 76 Pëlqim mbi përmbushjen e kushteve minimale teknike për ushtrim të veprimtarisë
- 77 Vërtetim për tatim në prone
- 78 Vërtetimi mbi përvojën e punës
- 79 Vërtetim për vize
- 80 Regjistrimi i Ri i Biznesit - Biznes Individual (B.I), Ortakëri e Përgjithshme (O.P), Shoqëri Aksionare (SH.A), Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), Ortakëri e Kufizuar (O.K), Degë e Shoqërisë së Huaj (DSHH) dhe Kooperativë Bujqësore (K.B)
- 81 Shuarja e Biznesit (për B.I., O.P., SH.A., SH.P.K., O.K., DSHH dhe K.B.)
- 82 Ndryshimi i Biznesit (për B.I., O.P., SH.A., SH.P.K., O.K., DSHH dhe K.B.), (ndërrim Emri ,Emri tregtar, adrese, Nr. të punëtorëve, Përfaqësuesi, veprimtaria, njësia, kapitali, drejtori...)
- 83 Vërtetim lidhur me biznesin apo individual
- 84 Lëshimi i informatave, historisë së biznesit apo fotokopjes së dokumenteve të biznesit për faqe - apo me vulë.

- 85 Vërtetim - Njoftim kopje(duplikat) për shuarje të biznesit
- 86 Certifikata e biznesit kopje/ duplikat apo me datë të re
- 87 Ndërrimi i Certifikatave të Biznesit të vjetra në Certifikata me Numri Unik Individual (NUI)
- 88 Vërtetim për mbajtje të armës
- 89 Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës
- 90 Vërtetim për pranimin e shtetësisë së Kosovës
- 91 Vërtetim për bashkim familjar
- 92 Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari
- 93 Vërtetim që personi nuk merr asistencë sociale
- 94 Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve (Caktimi i emrit të fëmijës)

Arsimi

Komuna e Prizrenit ka 59 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe të mesme të larta, ndërsa numri i çerdheve publike është 2. Shkolla fillore të mesme të ulëta janë 52, ndërsa shkolla të mesme të larta janë 5. Shkolla në vendbanimet urbane janë 22, ndërsa shkolla në vendbanimet rurale janë 37. Numri i nxënësve në komunën e Prizrenit për vitin shkollor 2023/24 është 24,351 nxënës, të cilët e vijnë në mësimin në tre nivele. Numri i stafit të angazhuar për vitin shkollor 2023/24 (duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ) është 1,978 mësimdhënës dhe staf administrativ. Përgatitja shkollore e stafit akademik është: 3 doktorë të shkencave, 234 master të shkencave, staf me fakultet janë 1,663, kurse 78 janë staf me shkollë të lartë. Numri i nxënësve të cilët udhëtojnë në shkollë është 249 nxënës udhëtar.



Fig.3 - SHFMU "Mati Logoreci"

Mesatarja e notës së nxënësve nëpër shkollë:

| Komuna | Klasë | Suksese të shkëlqyeshëm | | Suksese shumë të mirë | | Suksese të mirë | | Suksese të mëjftueshëm | | Notës me nota pozitive | | Suksese të pamjftueshme | | Të pa notuar | | Gjithsej |
|---------|----------|-------------------------|-----------|-----------------------|-----------|-------------------|-----------|------------------------|-----------|------------------------|-----------|-------------------------|-----------|-------------------|-----------|----------|
| | | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | Numëri i nxënësve | % | |
| | | a | b=a/o*100 | c | d=c/o*100 | e | f=e/o*100 | g | h=g/o*100 | i=a+c+e+g | j=i/o*100 | k | l=k/o*100 | m | n=m/o*100 | |
| Prizren | Klasa 1 | 1689 | 76.2 | 260 | 11.7 | 354 | 7.4 | 65 | 2.9 | 2178 | 98.2 | 16 | 0.7 | 23 | 1.0 | 2217 |
| | Klasa 2 | 1531 | 67.4 | 385 | 17.0 | 218 | 9.6 | 95 | 4.2 | 2229 | 98.2 | 20 | 0.9 | 21 | 0.9 | 2270 |
| | Klasa 3 | 1457 | 62.6 | 459 | 19.7 | 269 | 11.6 | 117 | 5.0 | 2302 | 98.9 | 18 | 0.8 | 8 | 0.3 | 2328 |
| | Klasa 4 | 1318 | 58.5 | 484 | 21.5 | 324 | 14.4 | 87 | 3.9 | 2213 | 98.2 | 26 | 1.2 | 14 | 0.6 | 2253 |
| | Klasa 5 | 1382 | 58.6 | 479 | 20.3 | 346 | 14.7 | 128 | 5.4 | 2335 | 99.0 | 9 | 0.4 | 15 | 0.6 | 2339 |
| | Klasa 6 | 937 | 41.3 | 573 | 25.3 | 489 | 21.6 | 190 | 8.4 | 2189 | 96.6 | 53 | 2.3 | 25 | 1.1 | 2267 |
| | Klasa 7 | 795 | 34.5 | 506 | 22.0 | 628 | 27.3 | 254 | 11.0 | 2183 | 94.8 | 96 | 4.2 | 24 | 1.0 | 2309 |
| | Klasa 8 | 731 | 32.0 | 536 | 23.5 | 614 | 26.9 | 308 | 13.5 | 2189 | 95.9 | 71 | 3.1 | 23 | 1.0 | 2289 |
| | Klasa 9 | 758 | 33.9 | 545 | 24.4 | 593 | 26.6 | 271 | 12.1 | 2167 | 97.0 | 54 | 2.4 | 12 | 0.5 | 2239 |
| | Klasa 10 | 461 | 21.4 | 636 | 29.5 | 523 | 24.3 | 197 | 9.1 | 1817 | 84.4 | 292 | 13.6 | 45 | 2.1 | 2154 |
| | Klasa 11 | 462 | 22.9 | 519 | 25.7 | 382 | 28.8 | 202 | 10.0 | 1765 | 87.4 | 235 | 11.6 | 20 | 1.0 | 2020 |
| | Klasa 12 | 445 | 28.6 | 425 | 27.3 | 449 | 28.9 | 137 | 8.8 | 1456 | 93.7 | 92 | 5.9 | 6 | 0.4 | 1554 |
| | Gjithsej | 11966 | 45.6 | 5807 | 22.1 | 5199 | 19.8 | 2051 | 7.8 | 25023 | 95.4 | 982 | 3.7 | 236 | 0.9 | 26241 |

Tab.5 – Notat dhe mesatarja e nxënësve në shkollat e komunës së Prizrenit

Në komunën e Prizrenit arsimit parafillor ofrohet në të gjitha institucionet arsimore (urbane dhe rurale). Numri i nxënësve në arsimin parafillor është 1,741.

Mësimi për nxënësit në arsimin fillor të mesëm të ulët ofrohet për 18,662 nxënës, kurse arsimit në shkollat e mesme të larta ofrohet në 5 shkolla urbane dhe 5 paralele shkollore në fshatra. Numri i përgjithshëm i këtyre nxënësve është 4,029.

Mesatarja e raportit mësimdhënës - nxënës për vitin shkollor 2023/24 është 12,31 nxënës për 1 mësimdhënës ose 0,081 mësimdhënës për 1 nxënës.

Sa i përket infrastrukturës së shkollave, të gjitha shkollat kanë rrjet funksional të ujësjellësit, dy çerdhet kanë nxemje me pelet, një objekt shkollor ka nxemje me naftë, tre objekte shkollore nxehen me rrymë, 25 shkolla përdorin dru dhe 48 objekte tjera shkollore kanë nxemje me pelet. Të gjitha shkollat kanë qasje në rrjetin e kanalizimit të vendeve ku janë të vendosura. Gjendja e objekteve në përgjithësi është e mirë dhe optimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor, mirëpo në vazhdimësi intervenohet në renovimin e tyre. Edhe situata me inventarin e shkollave është në rregull dhe çdo vit bëhet furnizimi me inventar të ri shkollor për shkollat më me nevojë, si nga ana e DKA-së, poashtu edhe nga donacione, ose projekte të ndryshme nga donatorë të ndryshëm. Numri i klasave në të gjitha shkollat është rreth 1,500 klasa mësimi. Disa shkolla posedojnë kabinetete

shkencore apo hulumtuese. Në komunën e Prizrenit janë gjithsej 22 shkolla që kanë kabinete shkencore.

Infrastruktura

Infrastruktura rrugore

| Nr | Përmbajtja e të dhënave | Njësia | Burimi i informacionit |
|----|---|------------|--|
| 1 | Gjatësia e përafërt e kilometrave rrugë në territorin e komunës së Prizrenit | 1500.00 km | Raportet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) nga sektori i infrastrukturës |
| 2 | Gjatësia e përafërt e kilometrave rrugë të shtruara me strukturë nga asfalti | L= 550 km | Raporti nga DSHP, sektori i infrastrukturës |
| 3 | Gjatësia e përafërt e kilometrave rrugë të shtruara me strukturë nga kubëza | L= 650 km | Raporti nga DSHP, sektori i infrastrukturës |
| 4 | Gjatësia e përafërt e kilometrave rrugë të cilat mirëmbahen rregullisht gjatë verës dhe dimrit (pastrimi i borës, hedhja e kripës etj.) | 300 km | Raporti nga (SMM) , si dhe kontratat: Mirëmbajtja zona I dhe II-2022 (1).pdf Mirëmbajtja zona III-2022.pdf |
| 5 | Kilometra rrugë gjatësi të shtruara në zona urbane dhe vendbanime në fshatra | 1200 | Raportet nga DSHP nga sektori i infrastrukturës |
| 6 | Kilometra rrugë të pajisura me trotuare në zona urbane dhe vendbanime në fshatra | 434.52 | Raportet nga DSHP nga sektori i infrastrukturës |

| | | | |
|----|---|--------|--|
| 7 | Kilometra rrugë të pajisura me ndriçim publik | 650 | Raportet nga DSHP nga sektori i infrastrukturës si dhe raportet nga sektori i energjetikës |
| 8 | Kilometra rrugë gjatësi me sistem të shenjzimit (vertikal dhe horizontal) | 707.84 | Raporti nga sektori i komunikacionit |
| 9 | Kilometra rrugë në zonat urbane të komunës | 800 | Raportet nga DSHP nga sektori i infrastrukturës |
| 10 | Kilometra rrugë në zona urbane me shteg të bicikletave | 3.3 | Raportet nga DSHP nga sektori i infrastrukturës |

Tab.6 – Shënime për infrastrukturën rrugore

Sipërfaqet publike

Sipërfaqja e hapësirave publike në një qytet ka një rëndësi thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së komunitetit lokal. Në komunën e Prizrenit, ku sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike arrin 219 ha dhe territori i komunës shtrihet në një sipërfaqe prej 640 km², ky burim jetik ofron ambientin e nevojshëm për aktivitete të ndryshme dhe përdorim të hapur.

Hapësirat e gjelbra kontribuojnë në shëndetin fizik dhe mendor të banorëve, duke ofruar vend të përshtatshëm për rekreacion, stërvitje fizike dhe momente relaksuese.

| Përmbajtja | Të dhënat (ha) |
|--|-----------------------|
| Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike | 219 ha |
| Sipërfaqja e territorit të komunës | 640 km ² |
| Sipërfaqja e hapësirave publike komunale | 219 ha |

Tab.7 – Sipërfaqet tokësore sipas pronësisë

Parkingjet publike

| Nr | Përmbajtja e të dhënave | Njësia | Burimi i informacionit |
|----|---|--------|--|
| 1. | Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike | 21 | Raport zyrtar nga sektori i komunikacionit me nr. te pr. 05-030-132415, e dt. 12.09.2023 |
| 2. | Numri i vend-parkimeve publike | 941 | - |
| 3. | Numri i veturave që kanë regjistrim të vlefshëm në vitin e raportimit | 32,849 | Raport zyrtar nga qendra per regjistrimin e veturave- njesia ne Prizren e datës 18.09.2023 (derguar me email zyrtar po ashtu te bashkangjitur) |
| 4. | Numri i mjeteve motorike të regjistruara dhe licencuara si taksi | 251 | - |
| 5. | Numri i vend-parkimeve formale të destinuara vetëm për taksi | 210 | - |
| 6. | Numri i parkingjeve me vend-parkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar | 21 | - |

Tab.8 - Parkingjet

Sistemi i kanalizimit dhe ujit të pijshëm

Të dhënat, të përmbledhura nga raportet zyrtare të Komunës së Prizrenit nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Hidroregjioni Jugor" dhe KRU "Radoniqi" Gjakovë, përfshijnë të dhënat e përmbledhura bazuar nga investimet kapitale dhe nga shënimet bazuar në realizimin e punimeve. Këto të dhëna predisponojnë të jenë si të përafërta sepse ndërtimet klasifikohen si ndërtime të reja, ndërtime në rehabilitim dhe ndërtime të kombinuara. Në total nuk kemi ndonjë të dhënë të saktë për shtrirjen në gjatësi por të dhënat paraqesin të dhënat e investimeve gjatë kësaj periudhe.

| Nr | Të dhënat për kanalizimin | Gjatësia (metër) | Burimi i informacionit |
|----|---|------------------|---|
| 1. | Gjatësia e sistemit të kanalizimit duke i përfshirë në grupe si investime kapitale dhe nga shënimet bazuar në realizimin e punimeve. Kjo vlerë në total paraqet shënimet nga periudha e pasluftës. | 931,000 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" dhe KRU Gjakova |
| 2. | Numri i ekonomive familjare në komunë të përfshira në sistemin e ujit | 34,136 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" dhe KRU Gjakova |
| 3. | Numri i ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm | 34,136 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" dhe KRU Gjakova |
| 4. | Numri i ekonomive biznesore (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e ujit të pijshëm | 4,634 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" dhe KRU Gjakova |

Tab.9 – Të dhënat për kanalizimet

| Nr | Përmbajtja e të dhënave Uji i pijshëm | Njësia | Burimi i informacionit |
|----|---|---------------------------|---|
| 1. | Gjatësia e sistemit të ujit të pijshëm duke i përfshirë në grupe si investime kapitale dhe nga shënimet bazuar në realizimin e punimeve. Kjo vlerë në total paraqet shënimet nga periudha e pasluftës. | 375,000 metër/ gjatësi | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" |

| | | | |
|----|---|--------|---|
| 2. | Numri i ekonomive familjare në komunë dhe të përfshira në sistemin e ujit | 34,136 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" |
| 3. | Numri i institucioneve publike të përfshira në sistemin e ujit | 177 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" |
| 4. | Numri i ekonomive biznesore (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e ujit | 4,634 | Komuna e Prizrenit, "KRU Hidroregjioni Jugor" |

Tab.10 – Të dhënat për ujin

Menaxhimi i mbeturinave

Tabela e paraqitur në vijim ofron një përmbledhje të objektivave dhe rezultateve të lidhura me menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prizrenit. Në aspektin demografik numri i banorëve, i ekonomive familjare dhe i bizneseve jep një perspektivë të përgjithshme të gjendjes. Ndërkaq, aspektet buxhetore dhe teknike të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë kapacitetin e deponive dhe përqindjen e mbulueshmërisë, tregojnë përpjekjet për trajtimin dhe uljen e ndikimit të tyre në mjedis. Përbërja e mbeturinave dhe operimi i deponive shënojnë hapat që janë ndërmarrë për të avancuar drejt një menaxhimi më të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për komunitetin dhe mjedisin tonë.

| Përmbajtja | Të dhënat |
|---|-----------|
| Numri i banorëve | 177,781 |
| Numri i ekonomive familjare | 31,739 |
| Numri i bizneseve | 4,403 |
| Numri i institucioneve | 177 |
| Numri i kompanive të kontraktuara | 1 |
| Numri i ditëve të planifikuara për mbledhjen e mbeturinave në vit | 265 |

| | |
|--|---|
| Sasia e mbeturinave në vit | 49,839,860 ton/vit |
| Sasia e mbeturinave në muaj | 136,544.1 ton/muaj |
| Sasia e mbeturinave ditore për person | 0.75 kg |
| Përqindja e mbulueshmërisë | 100% (përfshirja e të gjitha zonave të komunës) |
| Buxheti vjetor për menaxhim të mbeturinave | € 1,892,174.40 |
| Përbërja e mbeturinave | 49% mbeturina me përbërje organike, 51% mbeturina tjera |
| Deponia e mbeturinave të ngurta | Lokacioni: Zhur, te Guri i shpuar |
| Deponia e mbeturinave komunale | Landovicë, deponi regjionale |
| Kapaciteti i deponisë lokale | - |
| Kapaciteti i deponisë regjionale | 2.6 milion m ³ (Deponia është planifikuar të mbushet deri në vitin 2021) |
| Operimi i deponisë lokale | Kompania për Menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK) |
| Sasia ditore e deponuar | 176.9 ton/ditë (112.8 ton/ditë nga Prizreni, 64.1 ton/ditë nga vendet tjera) |

Tab.11 – Të dhëna për mbeturinat

| | |
|---|--|
| Baza Ligjore | |
| - Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave (RKMM) e aprovuar më 2021 | |
| - Plani Pesëvjeçar 2013-2018, shtator 2013 | |
| - Plani Master 2014-2023 Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015 | |

| |
|--------------------------------|
| - Plani Lokal i Mjedisit (PLM) |
| - Programe vetëdijesuese |
| - Programet mjedisore |

Tab.12 – Baza ligjore

Paraqitja tabelare e përberjes së mbeturinave

| Llojet e Mbeturinave | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|-------------------------|--------|--------|--------|--------|
| Mbeturinat e kuzhinës | 41.1% | 41.4% | 41.7% | 42.0% |
| Bari/Dru | 2.8% | 2.8% | 2.8% | 2.8% |
| Mbetje të kompostueshme | 43.8% | 44.2% | 44.5% | 44.8% |
| Letër | 13.7% | 13.9% | 14.2% | 14.4% |
| Plastikë | 12.5% | 12.7% | 12.8% | 13.0% |
| Metal | 1.6% | 1.6% | 1.6% | 1.7% |
| Gjam/Shishe | 5.9% | 6.0% | 6.0% | 6.1% |
| Mbetje të reciklueshme | 33.7% | 34.2% | 34.7% | 35.1% |
| Tekstil | 1.8% | 1.8% | 1.8% | 1.8% |
| Gomë/Lëkurë | 0.3% | 0.4% | 0.4% | 0.4% |
| Qeramikë/Guri | 0.6% | 0.6% | 0.6% | 0.6% |
| Dheu/Hiri | 12.1% | 12.0% | 11.9% | 11.9% |
| Tjera | 7.7% | 7.0% | 6.3% | 5.6% |
| Mbetje nga mbeturinat | 22.5% | 21.7% | 20.9% | 20.1% |
| Gjithsej | 100.0% | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tab.13 – Tabela e llojit të mbeturinave sipas përqindjes dhe viteve




Fig. 4 – Grafiku i përberjes së mbeturinave në përqindje

Mbrotja e mjedisit

Tabela e mëposhtme paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi përpjekjet dhe progresin e komunës në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Me një numër prej 88 kërkesash për Leje Mjedisore Komunale (LMK) gjatë vitit dhe 84 leje mjedisore të lëshuara, tregohet një përqëndrim në zbatimin e standardeve mjedisore. Objektet e pajisura me lejen mjedisore komunale shënojnë një nivel të mirëorganizuar të përshtatshmërisë mjedisore në komunitet. Ndërtesat e reja, që kanë arritur një shkallë zbatimi prej 95.28%, pasqyrojnë një angazhim në përdorimin e teknologjive dhe materialeve mjedisore. Megjithatë, prania e 13 gjobave dhe 7 fletëparaqitjeve në gjykatë për mosposedimin dhe moszbatimin e LMK-së reflekton sfidat dhe nevojën për rritjen e masave ligjore dhe edukuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë mjedisore në komunë. Masat e mësipërme paraqesin një përpjekje koordinuese për të ruajtur dhe mbrojtur mjedisin tonë.

| Përmbajtja | Të Dhënat |
|--|-----------|
| Kërkesat për LMK gjatë vitit (për objektet që u kërkohet leja mjedisore) | 88 |
| Lejet mjedisore të lëshuara gjatë vitit | 84 |
| Numri i objekteve që janë të pajisura me lejen mjedisore komunale | 71 |
| Numri i objekteve të cilat kanë LMK dhe e zbatojnë LMK | 74 |
| Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale | 95.28% |
| Numri i gjobave të shqiptuara për mosposedimin dhe zbatimin e LMK | 13 |
| Numri i fletëparaqitjeve në gjykatë për mosposedimin dhe zbatimin e LMK | 7 |

Tab.14 – Të dhëna për mjedisin

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) si shërbim social i komunës, ofron mbështetje për kategoritë e mëposhtme:

- Fëmijët me nevoja të veçanta,
- Fëmijë në strehim familjar tek të afërmit,
- Fëmijë me strehim rezidencial dhe
- Të rritur me probleme të shëndetit mendor në strehim rezidencial

Nga skema pensionale në kategorinë e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta përfitojnë 262 fëmijë, 25 fëmijë përfitojnë nga skema e mbështetjes financiare për fëmijë që gjenden në strehim familjar (fëmijë të ngelur pa përkujdesje prindërore), 4 fëmijë janë të vendosur në strehim rezidencial, tek “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve” në Prishtinë, kurse 13 persona me probleme të shëndetit mendor gjenden në strehim rezidencial. Stafi i asistencës sociale pranë QPS-së në Prizren gjatë periudhës kohore janar - nëntor të vitit 2023 ka punuar në identifikimin e rasteve sociale, vlerësimin dhe monitorimin e tyre, gjithnjë duke u bazuar në ligjin e asistencës sociale 2003/15 dhe plotësim-ndryshimin e Ligjit 04L-096 për Skemën e Asistencës Sociale (SAS) i zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale gjatë kësaj kohe ishte 655 familje me 2,288 anëtarë. E gjithë puna që kryhet në shërbimin e SAS-it për periudhën janar - nëntor të vitit 2023 është kryer nga 6 zyrtarë komunal. Përpos punëve të përshkruara në sistematizimin e vendeve të punës, në Qendrën Sociale shërbimi i SAS-it organizon dhe pregadit lëndët dhe raportet për komisionin mjekësor, i cili mban seanca një herë në muaj në nivel rajonal. Në komunën tonë ka shumë familje që janë në gjendje të vështirë materiale dhe që kërkojnë ndihmë sociale, por për shkak të mosplotësimit të të gjitha kriterëve nuk kanë mundur ta realizojnë këtë të drejtë.

Më poshtë është paraqit skema tabelare e familjeve dhe anëtarëve të familjeve të cilët gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale si dhe shumën e mjeteve të cilat jepen nga Ministria e Ekonomisë, Punës dhe Transfereve (MEPT).

| Muaji | Numri i familjeve | Numri i anëtarëve | Shuma e mjeteve në total (€) |
|---------|-------------------|-------------------|------------------------------|
| Janar | 699 | 2485 | 82.500,00 |
| Shkurt | 694 | 2470 | 82.500,00 |
| Mars | 683 | 2432 | 80.980.00 |
| Prill | 675 | 2406 | 80.810.00 |
| Maj | 683 | 2427 | 80.970.00 |
| Qershor | 681 | 2412 | 80.540.00 |
| Korrik | 682 | 2409 | 80.130.00 |
| Gusht | 679 | 2397 | 79.910.00 |

| | | | |
|----------|--|--|------------|
| Shtator | 672 | 2369 | 78.940.00 |
| Tetor | 658 | 2305 | 77.000.00 |
| Nëntor | 655 | 2288 | 76.450.00 |
| Dhjetor | 657 | 2293 | 77.290.00 |
| Gjithsej | Varion nga 699 familje në janar deri më 657 në dhjetor | Varion nga 2,485 deri në 2,293 anëtarë | 958.020.00 |

Tab.15 - Skema tabelare e familjeve dhe anëtarëve të familjeve të cilët gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale

Shënimet e sipërpërmendura dëshmojnë se numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale për çdo muaj është në zbritje. Kjo nuk është gjendja reale në teren, ngase ka shumë familje që kërkojnë ndihmë sociale, por janë kriteret që e pengojnë realizimin e kësaj të drejte. Shërbimi i SAS-it gjatë kësaj periudhe përveq punëve profesionale dhe administrative ka kryer edhe vizita në teren, me të cilat janë verifikuar dhe riverifikuar të gjitha familjet të cilat janë shfrytëzues të ndihmës sociale. Në total gjatë vitit 2023 janë verifikuar/riverifikuar 817 familje.

Gjatë këtij viti shërbimi i SAS-it ka përgatit mbi 345 lëndë për komisionin mjekësor, i cili çdo muaj shqyrton rastet sipas raporteve mjekësore të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmës sociale. Sipas evidencës së shërbimit protokollar të SAS-it gjatë vitit 2023 janë lëshuar 157 vërtetime sipas kërkesës së palëve. Gjatë muajit mars dhe prill shërbimi i SAS-it ka qenë i angazhuar edhe në shpërndarjen e ndihmave të ofruara nga shoqata të ndryshme për muajin Ramazan, me të cilin rast ka shpërndarë pako për 697 familje në nevojë. Në muajin tetor 2023 janë përpiluar edhe listat për 900 familje skamnore për pako ushqimore dhe higjienike nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS)/Komuna. Gjithashtu, janë shpërndarë edhe dru për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe familjeve skamnore, për rreth 300 familje. Pas akreditimit të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF) nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK), zyrtarët e SAS-it kanë zhvilluar modulet për trajnime përkatëse.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

- Shfrytëzimi i tokës sipas kulturave në ha

| Ara | Pemishte | Vreshta | Livadhe | Kullosa | Male | Jo pjellore | Gjithsej |
|--------|----------|---------|---------|---------|--------|-------------|----------|
| 12.081 | 448 | 197 | 6.738 | 14.096 | 24.799 | 5.180 | 63.474 |

| Ara | Pemishte | Vreshta | Livadhe | Kullosa | Male | Jo pjellore | Gjithsej | |
|--------|----------|---------|---------|---------|--------|-------------|----------|----|
| 12.081 | 448 | 197 | 6.738 | 14.096 | 24.799 | 5.18 | 63.474 | ha |
| 12081 | 448 | 197 | 6738 | 14096 | 24779 | 5180 | 63519 | ha |
| 120.81 | 4.48 | 1.97 | 67.38 | 140.96 | 247.79 | 51.8 | 635.19 | ha |

Tab.16 – Kulturat bujqësore në ha (km²)

Në pronësi private janë 95% e tokave bujqësore kultivuese. Prodhimi lavërtar i plotëson rreth 45% të nevojave me drithëra, 85% me foragjere. Prodhimtaria e perimeve paraqet disproporcion të theksuar për periudha të ndryshme të vitit. Derisa gjatë verës, fundi i qershorit e deri kah fundi i muajit tetor kemi hiperprodhim, pjesën tjetër të vitit kemi mungesë të perimeve.

- Fondi blegtoral

| Gjedhe | Dele | Dhi | Derra | Kuaj | Shpezë |
|--------|--------|-------|-------|-------|--------|
| 12.880 | 19.820 | 3.750 | 1.120 | 2.450 | 62.000 |

Tab. 17 – Përbërja e fondit blegtoral për frymë blegtoriale

Fermtat

- 179 ferma me lopë qumështore ..me kapacitet..... 5 – 55 krerë
- 110 ferma të deleveme kapacitet30 – 500 krerë
- 23 ferma të dhiveme kapacitet20 – 150 krerë

- 119 bletarëme kapacitet..... 30 - 200 koshere
- 9 ferma pula vojëse..... me kapacitet1,200 - 8.000 copë
- 148 fermerë prodhues grurime kapacitet..... 2 - 100 ha.
- 146 fermerë prodhues misrime kapacitet1 - 30 ha.
- 304 fermerë me vreshtame kapacitet..... 0.10 - 20 ha.
- 107 fermerë me perime.....me kapacitet..... 0.50-37 ha

- Kulturat vjeshtore

| Nr. | Kultura | Sipërfaqja në ha. |
|-----|----------|-------------------|
| | | 1. |
| 3. | Elb | 10 |
| 4. | Thekër | 15 |
| 5. | Tërshërë | 25 |

Tab.18 - Kulturat vjeshtore sipas llojit në ha

- Kulturat pranverore

| Nr. | Kulturat | Sipërfaqja/ha |
|-----|------------------|---------------|
| 1 | Misër për kokërr | 1,850 |
| 2 | Misër me fasule | 410 |
| 3 | Misër i gjelbërt | 950 |
| 4 | Elb | 12 |
| 5 | Tërshërë | 25 |
| 7 | Bimë foragjere | 20 |
| 8 | Bimë industriale | 7 |
| 9 | Perime në serra | 18 |

| | | |
|----|--------------------------|-----|
| 10 | Perime në fushë të hapur | 680 |
| 11 | Patate | 8 |
| 12 | Fasule monokulturë | 4 |

Tab.19 – Kulturat pranverore sipas llojit në ha

Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Komuna e Prizrenit përfshin masivin e Maleve të Sharrit dhe karakterizohet me turizëm kulturor, malor, dimëror-rekreativ, rural, gjueti dhe peshkim, turizëm alpin dhe me ekskursione rekreative. Komunën e bën të veçantë Prizreni si “Qytet Muze”, prania e Parkut Kombëtar “Mali Sharr”, në kuadër të të cilit përfshihen qendrat rekreative Prevala, Guri i Zi, Kabashi, Struzha si dhe Nasheci. Zona e Veçantë e Parkut të Natyrës “Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës” e shpallur me vendim të Qeverisë së Kosovës më 23.05.2019, shtrihet në një sipërfaqe prej afërsisht 6.000 ha, prej të cilave 75% janë pjesë të territorit të komunës së Prizrenit, ndërsa pjesa tjetër i takon territorit të Komunës së Gjakovës. Në kuadër të zonës nuk ka vendbanime, ndërsa sa i përket pronësisë, 98% e territorit është në pronësi publike dhe vetëm 2% është në pronësi private. Zona në fjalë gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, në kufi me Shqipërinë (vija kufitare në gjatësi rreth 18 km) dhe si e tillë është pjesë e një rajoni më të gjerë, të pasur me peizazhe dhe vlera të shumta natyrore që janë bazë e mirë për zhvillimin e turizmit malor ndërkufitar.

Zona me interes të veçantë ekonomik për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit (e shpallur me vendimin nr. 03-V-154 të datës 24 korrik 2009, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.941 ha) ndodhet në pjesën jugore të Kosovës, në jug-perëndim të Komunës së Prizrenit dhe në veri të komunës së Dragashit. Vendbanimet në kuadër të zonës së interesit HC ZHUR, zënë rreth 5% të sipërfaqes së tërësishme të kësaj zone të ndara në Komunën e Prizrenit (vendbanimet Zhur dhe Dobrushë) dhe në Komunën e Dragashit (vendbanimet Rrencë, Shajnë, Dragash, Lubovishtë, Kukjan, Dikancë, Gllaboqicë dhe Krushevë).

Komuna e Prizrenit është e pasur me atraksione të ndryshme natyrore. Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik (DTZHE), bazuar në hulumtimin që ka bërë, ka arritur të gjej më tepër se 44 pika, ose atraksione natyrore. Bukuria natyrore, lartësia mbidetare, shtigjet e përshtatshme për skijim, ajri i pastër shërues për sëmundjet e zemrës dhe të



Fig.5 – Shtigje të ecjes në malet e Sharrit



Fig.6 – Liqenet e maleve të Sharrit

mushkërive janë veçoritë dhe përparësitë e zonës për zhvillimin e turizmit dimëror, sportiv dhe shëndetësor. Liqenet glaciale paraqesin një nga bukuritë më të mëdha të Malit Sharr. Në lartësinë mbidetare mbi 1,900 m janë disa liqene, të cilat posaçërisht dallohen sipas bukurisë dhe madhësisë së

tyre. Këtu vlen të përmenden para se gjithash Liqeni i Livadicës dhe Liqeni i Jazhincës, e pastaj edhe liqenet tjera, si liqenet e Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës dhe Bezdankës. Liqeni më i madh është ai i Livadicës, e pas tij vjen Liqeni i Jazhincës.



Atraksionet natyrore:

- Lumi Drini i Bardhë
- Burimi i Lumëbardhit dhe lumi Lumbardh
- Ujëvarat e Lumëbardhit
- Ujëvara e Konjushës
- Kulla e Hoxhës
- Pika Malore Bistra
- Maja Kobilica
- Oshlaku
- Maja e Arnenit
- Prevalla

Trashëgimia Kulturore-Historike

Trashëgimia Kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar gjatë shekujve deri në ditët e sotme. Duke zotëruar një pozitë të mirë gjeografike dhe gjeopolitike, Prizreni gjithmonë është gjendur në udhëkryq të kulturave të mëdha, si dhe të kulturave etnike, të cilat kanë jetuar njëra pranë tjetrës, si: dardano-iliro-shqiptare, romake, bizantine, serbe, turko-osmane, etj. Në qytetin e Prizrenit gjatë shekujve flitëshin disa gjuhë zyrtare.

Asetet kryesore të trashëgimisë kulturore, historike dhe religjioze

- Lidhja Shqiptare e Prizrenit
- Kalaja e Prizrenit
- Ura e Gurit
- Shatërvani i Prizrenit
- Xhamia e Sinan Pashës
- Xhamia e Mehmed Pashës dhe Medreseja
- Hamami i Gazi Mehmed Pashës
- Xhamia e Emin Pashës
- Namazxhahu - Kërëk Xhamia
- Xhamia e Çatip Sinanit - Ljevisha
- Kishat e Shën Gjorgjit dhe Runoviq
- Katedrala Zonja Ndhimëtare
- Muzeu Arkeologjik - Sahat Kulla
- Famullia e Zymit
- Kompleksi Marash

Manifestimet kulturore

- DokuFest

- 40 Bunar Fest
- Festivali i këngës qytetare “Zambaku i Prizrenit”
- NGOM Fest
- Rock and Blues Fest
- Old Timer Fest
- Festivali i Stripit dhe Karikaturës
- Takimet e Gjeçovit
- Hasi Jehon dhe Sofra hasjane
- Zgjimi me Art (Sanatla Uyanmak)
- Panairi Kulturor
- Festivali i teatrove Prizren Fest
- Festivali i fëmijëve Fluturat
- Sofra e Gurbetqarëve - ansambli Emin Duraku, Zhur

Gjatë viteve të fundit DTZHE ka investuar në asete të ndryshme turistike, siç janë vendet e mëposhtme:

- Ujëvarat e fshatit Kabash në Korishë,
- Gurra në Poslisht,
- Fshati Nashec,
- Kala - Pashaqeshme,
- Prevallë, si destinacion turistik ku zhvillohet oferta turistike e skijimit dhe hikingut.
- Fshati Leskovec, etj.

Potencial për zhvillim kanë edhe destinacionet tjera, të cilat planifikohet të zhvillohen nga DTZHE, si psh.:

- Fshati Porodinë që ka pamje magjepëse të qytetit të Prizrenit,

- Fshati Vërmicë ku mbizotëron oferta e peshkut,
- Fshati Zym që posedon objekte të trashëgimisë kulturore,
- Fshati Struzhë që ka potencial për tërheqjen e turizmit nga aspekti i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore,
- Fshati Kabash i pasur me monumente fetare të ruajtuara ndërshekuj.

Sfidat kryesore për zhvillimin e turizmit

- Mungesa e infrastrukturës adekuate
- Mungesa e bashkëpunimit me akterë turistik
- Mungesa e promovimit dhe krijimit të ofertave turistike
- Mungesa e bashkëpunimit të nivelit lokal, qendror dhe rajonal
- Buxhet i pamjaftueshëm

Kultura, Rinia dhe Sporti

Gjatë vitit 2023 në Komunën e Prizrenit kanë qenë aktive rreth 834 organizata jo-qeveritare (OJQ), të cilat zhvillojnë aktivitete. Ky numër i OJQ-ve është marrë nga databaza e OJQ-ve aktive dhe të regjistruara në komunën e Prizrenit.

Numri i shfaqjeve dhe performancave artistike në shtëpinë e kulturës në vitin 2023 është 4 shfaqje dhe rreth 40 repriza.

Numri i klubeve sportive sipas llojit të sportit

- Klubet e Futbollit (KF), bashkë me Shkollat e Futbollit (SHF):

- KF "Liria"
- FC "Prizreni"
- KF "Pirana"
- KF "Drini i Bardhë Has"
- KF "Arbanasi"
- KF "Arbana"
- SH.F "Teuta"
- KF "Lidhja e Prizrenit"

- SH.F "Albionët"
- SH.F "Arasta"
- SH.F "Winner"
- SH.F "Dardanët"
- SH.F "Drini i Bardhë"

Klubet e Veteranëve të Futbollit (KVF):

- KFV "Kabashi"
- KFV "Veteranët"
- KFV "Pashtriku"
- KFV "Prizren Masters"
- KFV "Prizreni 2018"
- FCV "Lumbardhi"
- KFV "Republika"

Klubet e Basketbollit (KB) dhe Klubet Sportive (KS):

- KB "Bashkimi"
- KBF "Bashkimi 1965"
- KB "Ponte Prizreni"
- KS "Megasports"
- KB "Junior 06"
- KB "Ylli 04"
- KB "New Basket"
- KB "Bashkimi me Karroca"

Klubet e Mundjes (KM):

- Klubi i Mundjes "Prizreni"
- Klubi i Mundjes "Kolosi"
- Klubi i Mundjes "Xhevat Berisha"
- Klubi i Mundjes "Vëllazëria"

Klubet e tjera:

- Klubi Sportiv "Probiciklistët"
- Klubi i çiklizmit "Prizreni"
- Klubi i Çiklizmit Malor "Grupi 04"

- Klubi i Bilardos "Prizreni"
- Klubi i Notit "02 KNOP"
- Klubi i Tenisit "Kalaja"
- Klubi i Tenisit "Prizreni"
- Klubi i Ping Pongut "Lidhja e Prizrenit"
- Klubi i Ping Pongut "Liria"
- Klubi i Ping Pongut "Sharri"
- Klubi i Ping Pongut "Shkolla Prizren"
- Klubi i Veteraneve te Ping Pongut "Prizreni"
- Klubi i Karatesë "Eagle Sport Center"
- Klubi i Karatesë "Eagle"
- Klubi i Karatesë "Prizreni"
- Klubi i Karatesë "K-Dant Drini"
- Shoqata e Motoristëve "Shqiponjat"
- Moto Cros Team Prizreni (motosport)
- Off Road "Prizren" (motosport)
- Klubi i Atletikes "Prizreni"
- Klubi i Shahut "Prizreni"
- Klubi i Shahut "Zhupa"
- Klubi i Hendbollit "Lidhja e Prizrenit"
- Klubi i Hendbollit "Prizreni F"
- Klubi i Hendbollit "Prizreni M"
- Klubi i Hendbollit "Click"
- Klubi i Shigjetarisë Tradicionale
- Lidhja e Vëzhguesve "Rinia e Kosovës"
- Shoqata e Bjeshkatarëve "Sharri"
- Klubi i Boksit "Prizreni"
- Auto Moto Turning Klubi (Gara me vetura)
- SH.A.M "Prizreni D&G" (Gara me vetura)
- Aero Klub "Shkaba"
- Klubi i Paraglajdzimit "Balonat e Sait Ukës"
- Klubi i Paraglajdzimit "Kabashi"
- Shoqata bjeshkatore Haxhi Beda

Klubet sportive sipas llojit:

- Futboll: 20
- Basketboll 8
- Mundje 4
- Çiklizëm: 3
- Bilardo: 1
- Not: 1
- Tenis: 2
- Ping Pong: 5
- Karate: 4
- Motosport: 5
- Atletikë: 1
- Shah: 2
- Henboll: 4
- Shigjetari: 2
- Bjeshkatari: 3
- Paragllajdzëm: 3

Sfidat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

- Sfidë kryesore mbeten hapësirat e pamjaftueshme për zhvillim të aktiviteteve (veçanërisht sektori i sportit).

Teatri i Qytetit “Bekim Fehmiu” gjatë vitit 2023 aktivitetet i ka zhvilluar në Qendrën Kulturore Boshnjake, pasi që Shtëpia e Kulturës “Xhemajli Berisha” është në proces të renovimit.

Krahasimi me vendet/komunat tjera

Rajoni Jugor përbëhet nga 6 komuna: Prizreni, Dragashi, Malisheva, Suhareka, Rahoveci dhe Mamusha, dhe sipas të dhënave zyrtare, ky rajon ka një popullësi prej

409,449 banorëvë apo 22.76% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, të shpërndarë në një sipërfaqe prej 2,015.01 km² apo 18.47% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës.

Suhareka - Guri i Dollocit gjendet në kurrizin e Rustenikut dhe ka pozicion të mirë gjeografik. Mendohet se është mbetje e një fortifikate të ndërtuar gjatë periudhës së sundimit të Justinianit të I-rë dhe si e tillë është pikë trigonometrike. I gjithë vargmali përreth këtij lokacioni ka resurse të mira turistike, sidomos për turizmin sportiv por ende nuk ka ndonjë zhvillim përveç restoranteve në rrethinë. Zona e Rustenikut është një ndër parqet e para të mbrojtura, rajon ky i cili kufizohet edhe me komunat e Shtimes, Shtërpces dhe Prizrenit. Ka pyje të pasura dhe botë shtazore të ruajtur mirë, ndërsa rrjeti i shtigjeve të ecjes ka filluar të marrë formë sepse po ndikohet nga iniciativat e komunave fqinjë.

Rahoveci - Kanjoni i Drinit të Bardhë paraqet resurs primar për shkak se në këtë zonë Drini i Bardhë qetësohet dhe krijon kushte për sporte ujore dhe turizëm të vizitave të shkurtëra. Një zonë e tillë është krijuar me projektin e urës "Tibetiane" dhe shtegut të ecjes përreth Drinit të Bardhë në fshatin Fshaj. Gjithashtu, kjo zonë ka mundësi edhe për sportin e peshkatarisë dhe kajakut. Bjeshka e Zatriqit është një vargmal në veri të Rahovecit me potencial të lartë turistik dhe njihet me majën të cilën e mbizotëron këtë zonë. Janë disa burime karstike të cilat rrjedhin në drejtim të qytetit ndërsa për shkak të gjeologjisë ka edhe shpella të cilat parqesin interes turistik. Majat e njohura të këtij vargmali janë "Bajraku" dhe "Maja e Shkodranit" të cilat janë mjaft të njohura dhe lidhen me historinë e Rahovecit. Edhe kjo zonë nuk ka hartë dhe shtigje turistike. Verëtaria është komponenta më e njohur e Rahovecit dhe resursi kryesor i saj. Nga turizmi i verëtarisë kanë përfituar edhe bizneset tjera të perimtarisë dhe kulinarisë sepse shpesh ka ngjarje të ndryshme promovuese, si "Hardh Festi". Mbetet ende të zhvillohet edhe si turizmi familjar dhe ai sportiv. Etno-kultura, përfaqësuese e përbërjes etnike dhe kulturore të Rahovecit përbën interes për zhvillimin e turizmit kulturor sepse në këtë qytet ka edhe kulinari të kombinuar.

Analiza SWOT

| Përparësitë | Dobësitë |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Natyrë të pasur - Trashëgimi kulturore të pasur - Pozitë të mirë gjeografike (fusha pjellore, male) - Infrastrukturë e mirë rrugore me tërë Kosovën - Infrastrukturë e mirë rrugore me Shqipërinë dhe rajonin - Burime të mjaftueshme ujore - Infrastrukturë e pasur turistike - Vepra artizanale të artit tradicional - Njerëz mikpritës - Meny tradicionale e kuzhinës - Mjedis relativisht i paprekur - Ciceronë të licencuar - Organizimi i aktiviteteve të shumta vjetore të kulturës dhe sportit - Popullata e re me nivel të mirë të arsimimit - Parku natyror, rezervatet dhe zonat e mbrojtura - Prezenca e qendrave për aftësim profesional - Siguria financiare për funksionim bazë të komunës - Zyrat komunale për ofrim të asistencës për çështje bujqësore dhe ekonomike - Inkasimi i të hyrave vetanake vjetore mbi nivelin e planifikuar | <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e koordinimit mes akterëve të ndryshëm në nivel lokal dhe rajonal - Shkalla e lartë e papunësisë - Mungesa e zbatueshmërisë së ligjeve të favorshme për zhvillim ekonomik - Kapacitete të pamjaftueshme për trajtimin e ujërave të zeza - Mungesa e standardeve të përparuara në shërbimet e turizmit - Parkingje të pamjaftueshme për automjete; - Promovim i pamjaftueshëm i turizmit; - Mungesa e kuadrove profesionale sipas kërkesave të tregut të punës - Mungesa e strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të qëndrueshëm dhe të balancuar - Mungesa e strategjisë dhe stimulimit për tërheqje të investimeve - Varësia e madhe buxhetore nga grantet qeveritare - Mosfunksionalizimi i zonës ekonomike në Lubizhdë - Pengesat që ndërlidhen me definimin e titujve pronësorë - Mungesa e pronës komunale për ta shfrytëzuar për qëllime investuese - Mungesa e infrastrukturës dhe vetëdijesimit për riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave |
| Rreziqet | Mundësitë |

| | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Konkurrenca e fortë e vendeve të rajonit - Mungesë e investimeve nga Qeveria dhe investitorët e huaj - Rritja e inflacionit - Situatat e jashtëzakonshme (pandemitë, fatkeqësitë natyrore, etj.) - Largimi i kuadrit profesional - Vendimet e pakoordinuara nga niveli qendror me efekt negativ financiar në komuna - Rrezik për investime (zhvillimet politike) - Furnizim jo i rregullt me energji elektrike, gjendja joadekuate teknike e infrastrukturës elektrike - Degradim mjedisor, ndotje te ajrit, ndotje të lumenjve - Mungesë e fondeve zhvillimore - Jo efikasitet i gjykatave dhe organeve të zbatimit të ligjit - Migrimi i pakontrolluar nga zonat rurale në zonat urbane dhe migrimi jashtë vendit - Definimi jo i qartë i kompetencave në mes të nivelit lokal dhe qendror | <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i vetë qytetit si një destinacion turistik me rritje të shpejtë - Përfshirja e diasporës në zhvillimin ekonomik - Ndërlidhja e Prizrenit me destinacione të tjera turistike të Shqipërisë dhe vendeve në rajon - Mbështetja dhe vullneti i mirë për investime nga komuna, bizneset, qytetarët dhe diaspora; - Investimet nga qeveria dhe donatorët për Prizrenin - Përdorimi i teknologjisë digjitale moderne - Disponueshmëria e skemave te granteve nga komuna dhe donatorë ndërkombëtarë - Shfrytëzimi i vendeve atraktive për ndërtimin e objekteve të reja rekreative dhe sportive - Zhvillimi i iniciativave të reja në kuadër të bashkëpunimit ndër-kufitar - Potencial i lartë për zhvillimin e qendrave të skijimit në malin e Sharrit me shtigje te skijimit të përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore - Rritja e partneritetit publiko-privat |
|--|---|

Tab.20 – Analiza SWOT

Përmbledhja e sfidave

Sfidat në sektorin e arsimit

- Kapacitetet e kufizuara për planifikim dhe menaxhim të bazuar në të dhëna statistikore,
- Numër i kufizuar i personelit arsimor i aftësuar për udhëheqje në arsim.
- Mos konsolidim i strukturave udhëheqëse dhe menaxheriale të shkollës.
- Mungesë e mekanizmave për stimulim të menaxhimit efikas të shkollave dhe angazhimit për ndërmarrësi.
- Mungesë e mekanizmave për vlerësim të brendshëm të shkollave.
- Bashkëpunim i kufizuar ndërmjet shkollave.
- Shkallë e ultë e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor.
- Mungesë e bashkëpunimit me institucionet private të arsimit.
- Përfshirje e ultë në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara.
- Vetëdije e ultë lidhur me rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të grupeve të marginalizuara
- Kapacitete të kufizuara për organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave për Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve (ZHPM).
- Mungesë e mekanizmave për financimin e ZHPM.
- Mungesa e kapaciteteve brenda komunës për organizim dhe menaxhim të ZHPM.
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm me Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe OJQ për ZHPM.
- Kapacitete të kufizuara për monitorimin e zbatimit të metodologjive bashkëkohore.
- Mungesë e mekanizmave për stimulim të mësimdhënësve të suksesshëm.
- Kapacitete të limituara komunale për mbështetjen e shkollave në zbatimin e kurrikulës së re.
- Kapacitete të kufizuara për zhvillimin e kurrikulës me bazë në shkollë.
- Mungesë e materialeve mësimore për zbatimin e kurrikulës së re.
- Mos informimi i duhur i prindërve lidhur me konceptet themelore të kurrikulës së re.
- Mungesa e përvojës për sigurimin e cilësisë në nivel të komunës dhe shkollës.
- Fonde të kufizuara për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.

- Buxhet i pamjaftueshëm për sigurimin e mjeteve të konkretizimit, laboratorëve, kabinetëve, etj.
- Vështirësi për sigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
- Mosharmonizim i disa profileve në arsimin profesional me kërkesat e tregut të punës.
- Investimet në sektorin e arsimit fillimisht duhet të orientohen në komunat ku kërkesa është më e madhe (sipas MASHT-it komunat e Prizrenit, Prishtinës, Podujevës, Gjilanit dhe Gjakovës);

Sfidat në sektorin e Infrastrukturës

- Shtimi i kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Prizrenit;
- Mungesa e ujit të pijes (keqpërdorimet dhe humbjet në rrjet)
- Identifikimi i burimeve të reja të ujit
- Fytet e ngushta në komunikacion
- Shtimi i sigurisë rrugore
- Mungesa e sinjalistikës së duhur rrugore
- Mungesa e hapësirave të mjaftueshme gjelbëruese
- Mungesa e deponive për mbeturina inerte dhe mbetjeve shtazore
- Mungesa e parkingjeve
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik
- Përmirësimi i shërbimeve të transportit lokal publik (urban dhe periferik)
- Ndërtimi i nënstacionit (NS) Prizreni 4.400/110 kV, 1x300 MVA në vazhdimësi të NS Prizreni 2 i cili përmban dy fusha të linjave 400 kV dhe një fushë lidhëse 400 kV;
- Ndërtimi i linjës 400 kV nga SSH Gjakova 3 deri tek NS Prizreni 4;
- Ndërtimi i linjës 400 kV nga NS Prizreni 4 deri tek NS Ferizaj 2;

Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx
- xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

Sfidat në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Krijimi i sipërfaqeve të reja të tokës bujqësore dhe rehabilitimi i sipërfaqeve ekzistuese;
- Kufizimi i ndërtimeve/zgjerimeve të mëtejme në vendbanime dhe korridore infrastrukturore;
- Stimulimi i fermerëve dhe të NVM-ve, që merren me kultivim, ruajtje, përpunimin dhe shitje të prodhimeve bujqësore;
- Rritja e nivelit të cilësisë së prodhimeve bujqësore, e sidomos atyre bio-ekologjike;
- Rritja e kapaciteteve prodhuese që mundësojnë edhe krijimin e vende të reja të punës;
- Rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve qendrore dhe lokale për monitorim më rigoroz dhe efikas ndaj humbjes së sipërfaqeve bujqësore;
- Ndarja e përgjegjësisë institucionale, të nivelit qendror dhe lokal, mbi proceset e planifikimit, miratimit dhe monitorimit të zbatimit të zhvillimeve si nga sektori bujqësor ashtu edhe ai urban/ndërtimor;
- Promovimi i zhvillimit kompakt në zonat urbane dhe rurale;
- Identifikimi i zonave më të përshtatshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore, si për arat (drithëra e perime), vreshtat (rrush), plantacionet (pemë), fidanishtet (hortikulturë), livadhet (ushqime kafshësh), etj;
- Azhurnimi dhe procedimi i të dhënave për sipërfaqet e ndërtuara të vreshtarisë;
- Komasacioni / rregullimi i tokave të fragmentuara bujqësore dhe krijimi i rrjetit të rrugëve fushore;
- Realizimi i projektit “Sistemi i Identifikimit të Parcelave” (LPIS);
- Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore duke adoptuar zonat kodrinore ose ato më pak të përshtatshme nën ujitje;
- Rehabilitimi i rrjetit të Sistemit të Ujitjes dhe zgjerimi i tij, me qëllim të rritjes së sipërfaqeve të tokës bujqësore dhe të cilësisë së prodhimit;
- Ruajtja e standardit ekologjik të tokës bujqësore për prodhimin e kulturave cilësore pa përdorim të preparateve kimike;
- Inspektimi i kujdesshëm dhe në kohë reale si gjatë monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të lejuara (sipas Planeve të miratuara) ashtu edhe në parandalimin e zhvillimeve të palejuara;
- Përditësimi dhe shkëmbimi ndërinstytucional i informatave më të hollësishme, për të gjitha hartat e modeleve hapësinore;

- Krijimi dhe zhvillimi i rrjetit të Bazës së të Dhënave Kombëtare, në aplikacionin GIS për të dyja nivelet, dhe përditësim të informatave më të hollësishme nga njësitë lokale të qeverisjes;
- Minimizimi i shpenzimeve për zhvillime të infrastrukturës dhe të shërbimeve tjera publike, që përmes urbanizimit sa më të koncentruar të lehtësojë barrën e financimit për zbatim të tyre;
- Trajtimi i kafshëve endacake

Sfidat në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore

- Mungesa e infrastrukturës adekuate
- Mungesa e bashkëpunimit me akterë turistik
- Mungesa e pakove turistike
- Mungesa e marketingut
- Mungesa e promovimit dhe krijimit të ofertave turistike
- Mungesa e bashkëpunimit të nivelit lokal dhe qendror.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm 1: Arsimi

7.1.1 Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i kushteve dhe shtimi i kapaciteteve të objekteve shkollore në 5 lokacione të ndryshme përmes anekseve shkollore dhe shkollave të reja brenda tri viteve të ardhshme

7.1.1.1 Treguesi 1 – Shtimi i hapësirave shkollore për nxënësit e shkollave në Landovicë, Vërmicë, Romajë, Lutogllavë dhe Prizren

7.1.1.1.1 *Aktiviteti 1 – Përgatitja e punëve të terrenit në lokacionet e përmendura më lartë*

7.1.1.1.2 *Aktiviteti 2 – Ndërtimi i anekseve, punët finalizuese dhe furnizimi me inventar*

7.1.1.2 Treguesi 2 – Rritja e numrit të nxënësve të regjistruar në vitet shkollore 2024/2025/2026/2027/2028

7.1.1.2.1 *Aktiviteti 1 – Informimi për regjistrim dhe regjistrimi i nxënësve në klasa*

7.1.1.2.2 *Aktiviteti 2 – Pajisja dhe furnizimi me mjete pune në klasë*

7.1.2 Objektivi specifik 2 – Krijimi i kushteve më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes furnizimit me mjete konkretizuese dhe laboratore në shkolla brenda tri viteve të ardhshme shkollore

7.1.2.1 Treguesi 1 – Numri dhe lloji i mjeteve konkretizuese të furnizuara

7.1.2.1.1 *Aktiviteti 1 – Përgatitja e dokumentacionit për blerje të mjeteve konkretizuese*

7.1.2.1.2 *Aktiviteti 2 – Blerja dhe funksionalizimi i mjeteve konkretizuese*

7.1.2.2 Treguesi 2 – Numri dhe lloji i laboratoreve të instaluar në shkolla

7.1.2.2.1 *Aktiviteti 1 – Përgatitja e dokumentacionit për furnizim me laboratore*

7.1.2.2.2 *Aktiviteti 2 – Blerja dhe instalimi i pajisjeve laboratorike*

7.1.3 Objektivi specifik 3 – Krijimi i kushteve dhe mundësi i zhvillimit të aktiviteteve të edukatës fizike në shkollat e komunës së Prizrenit

7.1.3.1 Treguesi 1 – Numri i sallave të edukatës fizike në shkolla të komunës së Prizrenit

7.1.3.1.1 *Aktiviteti 1 – Punët përgatitore dhe ndërtimi i vrazhdë i sallave përkatëse*

7.1.3.1.2 *Aktiviteti 2 – Finalizimi i punëve jashtë dhe brenda sallave si dhe instalimi i rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit dhe rrymës elektrike*

7.1.3.2 Treguesi 2 – Madhësia dhe lloji i sallave dhe fushave të edukatës fizike në shkolla të komunës së Prizrenit

7.1.3.2.1 *Aktiviteti 1 – Furnizimi me pajisje përkatëse (për sporte të ndryshme) të sallave të edukatës fizike*

7.1.3.2.2 *Aktiviteti 2 – Montimi dhe instalimi i pajisjeve dhe rekuizitave sportive përkatëse sipas natyrës së përdorimit të sallës.*

Objektivi i përgjithshëm 2: Infrastruktura

7.1.4 Objektivi specifik 1: Krijimi i kushteve më të mira për jetesë dhe zhvillim të bizneseve

7.1.4.1 Treguesi 1: Zgjerimi i sistemit të ujësjellësit në komunë

7.1.4.1.1 *Aktiviteti 1: Punët përgatitore për rregullim të ujësjellësit*

7.1.4.1.2 *Aktiviteti 2: Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit*

7.1.4.2 Treguesi 2: Zgjerimi i sistemit të kanalizimit

7.1.4.2.1 *Aktiviteti 1: Punët përgatitore për rregullim të kanalizimit*

7.1.4.2.2 *Aktiviteti 2: Instalimi i gypave dhe pusetave përgjatë vijës së investimit*

7.1.5 Objektivi specifik 2: Krijimi i kushteve mjedisore dhe funksionalizimi i hapësirave publike përmes ndërtimit të hapësirave të gjelbërta dhe instalimit të ndriqimit publik në territorin e komunës së Prizrenit

7.1.5.1 Treguesi 1: Rritja e hapësirave të gjelbërta në lokacione të ndryshme në qytet dhe fshatra

7.1.5.1.1 *Aktiviteti 1: Kryerja e punëve të vrazhdëta në lokacionet përkatëse*

7.1.5.1.2 *Aktiviteti 2: Instalimi dhe montimi i pajisjeve të ndryshme në parqe*

7.1.5.2 Treguesi 2: Rritja e së paku 50% e shfytëzueshmërisë së hapësirave të gjelbërta nga banorët dhe bizneset lokale

7.1.5.2.1 *Aktiviteti 1: Promovimi i hapësirave të shfrytëzueshme për përdorim nga banorët dhe bizneset*

7.1.1.1.1 *Aktiviteti 2: Organizimi i aktiviteteve të ndryshme argëtuese, rekreative dhe panairëve*

7.1.2 Objektivi specifik 3: Krijimi i kushteve dhe rritja e mundësive për qarkullim më të lehtë dhe të shpejtë të qytetarëve përmes ndërtimit të rrugëve me infrastrukturën përcjellëse

7.1.2.1 Treguesi 1: Rritja e gjatësisë së rrugëve të rregulluara të komunës

7.1.2.1.1 *Aktiviteti 1: Rehabilitimi i rrugëve ekzistuese*

7.1.2.1.2 *Aktiviteti 2: Rehabilitimi i infrastrukturës përcjellëse rrugore*

7.1.2.2 Treguesi 2: Mundësimi i qasjes mw tw lehtw të qytetarëve nga lokacionet e ndryshme në qendër

7.1.2.2.1 *Aktiviteti 1: Shtrimi i rrugëve të reja*

7.1.2.2.2 *Aktiviteti 2: Instalimi dhe vendosja e infrastrukturës përcjellëse rrugore*

Objektivi i përgjithshëm 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

7.1.3 Objektivi specifik 1: Ndërtimi i objekteve të reja shëndetësore

7.1.3.1 Treguesi 1 (Së paku dy objekte të reja shëndetësore janë ndërtuar në komunën e Prizrenit)

7.1.3.1.1 *Aktiviteti 1: Ndërtimi i objekteve të reja shëndetësore*

7.1.3.2 Treguesi 2 (Objektet e reja dhe ato të vjetra janë të furnizuara me pajisje të nevojshme medicinale dhe jomedicinale)

7.1.3.2.1 *Aktiviteti 1: Sigurimi i pajisjeve të nevojshme medicinale dhe jomedicinale*

7.1.4 Objektivi specifik 2: Ngritja e cilësisë së shërbimeve sociale në komunë

7.1.4.1 Treguesi 1 (Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat e cënueshme)

7.1.4.1.1 *Aktiviteti 1: Ndërtimi i objekteve të reja sociale*

7.1.4.2 Treguesi 2 (Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale)

7.1.4.2.1 *Aktiviteti 1: Ndërtimi i QPS 2*

7.1.5 Objektivi specifik 3: Furnizim me pajisje të nevojshme për objektet sociale

7.1.5.1 Treguesi 1 (Shtëpia rezidenciale dhe ajo e pleqëve janë furnizuar me automjete përkatëse)

7.1.5.1.1 *Aktiviteti 1: Sigurimi i automjeteve për objektet rezidenciale*

7.1.5.2 Treguesi 2 (Siguria në objektet sociale është në nivelin e duhur)

7.1.5.2.1 *Aktiviteti 1: Rritja e sigurisë në objektet sociale*

Objektivi i përgjithshëm 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

7.1.6 Objektivi specifik 1: Përmirësimi i kushteve të punës dhe njohurive teknike të fermerëve

7.1.6.1 Treguesi 1 (Njohuritë e fermerëve rreth praktikave bujqësore dhe afarizmit janë ngritur)

7.1.6.1.1 *Aktiviteti 1: Ndërtimi i objektit për trajnimin e fermerëve*

7.1.6.2 Treguesi 2 (Kushtet fizike për fermerët e komunës janë përmirësuar)

7.1.6.2.1 *Aktiviteti 1: Rregullimi i rrugëve fushore dhe kullimit të tokave bujqësore*

7.1.7 Objektivi specifik 2: Rritja e prodhimit bujqësor

7.1.7.1 Treguesi 1 (Prodhimtaria bujqësore është rritë mbi 30% me nxitjen e investimeve të reja)

7.1.7.1.1 *Aktiviteti 1: Krijimi i kushteve më të mira fizike për fermerë*

7.1.7.2 Treguesi 2 (Në sektorin e bujqësisë janë punësuar së paku 300 punëtorë deri në fund të vitit 2026)

7.1.7.2.1 *Aktiviteti 1: Rritja e prodhimit dhe eksportit bujqësor*

7.1.8 Objektivi specifik 3: Promovimi më i mirë i produkteve bujqësore

7.1.8.1 Treguesi 1 (Qarkullimi në sektorin e bujqësisë është rritur mbi 30% deri në fund të vitit 2025)

7.1.8.1.1 *Aktiviteti 1: Bashkëpunimi më i mirë në mes të fermerëve*

7.1.8.2 Treguesi 2 (Fermerët lokal kanë përvetësuar metoda dhe praktika të reja në agrokulturë)

7.1.8.2.1 *Aktiviteti 1: Këmbimi i njohurive dhe praktikave më të mira me fermerët e rajonit*

Objektivi i Përgjithshëm 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

7.1.9 Objektivi specifik 1: Avansimi i infrastrukturës turistike në komunën e Prizrenit

7.1.9.1 Treguesi 1 (Infrastruktura turistike e rregulluar në disa pika turistike të komunës)

7.1.9.1.1 *Aktiviteti 1: Zhvillimi i infrastrukturës turistike*

7.1.9.2 Treguesi 2 (Infrastruktura turistike – historike e rregulluar në katër pika të trashëgimisë së luftës së UÇK-së)

7.1.9.2.1 *Aktiviteti 1: Investimet në trashëgiminë e UÇK-së*

7.1.10 Objektivi specifik 2: Mirëmbajtja dhe rritja e objekteve të trashëgimisë kulturore

7.1.10.1 Treguesi 1 (Trashëgimia kulturore në komunën e Prizrenit është mirëmbajtë dhe pasuruar me asete të reja)

7.1.10.1.1 *Aktiviteti 1: Ndërtimi i objekteve të reja kulturore në qytet*

7.1.10.2 Treguesi 2 (Rritja e investimeve në sektorin e kulturës në zonat rurale)

7.1.10.2.1 *Aktiviteti 1: Renovimi dhe ndërtimi i objekteve kulturore rurale*

7.1.11 Objektivi specifik 3: Krijimi i kushteve për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit

7.1.11.1 Treguesi 1 (Objektet ekzistuese sportive janë të mirëmbajtura dhe objekte të reja janë ndërtuar)

7.1.11.1.1 *Aktiviteti 1: Mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve të reja sportive*

7.1.11.2 Treguesi 2 (Ndërtimi i parqeve të reja në komunën e Prizrenit)

7.1.11.2.1 *Aktiviteti 1: Shtimi i hapsirave të gjelbërta në qytet*

Monitorimi dhe Raportimi

Monitorimi dhe raportimi i strategjisë duhet të bëhet kundrejt objektivave përmes tregueseve të vendosur. Raportimi duhet të përfundojë në tre mujorin e parë të vitit pasues dhe duhet të ketë informata lidhur me shkallën e zbatimit të tregueseve, problemet me zbatim dhe masat korrigjuese. Duket u bazuar në raportet e progresit të dokumenteve strategjike, dhe në bazë të sistemit të monitorimit, sipas nevojës bëhet rishikimi/vlerësimi i ndërmjetëm i planeve të veprimit.

Të dhënat e monitorimit do të mblidhen në baza vjetore. Bazuar në këto të dhëna, do të hartohen raporte të rregullta të progresit për të pasqyruar nivelin e zbatueshmërisë së këtij dokumenti.

Drejtoria e administratës në kuadër të Komunës së Prizrenit do të jetë institucioni përgjegjës për koordinimin e procesit të grumbullimit të të dhënave dhe për hartimin e raportit vjetor të progresit të SZHEL 2024-2029. Raporti vjetor i progresit do të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.

Matja e zbatueshmërisë së strategjisë do të bëhet përmes treguesve të ndikimit (për objektivat strategjike); treguesve të rezultatit (për objektivat specifike) dhe treguesve të produktit (për aktivitetet strategjike).

Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor

| Përmbledhje e kostove të Strategjisë | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 |
|---|------------|------------|------------|
| Mbështetja e zotuar me ekspertë | | | |
| Mbështetja e zotuar buxhetore (e harmonizuar me KASH) | 10,495,952 | 11,000,000 | 12,500,000 |
| Mundësi potenciale financimi për donatorët | 500,000 | 500,000 | 1,000,000 |
| Buxheti i Kosovës | | | |
| Totali | 10,995,952 | 11,500,000 | 13,500,000 |

I. Plani i Veprimit

PLANI I VEPRIMIT 2024-2026 PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2024-2029

| Objektivi i përgjithshëm 1: ARSIMI | | | | | | |
|---|---|--------------------|---|----------------------|-----------------------|-----------|
| Objektivi specifik 1.1 | Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit | | | Gjendja bazë | Caku 2025 | Caku 2026 |
| Përmirësimi i kushteve dhe shtimi i kapaciteteve të objekteve shkollore në lokacione të ndryshme përmes anekseve shkollore dhe shkollave të reja brenda tre viteve të ardhshme. | 1. Hapësirat shkollore të komunës se Prizrenit janë shtuar | | | | | |
| | 2. Numri i nxënësve të regjistruar në vitet shkollore 2024/2025, 2025/2026 dhe 2026/2027 është rritur | | | | | |
| Aktiviteti | Afati për zbatim 2024-2026 | Kostoja Totale (€) | Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të ceket) | Drejtoria udhëheqëse | Drejtoria mbështetëse | Rezultati |
| 1.1.1 Ndërtimi i anekseve shkollore | | | | | | |

| | | | | | | |
|--|-----------|------------|--------------------|---------------------|-----------------------|----------------------------------|
| 1) Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë | 2024 | 240,218.84 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Aneksi i ndërtuar |
| 2) Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vërmicë | 2024 | 243,333.54 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Aneksi i ndërtuar |
| 3) Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë - Has | 2024 | 140,000.54 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Aneksi i ndërtuar |
| 4) Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllave | 2024-2026 | 400,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Aneksi i ndërtuar |
| 5) Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Gjinnazi "Remzi Ademaj" në Prizren | 2025-2026 | 400,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Aneksi i ndërtuar |
| 1.1.2 Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe renovimi i atyre ekzistuese | | | | | | |
| 6) Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek | 2024-2025 | 433,253,53 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Objekti i ri shkollor i ndërtuar |
| 7) Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushë të Vogël | 2024-2025 | 391,589.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Objekti i ri shkollor i ndërtuar |
| 8) Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Gernqare" Novoselan | 2024 | 78,148.35 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Objekti shkollor i renovuar |
| 9) Renovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren | 2024 | 100,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Objekti shkollor i renovuar |

| | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|
| 10) Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Lagjen "Bajram Curri" Prizren | 2025-2026 | 300,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Objekti i ri shkollor i ndërtuar |
| Objektivi specifik 1.2 | Treguesi (treguesit) për matjen e përbushjes së objektivit | | | Gjendja bazë | Caku 2025 | Caku 2026 |
| Krijimi i kushteve më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes furnizimit me mjete konkretizuese dhe laboratore në shkolla brenda tri viteve të ardhshme shkollore | 1. Shkollat e komunës janë furnizuar me mjete konkretizuese | | | | | |
| | 2. Është rritur numri i laboratoreve të instaluar nëpër shkolla | | | | | |
| Aktiviteti | Afati për zbatim | Kostoja Totale | Burimi i financimit | Drejtoria udhëheqëse | Drejtoria mbështetëse | Rezultati |
| 1.1.1 Sigurimi i pajisjeve për laboratorë dhe mjeteve tjera konkretizuese | | | | | | |
| 11) Adaptimi i hapësirave për laboratore | 2025-2026 | 50,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Hapësirat janë adaptuar |
| 12) Furnizimi i shkollave me pajisje për laboratorë dhe mjete tjera konkretizuese | 2025-2026 | 300,000.00 | Komuna e Prizrenit | Drejtoria e Arsimit | Drejtoria e Financave | Shkollat janë furnizuar me mjete e pajisje |
| Objektivi specifik 1.3 | Treguesi (treguesit) për matjen e përbushjes së objektivit | | | Gjendja bazë | Caku 2025 | Caku 2026 |
| | 3. Është rritur numri i sallave të edukatës fizike në shkollat e komunës së Prizrenit | | | | | |

| Krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve të edukatës fizike në | 4. Është bërë renovimi i sallave dhe fushave të edukatës fizike | | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------------|-----------------------------|------------------------------|---------------------------------|
| 4.1 NJ.P- PRIZREN – TM1- 2023-2024 | 15 |
| 4.1 INVESTIMET – NJP- PRIZREN | 0 |

I. MBELUESHMËRIA ME SHËRBIME NË PRIZREN

1.1 Zonat në menaxhim të KRU-së

| Mbulushmeria në njesinë e Prizrenit, KRU "HRJ" | | | |
|--|-------------------|-------|-------|
| Nr. | Njesia | Qytet | Fshat |
| 1 | Prizren | Qytet | |
| 2 | Dushanovë | | Fshat |
| 3 | Petrovë | | Fshat |
| 4 | Atmaxhë | | Fshat |
| 5 | Landovicë | | Fshat |
| 6 | Tupec | | Fshat |
| 7 | Serbicë e poshtme | | Fshat |
| 8 | Serbicë e eperme | | Fshat |
| 9 | Trepetnicë | | Fshat |
| 10 | Malsi e re | | Fshat |
| 11 | Medvec | | Fshat |
| 12 | Zojz | | Fshat |
| 13 | Nashec | | Fshat |
| 14 | Pouskë | | Fshat |
| 15 | Grazhdanik | | Fshat |
| 16 | Gjonaj | | Fshat |
| 17 | Mazdrek | | Fshat |
| 18 | Kojushë | | Fshat |
| 19 | Kobajë | | Fshat |
| 20 | Vlashnje | | Fshat |
| 21 | Muradem | | Fshat |
| 22 | Panej | | Fshat |
| 23 | Milaj | | Fshat |
| 24 | Kushnin | | Fshat |
| 25 | Kabash i Hasit | | Fshat |
| 26 | Gorozhup | | Fshat |
| 27 | Dobrushtë | | Fshat |
| 28 | Vërmicë | | Fshat |
| 29 | Shkozë | | Fshat |
| 30 | Zhur | | Fshat |

1.2 Zonat te investuara dhe jashtë menaxhimit

| Mbulushmeria në njesinë e Prizrenit, KRU "HRJ" | | | |
|--|------------|-------|-------|
| Nr. | Njesia | Qytet | Fshat |
| 1 | Shpenadi | | Fshat |
| 2 | Velezhë | | Fshat |
| 3 | Smaç | | Fshat |
| 4 | Novak | | Fshat |
| 5 | Caparc | | Fshat |
| 6 | Lutugllavë | | Fshat |

1.3 Zonat jashtë menaxhimit të KRU-së

| Fshtrat qe nuk menaxhohen nga KRU "HRJ" | | | |
|---|-------------------|-------|--------|
| Nr. | Njesia | Qytet | Fshatë |
| 1 | Korishë | | Fshat |
| 2 | Lubizhdë | | Fshat |
| 3 | Gërncar | | Fshat |
| 4 | Novesellanë | | Fshat |
| 5 | Dojnicë | | Fshat |
| 6 | Skorobishtë | | Fshat |
| 7 | Kabash | | Fshat |
| 8 | Vërbiçan | | Fshat |
| 9 | Posilisht | | Fshat |
| 10 | Hoçë e qytetit | | Fshat |
| 11 | Leskovec | | Fshat |
| 12 | Billushë | | Fshat |
| 13 | Jashkovë | | Fshat |
| 14 | Lubiqevë | | Fshat |
| 15 | Kustandil | | Fshat |
| 16 | Lez | | Fshat |
| 17 | Jabllanicë | | Fshat |
| 18 | Llokvicë | | Fshat |
| 19 | Reçan | | Fshat |
| 20 | Zhivinjan | | Fshat |
| 21 | Pllanjan | | Fshat |
| 22 | Struzh | | Fshat |
| 23 | Nepergosht | | Fshat |
| 24 | Manastirivë | | Fshat |
| 25 | Lubinjë e poshtme | | Fshat |
| 26 | Lubinjë e eperme | | Fshat |
| 27 | Drajçiq | | Fshat |
| 28 | Mushnikovë | | Fshat |
| 29 | Sredeskë | | Fshat |
| 30 | Gornjesellë | | Fshat |

1.4 Zonat e menaxhuara nga KRU- Gjakova

| Fshatrat qe nuk menaxhohen nga KRU "HRJ" | | | |
|--|------------------|-------|--------|
| Nr. | Njesia | Qytet | Fshatë |
| 1 | Lubizhdë e Hasit | | Fshat |
| 2 | Dedaj | | Fshat |
| 3 | Romajë | | Fshat |
| 4 | Lukinaj | | Fshat |
| 5 | Karashengjergj | | Fshat |
| 6 | Zym | | Fshat |
| 7 | Krajk | | Fshat |
| 8 | Krushe e vogël | | Fshat |
| 9 | Piranë | | Fshat |
| 10 | Randobravë | | Fshat |

2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES


2.1 Stacionet e pompimit

Të dhënat e stacioneve të pompimit me koordinata, kapacitete dhe karakteristika.

| Nr | Emri i stacionit të pompimit | Y | X | Z | Komuna | Fuqia e pompës (kW) |
|----|------------------------------|------------|------------|--------|---------|---|
| 1 | BUNARI 1 | 7478771.37 | 4674494.87 | 413.77 | Prizren | PUMP 2X 5.5kW/10.5A PUMP 1X 7.5kW/15A PUMP 1X 2.2kW/4-6A PUMP 3X 90kW/160A PUMP 1X 90kW/160A PUMP 1X 45kW/80-90A |
| 2 | BUNARI 2 | 7478829.51 | 4674565.51 | 414.85 | Prizren | PUMP 2x45KW/90A PUMP 3x90KW/160A |
| 3 | 40-BURIMET | 7481229.15 | 4672820.14 | 490.08 | Prizren | PUMP 1X 2.2kW / 6A PUMP 2X 7.5kW / 15A PUMP 1X 15kW / 30A PUMP 1X 11kW / 22A PUMP 2X 9.2kW / 20A |
| 4 | 40-BURIMET - KOMORA E RE | 7481124.70 | 4672882.80 | 480.27 | Prizren | PUMP 1X 2.2kW / 6A PUMP 2X 5.5kW / 16A PUMP 2X 7.5kW / 16A PUMP 2X 0.55kW - CI |
| 5 | 40-BURIMET - Puset TEK OAZA | 7480560.33 | 4673333.84 | 470.35 | Prizren | PUMP 2X 7.5kW / 16A PUMP 2X 9.2kW / 25A |

| | | | | | | |
|----|------------------|------------|------------|--------|---------|---|
| 6 | MULLIRI I VJETER | 7479959.62 | 4673974.24 | 446.14 | Prizren | PUMP 1X 7.5kW / 16A PUMP 1X 11kW / 25A PUMP 1X 15kW / 45A PUMP 1X 3kW / 10A - CI PUMP 1X 1.5kW - CI |
| 7 | REZ.SHPATI | 7479239.93 | 4674609.04 | 462.12 | Prizren | PUMP 2X 75kW / 126A |
| 8 | REZ.VERMICA | 7464698.10 | 4668893.22 | 446.95 | Prizren | PUMP 2X 110kW / 185A PUMP 1X 37kW / 39.5A PUMP 1X 18.5kW / 34A PUMP 1X 11kW / 24A |
| 9 | ST,P.MURADEMAJ | 7470627.08 | 4673153.54 | 325.62 | Prizren | PUMP 2X 11kW / 20.3A |
| 10 | REZ.NASHEC | 7471208.08 | 4677435.97 | 294.43 | Prizren | PUMP 3X 45kW / 83A PUMP 3X 37kW / 64A PUMP 1X 15kW / 28.5A |
| 11 | REZ.KOJUSH 1 | 7468238.54 | 4676235.99 | 459.84 | Prizren | PUMP 3X 22kW / 40.5A |
| 12 | REZ.KOJUSH 2 | 7467220.61 | 4676088.15 | 564.10 | Prizren | PUMP 2X 15kW / 29A |

Harta e stacioneve të pompave në zonën e shërbimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren




Të dhënat e burimeve ujore me koordinata dhe karakteristikat e burimit.

| Nr. | Emri i burimit | Lloji i Burimit | Komuna | Lokacioni | |
|------------|-----------------------|------------------------|---------------|------------------|-------------|
| 1 | 40 Burimet | Burim nëntokësor | Prizren | 7481106.69 | 4672918.209 |
| 2 | Galeria I dhe II | Burim nëntokësor | Prizren | 7478775.213 | 4674493.762 |
| 3 | Sozi | Burim nëntokësor | Prizren | 7471247.48 | 4677340.116 |
| 4 | Vërmicë | Burim nëntokësor | Prizren | 7465211.501 | 4669737.463 |
| 5 | Gjonaj | Burim nëntokësor | Prizren | 7468934.457 | 4680122.267 |
| 6 | Sërbicë e Poshtme | Burim nëntokësor | Prizren | 7474842.322 | 4683052.394 |
| 7 | Novakë | Burim nëntokësor | Prizren | 7480291.415 | 4684329.108 |
| 8 | Cvileni | Burim nëntokësor | Prizren | 7479019.681 | 4671299.215 |
| 9 | Malësi e re | Burim nëntokësor | Prizren | 7484227.125 | 4680800.6 |
| 10 | Kabash i Hasit | Burim nëntokësor | Prizren | 7463097.111 | 4681356.882 |
| 11 | Kushnin | Burim nëntokësor | Prizren | 7462811.914 | 4681303.893 |
| 12 | Zojz | Burim nëntokësor | Prizren | 7475036.349 | 4684398.897 |
| 13 | Medvec | Burim nëntokësor | Prizren | 7476198.719 | 4685414.717 |
| 14 | Poslisht Gurra | Burim nëntokësor | Prizren | 7472655.01 | 4671010.98 |

Të dhënat e rezervuarëve me koordinata, kapacitete dhe karakteristika.

| Nr | Emri i stacionit të pompimit | x | y | z | Komuna | Kapaciteti m3 | Materiali | Viti i futjes në operim |
|----|------------------------------|------------|------------|--------|---------|---------------|-----------|-------------------------|
| 1 | Rezervuari i Tusuzit 1 | 4673374.55 | 7477888.07 | 510.00 | Prizren | 2000 | Beton | 1986 |
| 2 | Rezervuari Kalaja | 4674410.65 | 7478965.83 | 518.57 | Prizren | 360 | Beton | 1945 |
| 3 | Rezervuari Kobaj | 4676279.81 | 7471329.01 | 459.62 | Prizren | 340 | Beton | 1988 |
| 4 | Rezervuari Kojush II | 4676085.79 | 7467214.52 | 564.10 | Prizren | 150 | Beton | 1989 |
| 5 | Rezervuari Planea | 4675550.10 | 7465810.79 | 749.14 | Prizren | 150 | Beton | 1973 |
| 6 | Rezervuari Landovices | 4679725.98 | 7473769.10 | 371.00 | Prizren | 35 | Beton | 1987 |
| 7 | Rezervuari Murademaj | 4672932.02 | 7470148.48 | 417.32 | Prizren | 180 | Beton | 1986 |
| 8 | Rezervuari i Vermices | 4668890.67 | 7464699.37 | 446.95 | Prizren | 500 | Beton | 1978 |
| 9 | Rezervuari Shkoze i Ri | 4669080.97 | 7466306.40 | 480.00 | Prizren | 300 | Beton | 2004 |
| 10 | Rezervuari Shpati | 4674615.04 | 7479244.20 | 462.11 | Prizren | 5000 | Beton | 1986 |
| 11 | Rezervuari Zhur i Ri | 4668744.23 | 7469133.63 | 546.00 | Prizren | 300 | Beton | 1993 |
| 12 | Rezervuari Zhur i Vjeter | 4668827.72 | 7469132.14 | 520.00 | Prizren | 150 | Beton | 1968 |
| 13 | Rezervuari Komunes | 4675541.22 | 7480190.38 | 583.24 | Prizren | 500 | Beton | 2019 |
| 14 | Rezervuari Kurilla i qytetit | 4675319.13 | 7479761.73 | 505.00 | Prizren | 1000 | Beton | 1986 |
| 15 | Rezervuari Gjonaj Te Gurra | 4680237.11 | 7469343.56 | 359.00 | Prizren | 300 | Beton | 2017 |
| 16 | Rezervuari Gjonaj-Komuna | 4678407.77 | 7467853.91 | 600.00 | Prizren | 750 | Beton | 2020 |
| 17 | Rezervuari Novakes | 4685176.05 | 7480955.26 | 408.24 | Prizren | 400 | Beton | 2004 |
| 18 | Rez.Serbice e Ulet | 4682792.24 | 7475179.15 | 352.00 | Prizren | 80 | Beton | 2005 |
| 19 | Rez.Medvec | 4685739.03 | 7475799.22 | 360.00 | Prizren | 110 | Beton | 2008 |
| 20 | Rez.Zojz | 4684805.38 | 7474469.29 | 353.00 | Prizren | 250 | Beton | 2007 |
| 21 | Rezervuari Kojush I | 4676250.86 | 7468239.17 | 459.84 | Prizren | 50 | Beton | 1988 |
| 22 | Rez. Kabash i Hasit | 4681486.19 | 7463524.26 | 367.00 | Prizren | 90 | Beton | 2003 |
| 23 | Rez.Kushnin | 4681852.98 | 7461196.65 | 451.00 | Prizren | 150 | Beton | 2002 |
| 24 | Rezervuari Lutogllave | 4681628.30 | 7483852.33 | 469.73 | Prizren | 250 | Beton | 2015 |
| 25 | Rez. Dobrusht | 4671018.34 | 7466805.29 | 403.00 | Prizren | 50 | Beton | 1986 |
| 26 | Rez. i vjeter _Shkoze | 4669201.93 | 7466188.30 | 449.00 | Prizren | 150 | Beton | 1978 |
| 27 | Rez. Ralin | 4674680.42 | 7479348.32 | 539.00 | Prizren | 850 | Beton | 2019 |

Rezervuarët



2.2 Aktivitetet kryesore

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve – TM1- 2024

| Njësia Operative | Ujësjetësi - uji i pijes |
|------------------|--------------------------|
| Prizren | 533 |
| Suharekë | 89 |
| Dragash | 12 |
| Malishevë | 117 |
| Total | 751 |

* Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në tabelë.

| Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik | | |
|--|--|--------------------------------------|
| Grupet | Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Mars - 2024 | |
| Kalibrim i ujëmatësve | 242 | riparime të ujëmatësve |
| Ndërrimi i ujëmatësve (D-M) | 777 | vizita të konsumatorit |
| | 428 | ndërrime të ujëmatësve |
| | 108 | riparim të defekteve gjatë ndërrimit |
| Detektimit të rrjetit | 190 | detektime |
| | 127 | defekte të gjetura |
| | 5,140 | rrjet i detektuar (m) |

Koment: Ne periudhën TM1-2024 janë ndërruar 428 ujëmatës – 165 ujëmatës me shume se ne periudhën TM1-2023 (vetëm 265 ujëmatës)

2.3 Cilësia e ujit të pijes

IKSHP

| NJËSIA | Lloji i Ujit | Numri i Mostrave | Numri i Mostrave qe nuk përgjigjen. |
|---------|--------------|------------------|-------------------------------------|
| PRIZREN | Burim | 3 | 0 |
| | | 428 | 1 |
| | Ujësjetës | 0 | 0 |
| | | 24 | 0 |
| | Burim | 0 | 0 |
| | | 55 | 0 |

| | | | |
|--------------|-------------|-----------|----------|
| DRAGASH | Ujësjiellës | 3 | 0 |
| | | 60 | 2 |
| SUHAREKË | Burim | 6 | 0 |
| | Ujësjiellës | 567 | 3 |
| | | 3 | 0 |
| | | 428 | 1 |
| MALISHEVË | Burim | 0 | 0 |
| | Ujësjiellës | 24 | 0 |
| | | 0 | 0 |
| | | 55 | 0 |
| TOTAL | | 3 | 0 |
| | | 60 | 2 |

*Mostra e cila nuk l përgjigjet standardeve te ujit te pijes sipas ISHP -Prizren është prania e hekurit në një mostër e marrë në Prizren.(muaji Shkurt)

*Mostra e cila nuk l përgjigjet standardeve te ujit te pijes sipas ISHP – është e marrë në njësinë Malishevë pas reshjeve të shiut ku prania e turbulitetit, e Manganit dhe hekurit ishte prezentë pak më shumë se normat e lejuara .Konsumatorët janë informua me kohë që mos ta përdorin për pije.(muaji Mars)

2.4 Situata e furnizimit

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për periudhën TM1 2024, në nivel rajonal, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt.

Vazhdimi i pjesshëm i reduktimeve të furnizimit në fshatin Zhur, komuna e Prizrenit, si shkak edhe te vazhdimit te investimit për ndërrimin e tërësishëm te rrjetit te ujësjiellësit. Mungesa e energjisë ekektrike (prishjet në rrjetin distributiv – KEDS) dhe mungesa të pjesëshme të furnizimit në disa lokalitete nga prishjet teknike në rrjetë, infrastrukturës elektropomuese dhe faktorëve tjerë eventual. Mungesat e furnizimit me ujë kryesisht janë shfaqur gjatë ditës apo në periudha të shkurtra kohore.

Nder faktorët qe kane ndikuar ne situatën e furnizimit janë edhe ndërhyrjet e shpeshta nga aperatorët ekonomik, gjate realizimit te investimeve te tyre, investime nga Qeveria e Kosoves, Kuvendi Komuna dhe KEDS. Etj. Rrjeti i vjeterur nga materiali asbest cement (ACC)

Keqperdorimet e mëdha te ujit te pijes, po ndikojne edhe ne rënien e presionit te ujit te pijes ne zona me te larta

3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.1 Inspektimi dhe Shkyçja

- Me intensitet të shtuar , kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, ku janë shpërndarë njoftime për përmbarim, legalizim te konsumatorëve, ankesa te konsumatorëve, inkasim e borgjeve dhe aktivitete të tjera duke i ndërruar terrenet e lexuesve.

RAPORT I EKIPEVE TË INPEKTORIATIT – TM1 2024

| Njesite operative | Shperndarja e njoftimeve paralajmerues e per permbarim/shkyçje | Shkyçjet-Lidhjet e paligjshme | Shkyçjet për mos pagesë | Nr. i shkyçje. Totale | Verifikimi i leximit te ujëmatësve | Nr. i leximeve te gabuara | Rastet e dorezuara per gjykatë | Kontrata te riprogramimit |
|-------------------|--|-------------------------------|-------------------------|-----------------------|------------------------------------|---------------------------|--------------------------------|---------------------------|
| Prizren | 4,334 | 184 | 246 | 430 | 2,131 | 17 | 69 | 34 |
| Suharekë | 1,781 | 13 | 24 | 37 | 1,864 | 5 | 35 | 29 |
| Malishevë | 1,283 | 3 | 23 | 26 | 61 | 5 | 14 | 0 |
| Dragash | 110 | 2 | 8 | 10 | 51 | 0 | 0 | 0 |
| TOTAL | 7,508 | 202 | 301 | 503 | 4,107 | 27 | 118 | 63 |

4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE

VI. PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

4.1 NJ.P- PRIZREN – TM1- 2023-2024

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

| MUAJI | TM1-2023 | TM1-2024 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|--------------|----------------|---------------|-------------|
| <i>Prodhimi m3</i> | 2,573,700 | 5,734,863 | 3,161,163 | 122.8% |
| <i>Faturimi m3</i> | 1,323,252 | 1,503,892 | 180,640 | 13.7% |
| <i>Faturimi nga uji €</i> | 907,219.34 € | 998,391.91 € | 91,172.57 € | 10.0% |
| <i>Faturimi- te tjera €</i> | 17,979.75 € | 7,456.30 € | - 10,523.45 € | -58.5% |
| <i>Faturimi Total €</i> | 925,199.09 € | 1,005,848.21 € | 80,649.12 € | 8.7% |
| <i>Inkasimi nga uji €</i> | 901,392.03 € | 933,178.04 € | 31,786.01 € | 3.5% |
| <i>Inkasimi - te tjera €</i> | 18,982.40 € | 5,975.52 € | - 13,006.88 € | -68.5% |
| <i>Inkasimi Total €</i> | 920,374.43 € | 939,153.56 € | 18,779.13 € | 2.0% |
| <i>Nr. i Konsumatorëve</i> | 39,350 | 41,059 | 1,709 | 4.3% |
| <i>% e inkasimit</i> | 99.4% | 93.5% | -5.9% | |
| <i>Shpenzimet</i> | 818,117.36 € | 934,874.41 € | 116,757.05 € | 14.3% |
| <i>Pagat</i> | 508,751.36 € | 549,893.44 € | 41,142.08 € | 8.1% |
| <i>Rryma elektrike</i> | 166,189.82 € | 189,202.91 € | 23,013.09 € | 13.8% |
| <i>Shpe. e derivateveve</i> | 27,365.00 € | 26,534.46 € | - 830.54 € | -3.0% |
| <i>Miremb. Dhe riparimet</i> | 24,507.38 € | 64,939.27 € | 40,431.89 € | 165.0% |
| <i>Miremb, e automjeteve</i> | 9,183.64 € | 19,173.30 € | 9,989.66 € | 108.8% |
| <i>Shpen. E taksave</i> | 29,095.77 € | 26,078.00 € | - 3,017.77 € | -10.4% |
| <i>Kemikalet</i> | 6,593.52 € | 3,015.90 € | - 3,577.62 € | -54.3% |
| <i>Shpenzimet tjera</i> | 46,430.87 € | 56,037.13 € | 9,606.26 € | 20.7% |
| <i>Uji I pafaturuar në m3</i> | 1,250,448 | 4,230,971 | 2,980,523 | 238.4% |
| <i>Uji I pafaturuar ne %</i> | 48.6% | 73.8% | 25.2% | |
| <i>Mbulimi operativ</i> | 1.12 | 1.00 | (0.12) | |
| <i>Mbulimi operativ-€</i> | 102,257.07 € | 4,279.15 € | - 97,977.92 € | |

4.1 INVESTIMET – NJP- PRIZREN

| MARRËRVESHJET NË KUADËR TË FINANCIMIT PËR PROJEKTE KAPITALE ME KOMUNAT DHE MINISTRINË NË ZONËN E SHËRBIMIT | | | | | | | | | | | | |
|--|--|-----------|---------|--|-------------------|-------------|---------------------|------------------|---------------|----------|--------------------|---|
| Nr .1 | Lënda e marrëveshjes | Nr. Prot. | Komuna | Projektet | Data e nëshkrimit | Kohëzgjatja | Vlera e kontraktuar | Financimi Komuna | Financimi HRJ | Progresi | Totali Marrveshjes | Statusi |
| 1 | Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes ne Rr. Edut Durham | 2244 | Prizren | Rr. Edit Durham Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes me gjatësi të trases 1.6 km, ku përfshihen dim. (Ø63, Ø75, Ø90, Ø110, Ø160, Ø200, Ø315). Vendosija e ujëmatesve në prone publike, kyçje shtëpiake mbi 420cope. | 23.08.2022 | 2 vite | € 639,314.96 | € 589,314.96 | € 50,000.00 | 95% | € 639,314.96 | E perfunduar Punimet janë perfunduar. Ka mbetur të bëhet pranimiti teknik nga ana e KK-Prizren. |
| 2 | Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes ne Rr. Nene Tereza | 2243 | Prizren | Rr. Nene Tereza Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes me gjatësi të trases 3.0 km, ku përfshihen dim. (Ø63, Ø75, Ø90, Ø110, Ø160, Ø315). Vendosija e ujëmatesve në prone publike, kyçje shtëpiake mbi 416cope. | 23.08.2022 | 2 vite | € 779,820.86 | € 729,820.86 | € 50,000.00 | 70% | € 779,820.86 | Aktiv Punimet kanë filluar në Maj -2024 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|--|------|---------|---|------------|--------|-------------------|-------------------|----------------|-----|-------------------|--|
| 3 | Vendosja e pusetave dhe ujematesave ne prone publike per konsumatorët e fshatrave te burimit te Vemices - Prizren, duke perfshire fshatrat Zhur, Shkoze, Vermice dhe Dobrosht. | 2746 | Prizren | Fshati Zhur Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit me gjatesi te trases 38.0 km, ku perfhsihen dim. (Ø63, Ø75, Ø90, Ø110, Ø125, Ø160). Vendosja e ujematesave ne prone publike, kyçje shtepiake mbi 1,250cope. Rehabilitim i komores se thate tek rezervuari ekzistues. | 05.11.2020 | 2 vite | € 2,497,919.29 | € 2,497,919.29 | € - | 45% | € 2,497,919.29 | Aktiv Punimet kane filluar ne Tetor -2023. Punimet jane duke vazhduar me intenzitet te larte |
| 4 | Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit ne zonen Nenkalaja -PZ | 2004 | Prizren | Nenkalaja Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit me gjatesi te trases 0.33 km, ku perfhsihen dim. (Ø63, Ø75, Ø110, Ø125). Rehabilitim i kyçjeve te lokaleve. | 20.08.2021 | 3 vite | € 188,744.50 | € 168,744.50 | € 20,000.00 | 95% | € 188,744.50 | E perfunduar Punimet jane perfunduar. Ka mbetur te behet pranimi teknik nga ana e KK-Prizren. |
| 5 | Rehabilitimi i gypit të ujësllësit DN 125mm në sheshin "Shadërvan" | 1085 | Prizren | Sheshi Shadërvan Gjatesia e trases se projektit 440 m', ku perfhsihen dim. (Ø63, Ø75, Ø90, Ø110). Rehabilitim i kyçje shtepiake mbi 80 cope. | 18.03.2024 | 3 muaj | € 20,000.00 | € - | € 20,000.00 | 95% | € 20,000.00 | Aktiv Punimet kanë filluar në Maj - 2024. Punimet tokesore Prizren Punet e furnizimit dhe instalimit - HRJ KK- |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|-----|---------------------------------------|--|------------|---------|----------------|----------------|----------------|------|----------------|---|
| 6 | Hapje e puseve dhe shtrirja e rrjetit te ujesjellesit ne fshatin Gerncar | 471 | Prizren Gerncar (Mninstia Ekonomisë) | Lot I : Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit me gjatesi te trases 1.3 km, ku perfhshihen dim. (Ø63, Ø90, Ø110, Ø125). Vendosja e ujematesve ne prone publike, kyçje shtepiake mbi 250cope. | 06.02.2024 | 10 muaj | € 94,406.53 | € 86,020.00 | € 8,386.53 | 10% | € 94,406.53 | Aktiv Punimet kanë filluar në Korrik - 2024. |
| 7 | | | | Lot II : Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit-hapja e puseve nëntokësore në zonën e shërbimit të KRU HRJ. | 06.02.2024 | 10 muaj | € 13,980.00 | € 13,980.00 | € - | 100% | € 13,980.00 | E perfunduar Punimet per shpimin e puseve kane perfunduar, ne Qershor - 2024. |
| 8 | Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU | | Prizren | Lot I: Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësave jashtë pronës private në rrugën "Astrit Suli" - Prizren. | 13.06.2024 | 3 muaj | € 52,217.70 | € - | € 52,217.70 | 10% | € 52,217.70 | Aktiv Punimet kane filluar ne Korrik 2024 |
| 9 | "Hidroregjioni Jugor" Sh.A (Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash). | | | Lot II: Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësave jashtë pronës private në rrugët: "Sadik Ramë Gjurgjeviku, Vilajeti i Sanxhakut, Aziz Kelmendi dhe Oso Kuka" - Prizren | 10.06.2024 | 3 muaj | € 77,019.00 | € - | € 77,019.00 | 30% | € 77,019.00 | Aktiv Punimet kane filluar ne Qershor 2024 |

| | | | | | | | | | | | |
|----|--|---------|---|------------|--------|-------------------|-------------------|-----------------|------|-------------------|--|
| 10 | Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes DN(160, 110, 90, 63)mm dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private, në rr. Xheme Gostivari - Priaren | Prizren | Xheme Gostivari Rehabilitimi i rrjetit të ujësjes në gjatësi rreth 1.4 km dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në rrugën, rreth 350 cope | | 6 muaj | € - | € - | € 235,000.00 | 0% | € 235,000.00 | Aktiv Projekti është inicuar në Korrik - 2024 dhe është në procedurë të prokurimit |
| 11 | Furnizimi me gjenerator 225kw, në lokacionin 40-Burimet në Prizren. | Prizren | Gjenerator te 40-Burimet Furnizimi dhe montimi i gjeneratorit me kapacitet 110kw, për mbajtjen në punë të pompave tek 40-Burimet, me qëllim të furnizimit të qendrueshëm me ujë | 28.02.2024 | 6 muaj | € - | € - | € 14,425.00 | 100% | € 14,425.00 | E perfunduar Projekti është përfunduar në Mars-2024 |
| 12 | Furnizimi me dy gjeneratore, për funksionalizimin e stacioneve të pompimit në STP. "Nashec" dhe STP. "Kojush 1". | Prizren | Dy Gjenerator në Nashec dhe Kojush 1 Furnizimi dhe montimi i dy gjeneratorëve për funksionizimin e stacioneve të pompimit dhe furnizimin e qendrueshëm me ujë për 14-fshatra. | | 2 muaj | € - | € - | € 50,000.00 | 0% | € 50,000.00 | Aktiv Projekti është inicuar në Korrik - 2024 dhe është në procedurë të prokurimit |
| | | | | | | € 4,363,422.84 | € 4,071,819.61 | € 577,048.23 | | € 4,662,847.84 | |

SEKTORI I MJEDISIT DHE MENAGJIMIT TE MBETURINAVE NE KOMUNEN E PRIZRENIT

HYRJE

Sektori i Mjedisit dhe Mbeturinave është themeluar në vitin 2015, në përputhje me Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060, i cili që përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e komunave. Që nga viti 2011, Komuna e Prizrenit ka marrë mbështetje nga Qeveria Japoneze përmes Agjencisë Japoneze "JICA", përmes projektit për Ngritjen e Kapaciteteve për Menaxhimin e Mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë. Ky projekt ka mbështetur komunën e Prizrenit me dy grante kryesore:

1. Granti për Ngritjen e Kapaciteteve Teknike: ky grant përfshinte trajnimin dhe aftësimin e zyrtarëve komunalë për menaxhimin e mbeturinave.
2. Granti ndihmës : ky grant përfshinte furnizimin me 25 kamionë për grumbullimin e mbeturinave, të cilët i janë dhuruar Komunës së Prizrenit.

Gjatë periudhës së bashkëpunimit me agjencinë “JICA” nga viti 2010 deri në vitin 2015, u realizua studimi i fizibilitetit të planit për menaxhimin e mbeturinave dhe trajnimi i stafit përmes shumë trajnimeve në Kosovë dhe Japoni.

Që nga viti 2015, Komuna e Prizrenit ka themeluar stafin për Sektorin e Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave, i cili përbëhet nga këta zyrtarë:

1. Udhëheqës i Sektorit të Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave
2. Zyrtar për Mjedis
3. Zyrtare për Menaxhim të Mbeturinave
4. Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun
5. Sporteliste për Databazën e Amviserive për Menaxhim të Mbeturinave

Ky sektor është përgjegjës për zbatimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit në Komunën e Prizrenit, duke siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët.

SISTEMI LIGJOR

Sektori i Mjedisit dhe menagjimit te mbeturinave vepron ne baze te ligjeve dhe rregulloreve qe i përcakton statusi i Komunës së Prizrenit dhe Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, komuna fuqizoi këto dokumente:

- Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave shkurt 2022
- Plani Pesëvjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2018
- Plani Master për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023 Nr. 01/011-161014,

Si dhe Ligjet :

- Ligji Nr. 02/L-30 për menaxhimin e Mbeturinave
- Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit

PLANI MASTER – ZBATIMI I SISTEMIT TE RI

Deri në vitin 2015, pastrimi i hapësirave publike në Komunën e Prizrenit ishte kontraktuar me kompaninë publike dhe dy kompani private, të financuara nga buxheti i komunës. Ndërkohë, sistemi i grumbullimit të mbeturinave menagjohej nga KRM Ekoregjioni dhe tri kompani të tjera private, të cilat financoheshin nga të hyrat e grumbullimit të mbeturinave, të cilat i mblidhnin vetë nga burimet gjeneruese.

Shkalla e inkasimit në zonat ku Ekoregjioni shërbente ishte e pamjaftueshme, rreth 50%, ndërsa kompanitë private grumbullonin mbeturinat vetëm nga ato amvisëri që kishin paguar. Për rrjedhojë, shumë qytetarë nuk merrnin shërbimin e grumbullimit, duke rezultuar në një sasi të konsiderueshme mbeturinash të pa grumbulluara në territorin e komunës.

Që nga viti 2015, bazuar në Planin Master, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave ka marrë përsipër përgjegjësinë e plotë për menaxhimin e mbeturinave dhe sistemin e inkasimit. Ky sektor ka përvetësuar të gjitha detyrimet që lidhen me organizimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e proceseve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave, si dhe mbledhjen e të hyrave nga shërbimet e ofruara. Kjo reformë ka synuar përmirësimin e efikasitetit dhe mbulueshmërisë së shërbimeve në të gjithë territorin e komunës, duke siguruar një menaxhim më të qëndrueshëm dhe të integruar të mbeturinave.

AKTIVITETE KRYESORE TË SMM

Veprimet kryesore të Sektorit në zbatimin e Planit Master për Menaxhimin e Mbeturinave janë:

1.1 KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR SISTEMIN E INKASIMIT TË MBETURINAVE:

Që nga viti 2015, sektori ka implementuar një sistem të centralizuar të bazës së të dhënave për inkasimin e grumbullimit të mbeturinave në të gjithë komunën e Prizrenit. Ky sistem është zhvilluar nga një kompani programuese me të cilën ka një kontratë të vazhdueshme për mirëmbajtje dhe rishikim të programit. Nga lista e marrë nga Sektori i Tatimit në Pronë, është bërë një rishikim i detajuar duke ndarë të gjitha amvisëritë që janë pronë e shtëpive banuese nga objektet e tjera si garazhdat, anekset, etj., për të siguruar një listë më të saktë.

| Tabela përmbledhëse per numrin e amvisërive | | | |
|---|--------|--|--------|
| Viti | 2015 | | 2023 |
| Numri i amviserive | 30,094 | | 33,124 |

1.2 ZGJERIMI I SHËRBIMIT TË MBETURINAVE, MIRËMBAJTJA VERORE, DIMËRORE SI DHE HARTIMI I DOKUMENTEVE PËR KONTRAKTIMIN E KOMPANIVE:

Sektori ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka kontraktuar kompanitë për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe grumbullimin e mbeturinave.

Në vitin 2023 është nënshkruar kontrata për shërbimin, grumbullimin, transportin, dhe deponimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit, në vlerë prej 3,259,401.60€, në periudhë dyvjeçare për 33,124 amvisëri.

Deri në vitin 2015 shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ka përfshirë **82%** të territorit të komunës ndërsa që nga periudha 2015-2023 dhe në vazhdimësi territori i komunës është i mbuluar




Figura e parë paraqet zonat e mbuluara me 82%, në vitin 2015, ndërsa figura e dyte paraqet zonat e mbuluara me 100%

1.3 SISTEMI I SHËRBIMIT DERË ME DERË

Sektori i Mbeturinave zbaton një sistem të shërbimit të qëndrueshëm dhe të organizuar për mbledhjen e mbeturinave në nivel individual dhe kolektiv. Për amvisëri, shërbimi ofrohet derë me derë, një herë në javë, duke siguruar që mbeturinat të grumbullohen në kohë dhe në mënyrë efikase.

Gjatë këtij shërbimi amvisëritë sinjalizohen me një melodi të kompozuar enkas për të dhënë sinjal që amvisëritë të vendosin shportat para derës së tyre me kohë. Në banesat kolektive, ku janë të vendosur kontejnerët, mbledhja e mbeturinave bëhet 2-3 herë në ditë. Në zonën e Sheshit të Shatërvanit shërbimi bëhet 5 herë brenda 24 orëve .


Në rrugën unazore shërbimi i grumbullimit bëhet 5 herë në ditë brenda 24 orëve, ndërsa gjatë muajve kur fluksi i njerëzve është më i madh, muaji Korrik dhe Gusht rritet numri i shërbimit në rrugën unazore por edhe në pjesë tjera të qytetit.

Sektori zhvillon aktivitete per ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave ku sipas kesaj zhvillohen dy aksione per mbledhjen e mbeturinave te vëllimshme: Aksioni Pranveror 1 – 7 Maj dhe Aksioni Vjeshtor 1 – 7 Nëntor.

Gjate disa festave te ndryshme vjetore zyrtare shërbimi sipas kalendarit behet një dite ose dy dite me vonë ose me herët se që është shërbimi i rregullt.

1.4 SASIA E MBETURINAVE PËRGJATË VITEVE

| Vitet | Sasia e mbeturinave të deponuar | Inkasimi i mjeteve |
|-------|---------------------------------|--------------------|
| 2016 | 37554 | 1086883.80 |
| 2017 | 43314 | 1118895.31 |
| 2018 | 44246 | 1184684.11 |
| 2019 | 40504 | 1255413.54 |
| 2020 | 41,913 | 1251881.52 |
| 2021 | 46839 | 1387520.10 |
| 2022 | 49447 | 1077469.27 |
| 2023 | 49409 | 1107672.32 |



1.5 Inkasimi dhe faturimi

Pergjatë këtyre viteve sistemi i inkasimit dhe faturimit është zbatuar përmes sistemit të përcaktuar në Planin Master, ku u krijua një databazë për menaxhimin e mbeturinave përmes një kompani programuese.

Tabela e përgjithshme e të dhënave

| Objektivat | Rezultatet |
|--|--|
| Numri i banoreve | 177,781 |
| Numri i ekonomive familjare | 3 |
| Numri i bizneseve | 4,403 |
| Numri i institucioneve | 134 |
| Numri i kompanive të kontraktuara | 1 |
| Numri i ditëve të planifikuara për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës në vit | 265 |
| Sasia e mbeturinave në vit | 49,839.80 / T |
| Sasia e mbeturinave në muaj | 136.54 /T |
| Sasia e mbeturinave për person / ditore | 0.75 kg/p/d |
| Përqindja e mbulueshmërisë | 100 % , përfshirja e të gjitha zonave të komunës |
| Përbërja e Mbeturinave | 49% mbeturina me përbërje organike , 51% mbeturina tjera |
| Deponia e mbeturinave komunale | Landovicë, deponi regjionale |
| Kapaciteti i Deponia e Landovicës | <ul style="list-style-type: none"> - Deponia është planifikuar që kapaciteti i saj të mbushet deri në vitin 2021 duke marrë parasysh që graviteti specifik i deponisë është parashikuar të jetë 1.2ton/m³ - Deponia regjionale është ndërtuar si deponi sanitare me hapësirë 25 ha dhe e dizajnuar me kapacitet 2.6 million m³, financuar nga EAR në Landovicë me 2004. - Deponia e Landovicës operohet nga Kompania për Menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK). |

- Sasia ditore e deponuar ishte 176.9ton/ditë (112.8ton/ditë nga Prizreni, 64.1 ton/ditë vjen nga vendet tjera) si në

Korrik 2024

RAPORT PUNE

Gusht 2023 - Qershor 2024

Këshilli për Trashëgimi Kulturore Të Qendrës Historike të
Prizrenit

Veron Tara
Kryetar



Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Akronimet | 2 |
| 1. Hyrja | 3 |
| 2. Përmbledhja e Punës | 4 |
| 2.1. Puna gjatë periudhës Gusht 2023 – Qershor 2024 | 4 |
| 2.2. Konsultimet shtesë..... | 7 |
| 3. Bashkëpunimi ndër-institucional..... | 7 |
| 4. Reagimet..... | 8 |
| 5. Administrimi | 9 |
| 6. Kërkesat për të ardhmen..... | 9 |
| 7. Kompezimi i punës së Anëtarëve të KTKQHPz..... | 10 |

Akronimet

| | |
|---------|--|
| KTKQHPz | Këshilli për Trashëgimi Kulturore e Qendrës Historike të Prizrenit |
| KTK | Këshilli për Trashëgimi Kulturore |
| QHPz | Qendra Historike e Prizrenit |
| DUPH | Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor |
| QRTK | Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| LQHPz | Ligji nr. 04/l-066 për Qendrën Historike të Prizrenit |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |

Ky raport është hartuar nga Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe reflekton punën dhe angazhimin e KTK-së nga Gusht 2023 deri në Qershor 2024. Raporti ka për qëllim informimin e Asamblesë Komunale të Prizrenit. Përmbledhja mund të shërbejë komunës së Prizrenit për të informuar për zhvillimet, sfidat brenda QHPz dhe punën e KTK-së. Raporti mund të përdoret vetëm nga ana e komunës së Prizrenit dhe nuk mund të shërbejë për qëllime tjera.

1. Hyrja


Ligji nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike Të Prizrenit ka për qëllim përcaktimin e rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Administrimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit bëhet sipas Ligjit zhvillohet duke u bazuar në parimet e përgjithshme: mbrojtja, ruajtja, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e karakteristikave tradicionale historike urbane të Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit bëhet sipas parametrave të elaboruar në nenet 5,6,7 dhe 8 në planin e konservimit, pjesë integrale e këtij ligji.

Sipas nenit 14 të këtij parshihet themelimi i KTK nga Komuna e Prizrenit, i cili tani më është themeluar dhe i ka 7 anëtarë: tre (3) anëtarë janë nga shoqëria civile, një (1) anëtar nga Bashkësia Islame; një (1) anëtar nga Kisha Ortodokse Serbe, (1) anëtar nga Komuna e Prizrenit dhe një (1) anëtar nga Kisha Katolike.

Ky është mandati i katërt i KTK-së dhe ka filluar punën prej datës 01 Janar 2023. Në këtë përmbledhje do të reflektohet puna dhe angazhimi i KTK-së që nga muaji Gusht 2023 deri në muajin Qershor 2024. Raporti do të pasqyrojë numrin e rasteve të shqyrtuara për cdo muaj, numrin e rasteve në total, bashkëpunimi ndër-institucional, numri i rasteve për të objekteve të mbrojtura, numri i rrënimeve, reagimet, konsultimet shtesë, etj.


2. Përmbledhja e Punës

2.1. Puna gjatë periudhës Gusht 2023 – Qershor 2024




Në grafikonin më lartë paraqiten mbledhjet e mbajtura nga muaji Gusht 2023 deri tek muaji Qershor 2024. Siç shihet në statistika, numri mesatar I mbledhjeve të mbajtura për muaj është dy (2), ndërsa totali i mbledhjeve të mbajtura deri më tani janë trembëdhjetë (13) mbledhje. Kjo nënkupton që në muaj janë mbajtur 1 deri në 2 mbledhje. Përmbajtja e mbledhjeve jo gjithmonë ka qenë e koncentruar në lëndë të pranuar, por edhe për avancimin e Këshillit në procese të mëtutjeshme, në krijimin dhe plotësimin e Databazës së lëndëve, në krijimin dhe plotësimin e databases së terrenit, në mbledhjet të cilat janë mbajtur për rishikimin e vendimeve dhe rikapitulimin e lëndëve. Po ashtu në kuadër të mbledhjeve të mbajtura janë edhe takimet të cilat janë bërë me qëllim të daljes në terren për vlerësimin apo evaluimin e lëndëve të dorëzuara në Këshill. Po ashtu në këtë numër të mbledhjeve hynë edhe takimet të cilat i kemi pasur me institucione relevante dhe përgjegjëse të trashëgimisë, institucioneve të tjera të cilat janë të qasura në ndërtime, institucione tjera relevante të cilat kanë qenë pjesë e ndonjë procedure të lëndëve të aplikuara, mbledhjet apo takimet me organizata të ndryshme në të cilat Këshilli ka qenë i ftuar si palë punuese apo edhe vetëm si pjesë e grupit. Duhet cekur që pjesë e takimeve kanë qenë edhe palët apo aplikuesit të cilët me kërkesën tonë apo

edhe me vet kërkesën e tyre kanë mbajtur konsultime shtesë dhe janë sqaruar mendimet dhe vendimet në mënyrë më të hollësishme.



Më lartë në grafikun paraqiten aplikimet e lëndëve të cilat janë bërë në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit. Siç shihet në grafikun numri i përgjithshëm i aplikimeve është 61, ku me përgjigje PO janë 43 lëndë, me përgjigje JO janë 9 lëndë, nuk shqyrëtohen është 2 lëndë dhe me kthim të lëndëve për Plotësim janë 8 lëndë. Kjo nënkupton që në muaj janë lëshuar pesë (5) deri në gjashtë (6) lëndë me përgjigje të caktuara të marra nga KTKQHPz. Këtu bëjnë pjesë jo vetëm kërkesa apo aplikime nga persona fizik por edhe nga institucione dhe organizata të ndryshme të cilat kanë qenë të inkuadruara në Qendrën Historike të Prizrenit. Me përqindje më të lartë shohim se janë lëndët të lëshuara me përgjigje positive pra me PO të cilat janë parë të arsyeshme dhe të cilat kanë respektuar rregulloret dhe ligjet e QHPz-së. Po ashtu me numër të afërt të përgjigjeve positive janë edhe ato të cilat nuk i'u është dhënë pëlqimi nga ana e Këshillit, sepse KTK ka vlerësuar se ato nuk i përmbushin rregullat dhe nuk janë në kontekst me ligjin e QHPz. Me përqindje më të ulët janë edhe përgjigjet e kthyera për Konsultime shtesë të cilat nuk rrefuzohen por se Këshilli e sheh të arsyeshme të ketë takime për sqarimin e lëndëve përkatëse. Në këtë grup janë edhe përgjigjet të cilat janë kthyer për Plotësim, të cilat qëllimin kryesor e kanë mos rrefuzimin e lëndës por Aplikuesi të dorëzojë dokumente shtesë për plotësimin e përmbushur të lëndës së dorëzuar.



Në grafikonin më lartë paraqiten të gjitha lëndët të ndarë në muaj. Gjithsej i kemi 61 lëndë duke i ndarë në muaj:

| Viti | Muaji | PO | JO | Plotësim | Nuk Shqyrtohen |
|------|---------|----|----|----------|----------------|
| 2023 | Gusht | 5 | 1 | 1 | 0 |
| 2023 | Shtator | 3 | 0 | 0 | 0 |
| 2023 | Tetor | 1 | 0 | 0 | 0 |
| 2023 | Nëntor | 10 | 0 | 0 | 0 |
| 2023 | Dhjetor | 2 | 1 | 0 | 0 |
| 2024 | Janar | 4 | 1 | 0 | 0 |
| 2024 | Shkurt | 2 | 4 | 1 | 0 |
| 2024 | Mars | 3 | 0 | 2 | 1 |
| 2024 | Prill | 3 | 0 | 3 | 1 |
| 2024 | Maj | 3 | 0 | 0 | 0 |
| 2024 | Qershor | 4 | 1 | 1 | 0 |

Sipas statistikave numri më i madh i lëndëve të shqyrtuara është në muajin Nëntor 2024 ku gjithësej kemi 10 lëndë.

2.2. Konsultimet shtesë

-KTK ka pranuar kërkesë nga Ruzhdi Thaqi me Nr. i Lëndës: 04-353/01-113407 për konsultime shtesë.

Duke u bazuar në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-066 dhe Nenin 17 me paragrafet 1 dhe 2, KTKQHPz ka organizuar takim ku janë ftuar përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore. Takimi është organizuar në dy pjesë, pjesa e vizitës në terren dhe e diskutimit mes përfaqësuesve të ftuar në takim.

Fillimisht rasti është vizituar në terren me qëllim të observimit të gjendjes aktuale dhe diskutimit të kërkesës së aplikuesit. Aplikuesi ka qenë i pranishëm në terren dhe gjatë diskutimit ka deklaruar që është e interesuar që projekti të jetë në harmoni me Ligjin dhe parametrat për Qendrën Historike të Prizrenit.

Pas vizitës në terren diskutimi ka vazhduar në zyrën e KTKQHPz ku janë diskutuar argumentet PRO dhe KUNDËR rrënimin.

Përfaqësuesja e QRTK-së ka deklaruar se do të mbajnë qëndrimin e vendimit të QRTK Prizren të lëshuar me datë 31.07.2023.

Sa i përket përfaqësueses nga DUPH, bazohen në dokumente ligjore dhe sipas tyre lënda në fjalë i ka përmbushur detyrimet ligjore.

Përfaqësuesit e KTKQHPz kanë deklaruar se do të mbajnë qëndrimin e vendimit të KTKQHPz të lëshuar me datë 15.08.2023.

Duke qenë që Konsultimi Shtesë ka përfunduar pa konsensus nga tre palët atëherë duke u bazuar në Ligjin 04/L-066, Neni 18, paragrafet 1. Në qoftë se brenda (pesëmbëdhjetë) 15 ditëve pas kërkesës për konsultime shtesë nuk arrihet marrëveshja, Drejtoria e urbanizmit lëshon lejen përkatëse ose e refuzon duke u bazuar në Planin e konservimit dhe ligjet në fuqi dhe 2. Leja e lëshuar apo e refuzuar nga Drejtoria e urbanizimit, i dërgohet paraqitësit të kërkesës, Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Prizren dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit.

3. Bashkëpunimi ndër-institucional

Bashkëpunimi është me OSBE-së. Është me rëndësi të përmendet ky takim, pasi që OSBE këtë takim e ka organizuar me qëllim të njohjes mes institucioneve relevante të QHPz dhe të diskutohet mbi aspektin e kompenzimit të punës së anëtarëve të Këshillit të QHPz.

4. Reagimet

Sikur edhe në periudhën kaluese KTK ka vazhduar me reagime ndaj parregullsive Brenda QHPZ.

Duke pasur parasysh situatën kautike të krijuar në Qendrën Historike të Prizrenit dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë dhe njëkohësisht të kërkojmë nga JU që urgjentisht të ndërmerren masa te nevojshme.

Duhet të theksohet se Plani i Konzervimit parasheh që Qendra Historike e Prizrenit (QHPz) të promovohet si zonë për këmbësorë. Për më tepër duke konsideruar gjendjen aktuale të krijuar (nën-zonën I, II dhe III) ku shumica e pronarëve të bizneseve, përfaqësues të institucioneve, organizatave etj, parkohen brenda QHPz, për ne si KTK është shqetësuese sepse reflekton uzurpim të trotuareve dhe kufizim të lëvizjes së lirë të këmbësorëve. Mendojmë që shëndrrimi i QHPz në vendparkim publik është i patolerueshëm dhe i papranueshëm. Për të shmangur këtë situatë rekomandojmë që fillimisht të revokohen të gjitha lejet të lëshuara (nëse posedojnë) deri sa të ofrohet zgjidhja afatgjate. Gjithashtu ju rekomandojmë që para se të lëshohet leja për qarkullim duhet të bëni analizë paraprake të gjendjes në terren për secilin aplikues.

Kemi përkujtuar se Neni 12, LIGJI Nr. 04/L-066 PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT-Lëvizja e automjeteve; Organi kompetent komunal për rregullim të trafikut, harton planin dhe regjimin e posaçëm të transportit automobilistik për Qendrën Historike të Prizrenit me qëllim të sigurimit të lëvizjes së lehtë dhe të vazhdueshme, duke promovuar mjetet jo-motorike të transportit - që do të thotë se jeni përgjegjës për hartim të një Plani të Mobilitetit për QHPZ i cili do të adresojë të gjitha problemet aktuale të lartpërmendura. Po ashtu kërkojmë që të zbatohen rregulloret, vendimet dhe ligjet në fuqi mbi aktivitetet brenda QHPz.

Duke u bazuar në LIGJIN Nr. 04/L-066 PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT në dispozita që dalin nga ky ligj dhe në Plan të Konzervimit, Këshilli për Trashëgimi Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit lëshon këtë reagim me këto rekomandime:

1. Rekomandohet që të largohen të gjitha reklamat/shenjëzimet të cilat kalojnë sipërfaqen e lejuar si dhe ato që nuk janë në harmoni me Ligjin e Qendrës Historike si dhe me Rregulloren e Komunës për vendosjen e reklamave (mbi 1m²) brenda gjithë QHPz.
4. Rekomandohet që të largohen të gjitha veturat brenda Sheshit Shadërvani të cilat nuk kanë pëlqim/vendim për parkimin e tyre.
5. Rekomandohet që të largohen shportat/kontejnerët e mbeturinave në apo në afërsi të monumenteve.
6. Rekomandohet që të largohen të gjitha elementet tjera (frigorifera, rafte) jashtë kiosqeve të cilat janë vendosur brenda QHPz.
7. Rekomandohet që të largohen tezgat/shitësit ambulativ të cilët janë pa pëlqim të QRTK, pa rekomandim të KTK dhe pa pëlqim të DUPH.

9. Rekomandohet që të largohen elemente si: kova, karrige, tavolina; brenda dhe në afërsi të Krojeve nën mbrojtje dhe brenda QHPz.

10. Rekomandohet të largohen dhe të vendosen shenjzime për ndalimin e parkimit të Motoçikletave brenda hapësirave publike të QHPz.

11. Rekomandohet të largohen (paketimet, gajbet, plastikat dhe elemente tjera) të lokaleve nga hapësirat e gjelbërta në të gjitha Kejet përreth bregut të lumit.

Të gjitha këto reagime duke u kumtuar si rekomandime janë bazuar në Ligjin e Qendrës Historike të Prizrenit me nr. nr. 04/L-066, në Planin e Konzervimit të Qendrës Historike të Prizrenit si dhe në rrgulloret tjera të Komunës së Prizrenit.

Prandaj, ne si KTK kemi kërkuar që të konsiderojnë rekomandimet të lartëcekura dhe sa më parë të ndërmerrni hapa drejt zgjidhjes së problemit që ballafaqohet me vite të tëra QHPz.

5. Administrimi

Sikurse edhe në periudhën paraprake ka vazhduar mirëmbajtja e databazës së krijuar ku rregjistrohen, strukturohen të gjitha kërkesat që vijnë në zyre të KTK. Është e rëndësishëm sepse ofrohet mundësia që puna dhe angazhimi i këtij mandati mund të përcjellet më lehtë në mandatet e ardhshme dhe njëkohësisht bëhet edhe ruajtja e informacioneve.

Duhet të theksohet se për krijimin e kushteve të volitshme për punë, KTK me financa personale bën pastrimin, lyerjen dhe rregullimin e zyrës.

6. Kërkesat për të ardhmen

Duhet marrë parasysh që KTK vazhdimisht bën kërkesa për funksionalizimin e zyrës, por shumë rrallë apo asnjëherë nuk kemi marrë. Andaj, **KTK** përsëri parashton disa kërkesa për zyre:

- Kyqja në rrjet të internetit;
- Hapja e e-mailave zyrtar për të gjithë anëtarët e Këshillit;
- Printimi i hartave të nevojshme të QHPz, në dimension A1;
- Një hapësirë në ndërtesën e Qendrës Evropë, si dhe dollape/rafte për arkivim;
- ID kartelat e anëtarëve të Këshillit;
- Furnizimi i një Hard Disk (SSD) për ruajtjen e të dhënave;


Si kërkesë të veçantë, e kemi shprehur disa herë që anëtarët e KTK të bëjnë vizita studimore në vendet të kërkuara, për ngritje dhe shkëmbim të informacioneve profesionale me institucionet të ngjajshme relevante të trashëgimisë kulturore në vendet e rajonit dhe më gjerë.

7. Kompezimi i punës së Anëtarëve të KTKQHPz

Ashtu siç dihet tash e 2 vite e gjysmë, anëtarët e KTKQHPz, nuk kompenzohen për punën e tyre profesionale. Nga vullneti i mirë dhe gjithmonë në gatishmëri, anëtarët kontribuojnë në vazhdimin e punës në këtë institucion, edhe pse nuk marrin asgjë në kompensim.

Andaj, kërkojmë përsëri nga ju, si një trup i vetëm që jeni, që të gjindet një zgjidhje për këtë qësjtje, pasi që ne vlerësojmë që nuk është aspak e drejtë nga ana e institucioneve kompetente të mos mirret asnjë veprim i suksesshëm.

Veron Tara, Kryesues



Këshilli i Trashëgimisë Kulturore
të Qendrës Historike të Prizrenit